



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar
në “Drejtësi”**

**Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut
në Tiranë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc. Dr. Hemion Braho

2. Dr. Bledar Mustafaraj

Shtator/2021

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar në "Drejtësi" të ofruar nga institucioni i arsimit të lartë "Universiteti i New York-ut në Tiranë"

Nr.		
1	IAL aplikues:	"Universiteti i New York-ut në Tiranë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Drejtësisë dhe Disiplinave Humane
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave (PI) në "Drejtësi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 939, datë 03.09.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Udhëzim i MASH Nr. 219, datë 3.7.2020.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASh Nr. 185, datë 10.09.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 40, datë 31.05.2019
8	Cikli i studimit:	Program Integruar
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 Vite
10	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	17PAE/7PAK v.a 2019-2020 17PAE/8PAK v.a 2020-2021
18	Numri i studentëve:	16 Studentë v.a 2019-2020 10 Studentë v.a 2020-2021
19	Komente / të tjera:	*Analiza e kryer në këtë raport i shërben akreditimit të programit ekzistues, përpara riakreditimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Institucioni jopublik i arsimit të lartë “University of New York-Tirana” (i përmendur në vijim me inicialet UNYT) është licencuar dhe ka nisur veprimtarinë e tij në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 397, datë 15.8.2002 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “New York University-Tirana”.

Në vitin 2012 institucioni ndryshon statusin nga shkollë e lartë universitare në Universitet, si dhe emërtimin nga “New York University of Tirana” në “Universiteti i New York-ut në Tiranë”, emërtim të cilin e ka dhe sot.

Ky institucion e ushtron veprimtarinë si person juridik, në formën e shoqërisë tregtare “New York University-Tirana” sh.p.k., me NUIS K21714002G. UNYT ushtron aktivitetin e tij në Tiranë, me adresë qendrore: Rruga “Kodra e Diellit”, Tiranë, në ambientet universitare ku është vendosur prej vitit 2015.

UNYT përbëhet nga tri njësi kryesore: Fakulteti i Informatikës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore. Brenda Fakultetit të Shkencave Shoqërore është ngritur dhe funksionon Departamenti i Drejtësisë.

UNYT është riakredituar institucionalisht me vendimin Nr. 102, datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Në bazë të këtij vendimi është vendosur “akreditimi institucional të institucionit të arsimit të lartë, “Universiteti i New York-ut në Tiranë”, me kohëzgjatje 3 vite”.

Programi i studimit në Drejtësi është një program i integruar i nivelit të dytë, i cili ka nisur të zbatohet gjatë vitit akademik 2009-2010. Programi është përshtatur në program Master i Shkencave me shkresën e MASH Nr. 6858/2, datë 6.5.2011.

Universiteti i New York-ut në Tiranë (UNYT) ka konceptuar dhe zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich, programin e integruar të studimit në “Drejtësi” (BA (Hons) Law). Deri në vitin 2014-2015 programi është ofruar nga UNYT në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich.

Programi është riakredituar me VBA Nr. 40, datë 31.5.2019, me kohëzgjatje 2 vite, i vlefshëm deri më 30.09.2021, me rekomandime.

Programi i integruar i studimit Master i Shkencave në Drejtësi është riorganizuar dhe miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me udhëzimin e kësaj të fundit Nr. 219, datë 3.7.2020. ***Pavarësisht kësaj, IAL kërkon që të akreditojë programin e studimit për studentët e rregjistruar para riorganizimit për shkak se nuk i transferon dot në programin e riorganizuar.***

Pavarësisht kësaj, UNYT ka aplikuar pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për akreditimin periodik të programit të integruar të studimit në “Drejtësi”, për shkak të pamundësisë së transferimit në programin e ri, të studentëve të regjistruar para riorganizimit.

Me shkresën Nr. 132/1 Prot., datë 21.12.2020 të kësaj Agjencie, ka marrë konfirmimin për aplikimin e kryer lidhur me qëllime të riakreditimit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL; ekspertët e jashtëm janë njohur me parimet kryesore të procesit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit të jashtëm (i përmendur në vijim me inicialet RVJ) është hartuar nga GVJ në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. RVJ bazohet në të dhënat e marra nga shqyrtimi i dokumentacionit që ka vënë në dispozicion IAL dhe vizitës së realizuar në institucion. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesin sa më drejt e në mënyrë objektive, performancën e institucionit në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele (sipas sistemit të standarteve të vendosur nga ASCAL):

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi është koordinuar nga ASCAL brenda afatit të caktuar, me të cilin grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. As. Hemion Braho, ekspert dhe drejtues i GVJ, dhe Dr. Bledar Mustafaraj, ekspert (të caktuar me urdhrin Nr. 34, datë 24.05.2021, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë). Gjatë gjithë këtij procesi, GVJ është asistuar nga Muhamed Prezja, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar dokumentet dhe informacionet e përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi, i cili ka shërbyer për hartimin e raportit të jashtëm. Dokumentacioni ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion.

Gjithashtu, informacioni i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, të zhvilluar në datë 4 Qershor 2021 sipas një agjende gjithëpërfshirëse.


Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga UNYT në ofrimin e një programi të mirë të integruar të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Drejtësi, gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik, kërkimor dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të juristëve.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit, mbështetur në Vendimin Nr. 40, datë 31.5.2019, janë:

1. Institucioni, të rishikojë planin mësimor me qëllim dedikimin e një numri më të madh kreditesh lëndëve të fushës së të drejtës dhe përfshirjen në plan të disa lëndëve të rëndësishme të së drejtës si p.sh. kriminologji/penologji, kriminalistikë, mjekësi ligjore, etj.
2. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, me grada e tituj, me qëllim mbulimin e lëndëve nga staf akademik me kualifikimin e kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe uljen e ngarkesës së lartë mësimore të stafit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi.
3. Institucioni, të marrë masa për garantimin e ngarkesës së nevojshme në auditor për çdo lëndë, me qëllim shqyrtimin e çështjeve me gjerësinë dhe thellësinë e nevojshme për një program të integruar në drejtësi.
4. Institucioni, të rishikojë syllabus-et e programit të studimit, në kuadër të standardizimit të tyre, ofrimit të një informacioni të detajuar për studentët lidhur me çështjet themelore dhe literaturën përkatëse, evitimin e mbivendosjeve të temave dhe sigurimin e një koherence të brendshme.
5. Institucioni, të marrë masa të vazhdueshme për përditësimin e literaturës në bibliotekë si dhe të sigurojë literaturën e nevojshme për lëndët e detyrueshme të këtij programi studimi.
6. Komisioni për Sigurimin e Cilësisë, të hartojë një plan veprimi dhe të pasqyrojë përmes raporteve të gjitha aktivitetet që ndërmerr lidhur me sigurimin e cilësisë si dhe të sigurojë ndjekjen e rekomandimeve dhe raportimin mbi masat e marra për adresimin dhe zbatimin e tyre.
7. Institucioni, të shtojë aplikimet për grante kërkimore dhe të mobilitetit dhe të rrisë përfshirjen e stafit akademik të këtij programi studimi në kërkim shkencor, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore.
8. Institucioni, të reflektojë mbi mundësitë dhe pengesat që lidhen me zhvillimin e programit në gjuhën angleze dhe mbulimin e lëndëve të programit me literaturë në gjuhën angleze.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni



1. Në lidhje me rekomandimin e parë:

Sa i përket këtij rekomandimi GVJ konstatoi në dokumentacion dhe gjatë vizitës që Institucioni ka riorganizuar në 2020 programin e integruar të Drejtësisë duke modifikuar kurrikulën në bazë të këtij rekomandimi dhe logjikës së specializimit. Si rjedhojë, lëndët e përgjithshme janë reduktuar si sasi, me përjashtim të lëndëve të cilat i ndihmojnë studentët në zhvillimin e tyre profesional. UNYT ka evidentuar si risi në kurrikulën e re kurset e Sigurisë Kibernetike dhe Kontrollit të Shtetit, Penologji dhe Kriminologji, Drejtësi për të Mitur, Klinikë Ligjore, Siguria Kibernetike (*Evidenca 1.31*). Gjithashtu në sajë të Projektit Jean Monnet i ofrohen studentëve lëndë inovative si p.sh. Ligji i BE-së në Sistemin Ligjor Shqiptar dhe Çështjet Shëndetësore të EU (*Evidenca 2.2*). *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*

2. Në lidhje me rekomandimin e dytë,

Gjatë vizitës Institucioni ka evidentuar angazhimin e personelit të ri në Fakultet dhe Departament sidomos me kohë të pjesshme, në përputhje me rekomandimin. Në përputhje edhe me numrin e vogël të studentëve të regjistruar në këtë program, mund të afirmohet se institucioni ka marrë masat për të angazhuar staf akademik me grada dhe tituj që janë në disa raste edhe personilite të fushës. Kjo ka sjellë edhe ulje të ngarkesës për pedagogët e brendshëm, gjithmonë duke respektuar kërkesat ligjore në shpërndarjen e ngarkesës. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*

3. Në lidhje me rekomandimin e tretë:

UNYT ka ndërmarrë hapa që të përpilojë një shpërndarje të ngarkesës mësimore në përputhje me udhëzimet e ministrisë. Me këtë qëllim, Institucioni ka marrë masat në lidhje me alokimin e krediteve dhe orëve pas riorganizimit të programit duke angazhuar staf të ri dhe të kualifikuar akademik. Ngarkesa e mësimdhënies shpërndahet në mënyrë të ekuilibruar mes anëtarëve të fakultetit dhe pedagogëve me kohë të pjesshme. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*

4. Në lidhje me rekomandimin e katërt:

Sa i përket programit nën vlerësim ky rekomandim mbetet i pandryshuar duke qenë se programi reflekton të njëjtën program mësimor. Rekomandimi konsiderohet i realizuar në relacion me programin e integruar të riorganizuar në 2020. Në këtë të fundit Departamenti ka konsideruar si të rëndësishme përputhjen logjike midis kurseve të ndryshme së bashku me përfshirjen e temave të reja dhe literaturën më të fundit. Kurrikulat dhe programet mësimore të rishikuara referojnë literaturën më të mirë ndërkombëtare. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*

5. Në lidhje me rekomandimin e pestë:

GVJ konstaton që institucioni ka ndërmarrë masat e nevojshme për përditësimin e literaturës në bibliotekë si dhe ka siguruar literaturën e nevojshme për lëndët e detyrueshme të këtij programi, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Literatura e gjendur në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe angleze, garanton përmbushjen e objektivave të programit për studentët (*Evidenca 1.25 "List of Purchased Books in Albanian - LAW"; Evidenca 1.25 "List of Purchased Books in English - LAW"*). Institucioni ka siguruar akses pa pagesë për studentët në bibliotekat online "Jstore" dhe "Emerald Insight", në të cilat studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë larmi tekstesh e punimesh, në përputhje me programin e studimit (*Evidenca 2.1, tabela 17*). Aksesi në

bibliotekat online sigurohet në bazë të abonimit, ku “Jstore” përfshin koleksione online të revistave të ndryshme shkencore. “Emerald Insight” përfshin tituj revistash shkencore dhe libra. Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me “Empire State College”, ekziston mundësia për akses dhe në databaza të tjera, të tilla si “EBSCO”, “Proquest”, “Gale”, etj (*Evidenca 4.13 “Library facilities”*). *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*

6. Në lidhje me rekomandimin e gjashtë:

Në vijim të rekomandimit të lënë, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, ka hartuar një planveprimi për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Ascal dhe Bordi i Akreditimit (*Evidenca 6.3 dhe Evidenca 6.3.1*). Pasi mbledh të dhënat e nevojshme, në përputhje me instrumentet e përdorur, në fund hartohet raporti përfundimtar vjetor, i cili iu dorëzohet strukturave kompetente në IAL (*Evidenca 6.2*). Rezulton që, pas planit të veprimit që ky Komision ka dorëzuar në Rektorat, ky i fundit ka marrë masat e nevojshme për riorganizimin e departamentit nga departamenti i Ligjit dhe Shkencave Humane, në Departamentin e Drejtësisë; gjithashtu u miratuan syllabus-et sipas udhëzimit përkatës të ministrit të Arsimit si dhe është riorganizuar dhe programi objekt shqyrtimi (*Evidenca 14 dhe Evidenca 6.3.1*). *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*


7. Në lidhje me rekomandimin e shtatë:

Për GVJ ka rezultuar nga të dhënat e vëna në dispozicion, që anëtarët e stafit akademik kanë qenë pjesëmarrës në një sërë veprimtarish, si konferenca ndërkombëtare apo veprimtari kërkimore-shkencore. Në këtë drejtim, universiteti nxit dhe mbështet botimet e punimeve në revista të ndryshme shkencore (*Evidencat shitesë 4; Evidenca 1.41; Evidenca 2.12*). Në përputhje mesa ka përcaktuar në statut për fushën e kërkimit shkencor, rezulton që UNYT të ketë vendosur objektiva të qartë në këtë drejtim dhe të ketë lidhur marrëveshje konkrete ndërkombëtare, në nivel rajonal dhe më gjerë. Objektivat vlejné dhe për stafin akademik të këtij programi të studimeve (*Evidenca 1.12 “List of agreements and MoU-s”; Evidenca 1.13 “Balkan University Association Membership Evidence”; Evidenca 6.7, pika B*). Marrëveshjet e përbashkëta synojné në realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkët. Brenda institucionit është ngritur dhe funksionon zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare që mundëson vënien në praktikë të politikave të bashkëpunimit (*Evidenca 1.1, neni 55*). Gjithashtu, vlen të përmendet dhe hartimi i një strategjie të posaçme të ndërkombëtarizimit që përfshin periudhën 2020-2025 (*Evidenca 1.14*). Universiteti ka vënë në dispozicion të dhëna konkrete sipas të cilave, në kuadër të projekteve ku është angazhuar, ka organizuar disa aktivitete me pjesëmarrje të studentëve, ku përfshihet projekti i BE “Jean Monnet”. Në kuadër të tij, në muajin Shkurt 2020, në bashkëpunim me universitetin e Dubrovnik-ut (Kroaci), është organizuar shkolla dimërore “Strategjitë e demokratizimit dhe pajtimit në Evropën Juglindore: ripërcaktimi i politikave joefektive”. Evidentohet shkolla verore në muajin Korrik 2019 “Angazhimi për miqësinë: Ndryshimi i kulturës politike në Ballkan”, po në kuadër të projektit “Jean Monnet”, në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane të Serbisë, si dhe shkolla dimërore “Krijimi i bashkëpunimit territorial: Ndikimi i dialogut ndërkulturor dhe rrjedhat e migrimit në Juglindje Evropë”, e zhvilluar nën të njëjtin projekt në muajin Dhjetor 2018, në bashkëpunim me universitetin e Bolonjës (Itali) (*Evidenca 2.8*). Në përputhje me rregullimet që ka bërë në statut sa i përket fushës së kërkimit shkencor, konstatohet që universiteti siguron mbështetje për stafin akademik dhe për studentët, në drejtim të publikimit të punimeve të tyre në revista shkencore

ndërkombëtare. Buxheti propozohet nga anëtarët e departamentit, miratohet në vijim nga drejtuesi i departamentit, dekani e në fund nga rektori dhe Bordi i Administrimit (*Evidenca shtesë 5*). Rezulton që për kërkimin shkencor ka buxhet të veçantë, që lehtëson punën kërkimore (*Evidenca 4.23; Evidencat shtesë 4*). Për të siguruar në vijimësi informacione mbi mundësinë e granteve dhe bashkëpunimin, institucioni qëndron në kontakt me zyrën kombëtare Erasmus+, Tiranë, si dhe me Agjencinë për Kërkime, Teknologji dhe Inovacion, Tiranë (*Evidenca 1.12.3*). Mobiliteti i studentëve, i stafit akademik dhe atij administrativ mundësohet edhe nëpërmjet programeve Mevlana (*Evidenca 1.12*). UNYT rezulton gjithashtu që të jetë bërë pjesë e një grupi arsimor në pronësi të fondacionit turk Maarif, nën siglën “International Maarif Schools”, që vepron në mbi 40 vende të globit. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*

8. Në lidhje me rekomandimin e tetë:

Në lidhje me këtë rekomandim UNYT ka reflektuar duke ofruar kurse të caktuara në gjuhën shqipe. Në riorganizimin e programit kurse të caktuara si Ligji Penal, E Drejta Civile, Penale Procedura, Procedura Civile, E Drejta Administrative dhe Procedura Administrative sipas Rregullores së Programit do të ofrohen në gjuhën shqipe për shkak të specifikave të lëndëve (*Evidenca 1.10*). Sidoqoftë programi ruan karakteristikat e një kurrrikule me natyrë ndërkombëtare duke ofruar disa lëndë në gjuhën angleze dhe në këtë drejtim gjithashtu pedagogët kanë mundësi materiale ndërkombëtare. Ky lehtëson edhe transferimin e studimeve brenda dhe jashtë shtetit. *Rekomandimi është plotësuar plotësisht.*



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar në “Drejtësi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar “Drejtësi”, i ofruar nga Departamenti i Drejtësisë i cili lidhet më së shumti me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Institucionit. Këto elemente shprehen qartë në planin strategjik të zhvillimit të Universitetit të New York-ut Tiranë (UNYT) të rishikuar në 2020. Programi ekzistues, por edhe programi i riorganizuar në 2020 (<i>Evidencat 1.2; 1.3, 1.4</i>) sigurojnë një kombinim gjithëpërfshirës të disiplinave ligjore duke u fokusuar në elementët kryesorë si doktrinarë, si praktikë me në focus tregun e punës dhe kapacitetet e brendshme të Fakultetit.
Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ekzistenca e Planit Strategjik të UNYT-së (<i>Evidenca 1.5</i>), ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm, të planifikuar e të mirë menduar të zhvillimit të programit të studimit si edhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen. Programi i studimit që nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Programi ofrohet në kombinim midis gjuhës angleze lidhur me temat e përgjithshme, po ashtu edhe në shqip lidhur me temat e domosdoshme teknike të fushës së drejtësisë (<i>evidenca 1.10</i>).
Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Si rrjedhojë, ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës bazuar në një studim të tregut të punës të përgatitur nga institucioni që përfshin: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar. UNYT në studimin dhe analizën e tregut ka arritur në përfundimin se Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Drejtësi” (<i>evidencat 1.2; 1.3; 1.6</i>) është një program i kërkuar kryesisht nga juristë të cilët duan të përfitojnë studime të thelluara në fushën e të drejtës private dhe tregtare, me qëllim punësimin pranë institucioneve publike dhe jo-publike, por edhe në strukturave publike si pranë organeve të administratës gjyqësore, në fushën e ndërmjetësimit dhe përmbarimit,

	zyrave të avokatisë dhe noterisë, personave juridik dhe shoqërive tregtare private, sistemit bankar etj.			
Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Si rezultat të diplomuarit punësohen kryesisht në firmat e njohura juridike në shkallë kombëtare por edhe ndërkombëtare në disa raste. Në këtë drejtim, UNYT ofron programin e tij të integruar të studimit në fushën e Drejtësisë duke ndërthur si teorinë ashtu edhe praktikën e së drejtës vendase dhe asaj ndërkombëtare. Këto element u mundësojnë studentëve të analizojnë praktikat e mira doktrinare si teorike, si praktike, duke reflektuar mbi zhvillimet e më të fundit jo vetëm juridik, por në tërësinë e aspekteve shoqërore.			
Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;	Programi i studimit paraqet elementët e konkurrueshmërisë në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të elementëve përbërës të tij si: plani mësimor/ kurrikula, programet e lëndëve, kreditet (BCTS/ECTS), metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve sipas njohurive të fituara (<i>evidenca 1.21</i>). Dimensionin si edhe politikat e UNYT kanë në qendër studentin, me mundësinë e individualizimit të nevojave akademike të studentëve (<i>evidencat 1,5; 1.17; 1.17,1; 1.18</i>)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet plotësisht	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi Master i Shkencave në “Drejtësi” është në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të UNYT-së 2020-2025. Kjo reflektohet në punën e vazhdueshme për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik, vazhdimësinë dhe rritjen e bashkëpunimeve, nxitjen dhe zhvillimin e kërkimit shkencor. Mungon një strategji zhvillimore e posaçme lidhur me Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Duke konsideruar gjerësinë e fushës së mbuluar nga ky Fakultet, një strategji e posaçme zhvillimore do të integronte më së miri politikat e ndërmara nga Universiteti, Fakulteti dhe Departamentet lidhur me çështjet akademike, fushat kërkimore, punësimin e studentëve, etj.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i	Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë ofrohet në përputhje me Statutin e UNYT, (<i>evidenca 1.1, Neni 63</i>) dhe Rregullat dhe Rregulloret e UNYT, (<i>evidenca 1.9, 1.10</i>). Në linjë me objektivat e strategjisë për zhvillimin e institucionit është edhe riorganizimi i programit të studimit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>MSc (PI) Drejtësi në drejtim të pajisjes së studentëve jo vetëm me njohuritë bazë shkencore dhe profesionale, si edhe me aftësitë e posaçme të kominikimit në funksion të zgjerimit të mundësive për punësim në disa sektorë. Ky program ofrohet me një maksimum prej 600 BCTS / 300 ECTS. Në Vitin 2020, programi ekzistues Master i Shkencave i Integruar në Drejtësi i cili u ofrua me një numër maksimal prej kreditesh (600 BCTS) u riorganizua në Kredite Evropiane në mënyrë që të harmonizohet më tej me sistemin Bolonjës. Në harmoni me dispozitat ligjore shqiptare të cilat kërkojnë që programet e integruara të ofrohen me minimumi 300 ECTS dhe një kohëzgjatje normale pesë vjet UNYT vepron (<i>takimi me drejtuesit e Fakultetit</i>). Plani Strategjik i rishikuar në 2020 tek pjesa ku analizohet "Era e Ardhshme e Edukimit" ka përcaktuar si qëllim inovator Digjitalizimin e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies (<i>Evidenca 1.5</i>). Programi është liçencuar me Vendimin e KM Nr. 939, datë 03.09.2009 dhe riorganizuar me Urdhrin e Ministrit të Arsimit Nr. 919, datë 03.07.2020 (<i>evidenca 1.41</i>). Mungon një rregullore e plotë e institucionit që nuk lejon të vlerësohet pozitivisht ky kriter. Kjo gjetje e GVJ-së do të reflektohet edhe përgjatë raportit lidhur me kërkesat e tjera të raportit lidhur me këtë akt rregullativ.</p>			
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë i cili është pjesë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (<i>Evidencat 1.1; 1.1.11</i>). Në tërësinë e tij programi MSc (PI) në Drejtësi synon të kualifikojë studentët bazuar në progresin e tyre gjatë studimeve si edhe mundësisë së zgjedhjes sipas fushave të interesave të tyre. Siç u afirmua edhe përgjatë takimeve, një pjesë e mirë e studentëve shprehin preferencat e tyre në fushën tregtare. Staf i angazhuar gjatë vitit akademik për të dhënë leksione, ose për të kryer aktivitete jashtëkurrikulare vjen nga fusha të ndryshme të ekspertizës duke synuar krijimin e një organi të konsoliduar profesional që zbaton programin (<i>evidencat 2.1.1; 2.1.2; 2.1.3</i>). Organizimi i lëndëve në semestra bëhet sipas kurrikulës së programit (<i>evidenca 1.2; 1.3</i>). Aspektet praktike dhe profesionale të arsimit janë të integruara në aspekte të ndryshme të programeve të studimit, përfshirë praktikatat dhe projektet e kërkimit shkencor.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Partnerë të jashtëm të universitetit bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me institucionin, që përfiton avantazhe si në objektivin e zhvillimit e punësimit të studentëve, por edhe sa i përket kurrikulave të programit përfshirë edhe structure e përgjithme të tij. Synimi kryesor mbetet përmbushja e nevojave të tregut dhe ndërkombëtarizimi i kurrikulës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
		<p>X</p>		


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43428

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi I.3	
Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në rregulloren e Programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar “Drejtësi”, institucioni ka përcaktuar qartë organizimin e punës mësimore, shkencore, financiare dhe administrative që janë dhe infrastruktura bazë e realizimit të procesit formues për studentët (<i>evidenca 1.8</i>). Programi strukturohet në lëndë dhe module, ku janë të përcaktuara qartë qëllimet, objektivat, dijet dhe kompetencat profesionale që studentët përfitojnë në përfundim të kursit. Bashkësia e këtyre kompetencave është thelbi i programit i cili sipas studimeve të tregut të punës gjithashtu i përshtatet kërkesave të tij (<i>evidenca 2.2</i>). Këto objektiva të përcaktuar në rregulloren e programit Master i Shkencave “Drejtësi” janë sintetizuar në planet mësimore dhe syllabuse e lëndëve. Në syllabusin e secilës lëndë parashikohen, përmbajtja, objektivat, temat duke evidentuar literaturën përkatëse, ndarë në atë bazë, ndihmëse dhe plotësuese, detyrimet e studentit dhe sistemi i vlerësimit të tij.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në proceset akademike pranë diplomimit, studentët inkurajohen të marrin pjesë në praktikën profesionale dhe programet e punësimit. UNYT ka vendosur kontakte të vazhdueshme me komunitetin e biznesit dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për t’u ofruar mundësi të praktikës (<i>evidencat 1.12; 1.12.1; 1.12.2</i>). UNYT ka bërë një studim të tregut nëpërmjet anketimeve cilësor dhe sasior dhe ka zhvilluar aktivitete si Panairët e Karrierë, që realizohen në mënyrë periodike (<i>evidencat 1.20; 1.20.1; 1.20.2</i>). Përmes këtyre aktiviteteve, institucioni ofron mundësinë e diskutimit midis aktorëve të ndryshëm pjesë e tregut të punës dhe studentëve. Institucioni bën rishikime të kurrikulës edhe në rastin e përshtatjes së saj me nevojat e tregut. Përshtatja e kurrikulës me nevojat e tregut realizohet edhe përmes përfshirjes së lëndëve me zgjedhje, të cilat synojnë të ofrojnë për studentët njohuri dhe aftësi të nevojshme për tregun e punës (<i>evidenca 1.21</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u</p>	<p>Elementët përbërës të programit të studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar “Drejtësi” janë lëndët dhe modulet përbërëse të tyre, që kanë të specifikuar qartë dhe në mënyrë eksplicite qëllimet, objektivat, dijet dhe aftësitë profesionale që studentët përfitojnë në përfundim të kursit (<i>evidencat 1.6; 1.10</i>). Këto lëndë janë shprehje e qartë e nevojave të tregut të punës për jurist që njohin mirë themelet logjike të së drejtës, aktivitetin sipërmarrës dhe pjesën juridike të administratës publike.</p>

<p>përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi synon formimin e aftësive të veçanta nëpërmjet lëndëve, specifike të avancuara, që synojnë pajisjen e studentëve jo vetëm me njohuri bazë shkencore dhe profesionale në fushën e drejtësisë por edhe me shprehje ndihmëse duke kontribuar në zgjerimin e mundësive për punësim në më shumë sektorë të tregut. Shtojca e Diplomës, shpjegon për çdo progrprogramin e studimit si edhe informacionin në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit rezultatet dhe aftësitë e të nxëniet që merren nga përfundimi i secilit program, si në kuadër të punësimit, por edhe për transferimin e studimeve (<i>evidencat 1.22; 1.23</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është i konceptuar në mënyrë të tillë që studentët që mbarojnë në këtë specialitet të kenë mundësi të përshtatet edhe me tregun e jashtëm të punës. Lëndët që ky program ofron kanë ngjashmëri me ato të fakulteteve të drejtësisë së rajonit por edhe atyre perëndimore. Bashkëpunimi ndërinstitucional midis UNYT dhe IAL të huaja si bashkëpunimi deri në me Universitetin e Greenwich ka mundësuar ofertën e lëndëve të një natyre ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare si E Drejta, Politika dhe Feja, Qeverisja e Korporatave, E Drejta e Arbitrazhit, etj. Kjo i bën studentët e këtij programi studimi të kenë mundësi transferimi të studimeve në këto institucione në tregun e huaj (<i>evidencat 1.24; 1.26</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane, siç është në veçanëti universiteti britanik i Greenwich. Gjithashtu, anëtarësimi i UNYT në 2019 në Shoqatën e Universiteteve Evropiane, EUA dhe Shoqatën e Universitetit Ballkanik konsoliduan praktikën e mira akademike si edhe forcimin e standardeve të UNYT (<i>evidencat 1.13, 1.27</i>). Në këtë fushë, gjatë riorganizimit në vitin 2020, sistemi i krediteve u ndryshua nga BCTS në ECTS për lehtësimin e studentëve në karrierën e tyre profesionale dhe akademike në të ardhmen pas përfundimit të studimeve (<i>evidenca 1.4</i>). Programi i studimit siguron mbarëvajtjen e tij në bazë të akteve të brendshme të UNYT (Statuti, Rregulloren e Departamentit të Dejtësisë si dhe, Rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Rregulloren e departamentit të Drejtësisë, Rregulloren e programit të studimit. <i>evidencat 1.1; 1.8; 1.9; 1.10</i>)</p>
<p>Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktikën profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si</p>	<p>Për aftësimin praktik të studentëve, programi MSc. (PI) "Drejtësi" ka përfshirë, përveç praktikës profesionale, edhe praktikën të posaçme në çdo lëndë si pjesëmarrja në procese gjyqësore, gjyqe simuluese etj.</p>




dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Praktika profesionale si lëndë e posaçme, synon thellimin e njohurive teorike e profesionale të studentëve të fituara gjatë kohës së studimeve në UNYT, njohjen e tyre me aspekte teknike e të organizimit të punës në qendrat e trajnimit dhe me probleme që lidhen me planifikimin dhe kontrollin, si dhe t'u japë atyre njohuri dhe përvojë praktike në masë të nevojshme për t'i aftësuar në ushtrimin e aktivitetit profesional (evidencat 1.5; 1.12; 1.26).			
	Vihet re se klinika e ligjit mund të jetë më funksionale apo të jetë më e përfshirë në gjyqet simuluese me qëllim aftësimin praktik të studentit.			
Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Profili me karakteristika të forta ndërkombëtare ka bërë shumica e moduleve të ofrohen në gjuhën angleze, duke lehtësuar në këtë mënyrë edhe mundësinë e punësimit në organizata ndërkombëtare si edhe mobilitetin përgjatë studimeve. Që nga 2018, UNYT ka rritur programet e lëvizshmërisë duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete prestigjioze si Universiteti Tilburg, Universiteti i Genova, Universiteti i Granadës, Universiteti i Stambollit, etj. (evidencat 1.12, 1.12.1 1.13). UNYT ka hapur dy thirrje për studentët e Drejtësisë vitin e kaluar, por situatë e COVID-19 ka kufizuar studentët lidhur me këto mundësi lëvizjeje (evidencat 1.12.2).			
Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	UNYT është angazhuar që dokumentacioni i mbledhjeve, debateve, dhe komunikimeve midis strukturave të tij administrative dhe akademike të mbahet fizikisht dhe elektronikisht, është sistemuar përputhmërisht me Rregulloren për Arkivat (evidenca 1.30). Drejtuesi i Departamentit ruan dokumentacionin kryesor të programit të studimit, gjithashtu nga Databaza e Rektoratit si edhe Dosjet e Departamentit të Drejtësisë. Anëtarët e Departamentit mund të kenë akses në këtë bazë dokumentare. Planprogramet e miratuara dhe të nënshkruara depozitohen në Rektorat. Lidhur me aktivitetet e institucionit, faqja e internetit të UNYT ofron informacion të plotë dhe të vazhdueshëm (https://unyt.edu.al).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4	
Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Asad Beqiri

<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale menaxhon 3 programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë të ofruara nga 3 departamente. Programi i Studimit të Ciklit të Dytë të Integruar të Drejtësisë (i mëparshëm dhe ekzistues) organizohet dhe ofrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi duke kategorizuar lëndët dhe përqindjet e kurseve sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr, 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) (evidenca 1.3 +++). Personel akademik me kohë të plotë rezultojnë gjithsej 17 persona, nga të cilët 13 janë personel akademik me grada shkencore dhe tituj akademik, me përvojë në mësimdhënie dhe punë kërkimore, të cilët bashkërendojnë aktivitetin dhe mbështesin kualifikimin edhe të pjesës tjetër të stafit të fakultetit.</p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MSc. (PI) “Drejtësi” në tërësinë e tij, është në kohezion të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale në UNYT. Kodifikimin kombëtar i tij është bazuar në nenin 86 dhe nenin 125, të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Programi i studimit MSc (PI) në drejtësi ofrohet nga Departamenti i Drejtësisë, i cili është një prej tre departamenteve bazë të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (njësia kryesore).</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ka në përbërje të tij njësitë bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamentin e Drejtësisë; - Departamenti i Shkencave Politike / Marrëdhëniet Ndërkombëtare; - Departamenti i Psikologjisë; (evidenca 1.1.1) 			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e programit të studimit MSc. (PI) “Drejtësi” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive bazë, përgjegjëse për programin e studimit titulluar Departamenti i Drejtësisë, i cili bashkëpunon me njësi të tjera brenda fakultetit dhe UNYT. Po kështu dhe fushat specifike të programit që kanë të bëjnë me aftësimin e studentëve në sektorin privat dhe në atë publik të cilët do të jenë në gjendje të japin mendime juridike, të hartojnë kontrata, akte që përmban një dosje hetimore, gjyqësore apo përmbarimore. Kështu që këto synime përmbushin nevojat e shoqërisë, aktualisht dhe në të ardhmen të zhvillimit të vendit që është në përputhje e në funksion të përmbushjes së qëllimit të departamentit dhe me objektivat e Fakultetit. Gjatë vizitës GVJ u njoh me faktin se Departamenti i Drejtësisë ka prezantuar disa module në kuadër të Projekteve Jean Monet që UNYT ka fituar. Mund të veçohen lëndët e specializuara si <i>Çështjet e Shëndetit të BE-së, E Drejta e BE-së në Sistemet Ligjore Shqiptare</i> dhe <i>E drejta për Refugiatët</i> (evidenca 2.2).</p>			
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	Përbushet plotësisht




Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Standardi I.5


Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Realizimi i programit sigurohet nga një staf burimesh njerëzore të kualifikuar si në drejtimin akademik edhe në atë administrativ apo institucional. Në rregulloren e Fakultetit, dhe në rregulloret njësisë bazë, departamentet përkatëse, janë përcaktuar qartë detyrat dhe detyrimet e secilit funksion (<i>evidencat 1.8; 1.9; 1.10</i>). Kështu departamenti merr masat që personeli akademik me kohë të plotë (PAE) dhe ai me kontrate (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte optimale me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Po ashtu edhe IT-ja siguron mbulimin e shërbimeve online dhe ka patur rol të rëndësishëm për realizimin e procesit mësimor në kohë dhe sipas kërkesave të stafit dhe studentëve, veçanërisht nëpërmjet platformës e-learning (zoom platform) dhe në mënyrë institucionale krijoi Qendrën e-Provimit (<i>evidenca 5.21, 1.46</i>). Përgjatë takimeve GVB u informua se institucioni ka qenë në gjendje të rifillojë mësimin vetëm një javë pas masave shtrënguese lidhur me COVID-19. Biblioteka është në funksion të realizimit të këtij programi studimi (<i>evidenca 4.13</i>). Sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit nëzyrat e ndryshme, faqja online, janë në shërbim me kohë të plotë në mënyrë operative, funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Cdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit respektivë.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>UNYT në funksion të realizimit të programit të studimit, që ka një profil të theksuar ndërkombëtar, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe brenda e jashtë vendit. Këto marrëveshje janë lidhur për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për zhvillimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar apo personalitete të njohura në fushën e Drejtësisë, tryeza të rumbullakëta, organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta (<i>evidenca 1.5</i>). Në këtë drejtim strategjia e ndërkombëtarizimit është modifikuar për t'u harmonizuar me qëllimet dhe objektivat e Planit Strategjik 2020-</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>2025 (<i>evidenca 1.14</i>). UNYT gjithashtu është anëtarësuar e tij në Shoqatën e Universiteteve Evropiane dhe Shoqatën e Universiteteve të Ballkanit (<i>evidenca 1.13</i>). Në politikën e bursave, UNYT bashkëpunon me Programin e Bursave YTB Turkey (Bursat e Shtetit Turk) për ti ofruar studentëve të interesuar ndërkombëtarë dhe kombëtarë që të ndjekin studimet e tyre në UNYT përmes një programi ndërkombëtar bursash (<i>evidenca 1.34</i>). Zgjerimi i Fondacionit MAARIF ndihmon në rritjen e mundësive të shkëmbimit të studentëve (<i>evidenca 1.42</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje për praktikën e studentëve me kompani ligjore apo institucione të ndryshme dhe në planin mësimor parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale përpara punimit të diplomës. Lista e institucioneve që UNYT bashkëpunon është e kënaqshme (Boga & Associates, Deloitte Albania, Bashkia e Tiranës, etj.) duke u përcaktuar qartë në disa marrëveshje fokusi i afrimit të studentit me tregun e punës. Sa i përket kërkimit shkencor si edhe mobilitetit, UNYT ka realizuar partneritete me universitete të rëndësishme si: Universiteti Tilburg, Hollandë; Universiteti i Granadës, Spanjë; Universiteti i Genova, Itali (<i>evidencat 1.12; 1.15; 1.28</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Zyra e karrierës luan një rol të rëndësishëm lidhur me bashkëpunimin me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës (<i>evidencat 5.16; 5.16.1</i>). Qëllimi kryesor i kësaj zyre mbetet përgatitja sa më mirë e studentëve për tregun e punës në sektorin publik apo privat. Institucioni ka organizuar rregullisht <i>Panairin vjetor të Karrierës</i> ku studentëve u jepet mundësia të takohen me punëdhënësit e ardhshëm dhe të zhvillojnë një intervistë paraprake po në ambientet e universitetit. Panairi i Karrierës në UNYT ka siguruar një numër të konsiderueshëm të studentëve të punësuar ose studentëve që kanë fituar praktika pune (<i>evidenca 1.20</i>). UNYT arriti të organizojë edhe në periudhën e COVID-19 Panairin e “e-karrierës” (<i>evidenca 1.20.1</i>). Ndihma studentëve u ofrohet gjithashtu në elementët praktikë si përgatitja e CV dhe një letër motivuese, të përmirësojnë paraqitjen e tyre gjatë një interviste etj. (<i>evidenca 1.37</i>). Zyra e Karrierës gjithashtu ka organizuar leksione të hapura në të cilat ekspertë të fushave të ndryshme ndajnë përvojat lidhur me specifikat e profesionit juridik dhe kërkesat e tregut të punës (<i>evidencat 1.39; 1.39.1</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve</p>	<p>Në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional UNYT ka një sërë marrëveshjesh të cilat janë me fokus në kërkimin shkencor, duke patur si bazë organizimin e konferencave të përbashkëta. Ky bashkëpunim shtrihet brenda dhe jashtë vendit. UNYT mban marrëdhënie të vazhdueshme me Zyrën Kombëtare Erasmus+ në</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Tiranë dhe Agjencinë për Kërkime, Teknologji dhe Inovacion (Shqipëri) lidhur me mundësitë e granteve dhe bashkëpunimet e mundshme. Programi i shkëmbimit MEVLANA reflekton këtë bashkëpunim të frytshëm (<i>evidencat 1.12; 1.12.3</i>).			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Departamenti i "Drejtësisë" përgjegjës për këtë program, në funksion të realizimit të tij, harton raporte analitike mbi marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe të huaja dhe vendase atje ku ka pasur përfitime (<i>evidenca 6.7</i>). Gjithashtu, çdo vit Drejtuesi i Departamentit i paraqet Dekanin të Fakultetit, raportin individual të vlerësimit me parashikimet e bëra nga secili anëtar i Departamentit për vitin e ardhshëm akademik (<i>evidencat 6.10; 6.10.1</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Sik	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Gjatë vizitës u theksua se UNYT është duke punuar për gjallërimin e revistës shkencore International Journal of Balkan Studies (https://ijbs.unyt.edu.al/). Ky konsiderohet si hap i rëndësishëm drejt ndihmës së dhënë në publikimin e rezultateve kërkimore të stafit. Institucioni nuk ka mbështetur financiarisht stafin në publikimin e rezultateve të tyre shkencore dhe mbështetja kryesore ka konsistuar në pagesat e <i>fee</i> -ve herë pas here për personel të caktuar apo mospagimi i <i>fee</i> kur institucioni është organizator. Çdo departament në fillim të vitit akademik, paraqet buxhet projektet reth aktiviteteve të ardhshme kërkimore shkencore gjatë vitit të cilat miratohen nga Senati dhe Bordi i Administrimit (<i>evidenca 1.32</i>). Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve ne nxitje te pjesëmarrjes, ne kontribut monetar e po ashtu edhe suport operacional. Në shumicën e lëndëve studentëve u kërkohet të kryejnë kërkimin shkencor përmes eseve dhe projekteve të cilat janë pjesë programit të kursit. Duke filtruar këto punime përmes 'Turnitin' që të arrihet një standard i duhur si edhe për të mbrojtur pronësinë intelektuale (<i>evidencat 1.19; 1.19.1; 1.46</i>)




<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Qendrat e mëparshme të Kërkimit janë riorganizuar në një institut të ri që është Institutit të Kërkimeve Evropiane dhe Ballkanike. Kërkimi shkencor është nxitës i rritjes së vazhdueshme së Fakultetit. Kërkimi shkencor mbetet një nga shtyllat kryesore ku mbështetet veprimtaria e institucionit si një nga kërkesat kryesore për implementimin e sistemit të Bolonjës në UNYT i cili synon standardet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. UNYT ka elaboruar një sistem për matjen e cilësisë / sasisë së rezultateve të kërkimit të aplikuar nga tre fakultetet që përfshijnë llojin e rezultateve të hulumtimit dhe caktimin e nje sistemi pikëzimi (evidenca 1.38). SI rezultat, institucioni ndjek vlerësimet vjetore të rezultateve të hulumtimit të prodhuara nga stafi akademik dhe studiuesit (evidencat 6.10; 6.10.11). Ekzistojnë lloje të ndryshëm të stimuljeve gjatë procesit të vlerësimit të performancës në hulumtimet shkencore të cilat përbëjnë sistemin për matjen e cilësisë së rezultateve të kërkimit. Dy forma kryesore janë stimujt financiarë dhe stimujt akademikë (evidenca 1.38).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Në dokumentat programatikë institucioni e ka në fokus kërkimin shkencor (evidenca 1.14). Gjithsesi vihet re mungesa e planeve të detajuara kërkimore dhe orientimi i stafit për kërkimin që mundet të kryejnë qoftë në grup qoftë në mënyrë individuale. Sidoqoftë institucion ka politika motivuese për të motivuar stafin në kërkimin shkencor, si në politikat e brendshme, si duke rezervuar në buxhet një pjesë për kërkimin shkencor (evidenca 1.1 [neni 31]; 1.31).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese.</p>	<p>Institucioni ka një Këshill Etike që merret me etikën në veprimtarinë, ndër të tjera, edhe të procesit kërkimor. Hartimi I Kodit të Etikës sipas përcaktimeve të Statutit dikton linjat kryesore për mbrojtjen e pronësisë intelektuale (evidenca 4.7). Njësia kryesore ka miratuar gjithashtu suplementin e Diplomës ku përcaktohen qartë linjat që duhet të ndiqen me qëllim mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe etika e praktikën e mira në veprimtarinë kërkimore (evidenca 1.23). Dobi të veçantë ofron edhe Turnitin si instrument teknologjik për të evituar shkeljet në fushën e pronësisë intelektuale (evidenca 1.46).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor duke krijuar mekanizma incentivues në fushën financiare dhe karrierën akademike. Departamenti i ka nxitur studentet për pjesëmarrjen në Konferenca Shkencore siç është rasti i Kongresit të Parë Ndërkombëtar Studentor elektronik (për shkak të COVID-19) organizuar nga vetë UNYT, ku studentët e Drejtësisë ishin pjesë e kongresit me hulumtimet e tyre (evidencat 1.18; 1.18.1).</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MSc. (PI) "Drejtësi" është në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe vlerësimi në kredite bëhet sipas sistemit britanik të krediteve (BCTS) (programi "I vjetër") dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (programi i riorganizuar) (evidencat 1.2; 1.3; 1.6). Ky program është i strukturuar sipas lëndëve, moduleve dhe krediteve përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor dhe jashtë tij, të ndara sipas formave të mësimdhënies. 1 ECTS I korrespondon 2 BCTS, ndërsa 1 ECTS permban 25 orë gjithsej në auditor dhe punë individuale sipas VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar) dhe Rregullores së Departamentit (evidencat 1.3; 1.10).
Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit MSc. (PI) "Drejtësi" synon, nëpërmjet secilës lëndë apo modul, t'u japë studentëve terminologjinë e duhur që i duhet në formimin e tyre profesional. Në syllabusin e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxëniet dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të kursit. Aftësitë shprehimore teknike do i lejojnë studentët për t'u përballur me shumëllojshmërinë e profesioneve në këtë fushë. Krahas kësaj një avantazh përbën gjuha e përdorur përgjatë programit që është anglishtja dhe në këtë drejtim studentët kanë mundësinë për të thelluar njohuritë e tyre në specializime të ndryshme për shkak të fleksibilitetit dhe qasjes më të gjerë të jurisprudencës dhe materialeve. Studentët pasi të kenë mbaruar

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al


	<p>këtë cikël studimi të jenë të aftë, të marrin kompetencat dhe ta ushtojnë profesionin e tyre me përgjegjësi si dhe vazhdojnë studime më të thelluara apo në ciklin e tretë (<i>evidencat 1.2; 1.3; 11 dokumentacion shtesë</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në disa nga aktet rregullatore të institucionit (rregullore fakultetit, e departamentit dhe e programit të studimit) është shprehur qartësisht profili i programeve dhe njohuritë që ato japin (<i>evidencat 1.6; 1.7, 1.8; 1.9; 1.10</i>). Përditësimi periodik i përmbajtjes së lëndëve/moduleve me literaturën më të fundit bashkëkohore, ndihmojnë studentët të njihen me të rejtat më të fundit në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Në syllabusin e secilës lëndë apo modul, tematikat janë bashkëkohore dhe në metodat e mësimnxënies kërkohet nga studentët mendimi kritik për çdo teori dominante të fushës (<i>evidenca 2.2</i>).</p> <p>Në programin e studimit nën vlerësim, përgjatë takimeve në Insitucion, GVJ ka konstatuar se pedagogët zhvillojnë dhe aplikojnë metoda dhe njohuri standarte me qëllimet e përgjithshme formuese të programit duke patur parasysh edhe nevojat e tregut të punës. Tematikat pasurohen me elementë bashkëkohorë duke patur në vëmendje aspektet studimorë të orientuar drejt praktikës sipas standarteve që kërkon një program studimi në nivelin e një “Master të Shkencave”.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Njohuritë teorike me aplikimin praktik lidhen direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Kjo për shkak të faktit që studentët janë të pakët në numër dhe UNYT zhvillon politika për t’i punësuar. Programi është ndërthur me njohuritë teorike me aplikimin praktik të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës (<i>evidencat 1.11; 1.11.1</i>). Secila tematikë trajtohet me metoda studimore inovative duke e përditësuar me informacion bashkëkohore. Metoda simulative gjatë seminareve, të shembujve të ndryshëm aplikohen tek studentët të cilëve më pas u kërkohen zgjidhje dhe vendimmarrje rast pas rasti (<i>evidenca 6.18</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Elementët përbërës të strukturës së programit të studimit Msc. (PI) “Drejtësi” janë në përputhshmëri me LALRSH 80/2015, dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. Ai zbaton kërkesat e akteve rregullatore të institucionit, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme dhe specifike për programin. Çdo modul ka të specifikuar qartë kreditet për të dy programet ekzistues (BCTS/ECTS) në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë. Kontrollat e dijeve kryhen me anë të detyrave/projekteve të kursit individual ose në grup dhe provimeve të ndërmjetme dhe forma të tjera të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Grupet e seminarit janë në përputhje me tabelën 2 të VKM 41/2018, me më pak se 35 studentë/grupi (<i>evidencat 1.6/1.10</i>).</p>

<p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi paraekzistues është i strukturuar në Kurrikulën e Kurseve të Përgjithshme (148 BCTS), të përqendruara (concentration) (188 BCTS), një gjuhë të huaj dhe / ose lëndë me zgjedhje (60 BCTS) dhe një cikël lëndësh të specializuara (204 BCTS). Për t'u diplomuar në këtë program, studentët duhet të fitojnë një minimum prej 600 BCTS (300 ECTS) në të katër komponentët në përputhje me shpërndarjen e përbërësve të tyre (evidenca 1.6). Programi i riorganizuar është strukturuar në 5 kategori të ndryshme si në vijim: në lëndët e programeve bazë / standarde me 56 ECTS, lëndë të kurrikulës bazë me 165 ECTS; ndërdisiplinore dhe lëndë me zgjedhje që janë 44 ECTS; lëndë plotësuese me 22 ECTS; Detyrime Perfundimtare/ Disertacionit 12 ECTS (evidenca 1.3).</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Në këto programe studimi janë përcaktuar qartë ngarkesa në kredite e praktikës profesionale dhe e diplomës (36 BCTS ose 18 ECTS). Ky komponent i riorganizuar është ndarë në dy komponentë që i referohen Praktikës me 4 ECTS dhe Disertacionit të Diplomës me 12 ECTS (evidencat 1.2; 1.3; 2.2). Kjo është në përputhje me aktet nënligjore të LALKSH 80/2015 dhe me VKM 41 si dhe nivelin e programit. Në planet mësimore vjetore janë të shënuar edhe lëndët e veprimtarisë formuese dhe kreditet përkatëse të tyre sipas leksioneve, seminareve dhe praktikës profesionale. Zyra e karrierës ndjek dhe suporton gjithë procesin e zhvillimit të praktikës, ndërsa mbikëqyrësi I caktuar në departament ndjek zhvillimin e disertacionit të diplomës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Struktura akademike e Fakultetit ndahet në departamente, me Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontrata (PAK) dhe Personel Administrativ. Tri njësitë themelore nën Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale janë: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Politike dhe Departamenti i Psikologjisë (Neni 9 i Statutit të UNYT; evidenca 1.1.1). Programi Master i Shkencave në “Drejtësi” ofrohet nën përgjegjësinë e Departamentit të Drejtësisë. Sidoqoftë, sipas të dhënave, ky departament plotëson, në vitin e fundit akademik 2020-2021, detyrimin ligjor për të pasur numrin prej 7 pedagogësh nga të</p>




	cilët 3 me tituj dhe grada (janë 2 Prof. Asoc / 5 Dr. / 1 proces doktore / 3 Msc). Të drejtat dhe përgjegjësitë e cdo njësie janë të përcaktuara në aktet rregullatorë të institucionit (<i>evidencat 1.8; 1.9</i>).
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Detyrat e njësisë bazë dhe të drejtuesit të departamentit janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të UNYT. Drejtuesi i departamentit të Drejtësisë, si autoriteti drejtues akademik i kësaj njësie, mban gradën shkencore Dr. Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve të FDSHS realizohet duke u mbështetur në aktet rregullative të UNYT (Statuti, Rregullorja institucionale) dhe në rregulloret e njësive përkatëse. Misioni dhe objektivat e secilës prej njësive, që janë ne perputhje të plotë me misionin dhe objektivat e institucionit, pasqyrohen në aktet rregullatore përkatëse (<i>evidencat 1.1; 1.6; 1.7; 1.8; 1.9; 1.10</i>).
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Departamenti i Drejtësisë përmbush kushtet ligjore përsa i përket stafit akademik që duhen për të realizuar këtë program. Departamenti ka 2 pedagogë me titullin shkencor “Profesor i asociuar”, 5 me gradën shkencore “Doktor shkencash” dhe 4 me gradën “Master Shkencash”, ndër të cilët 1 është në process doktore. Ndërsa PAK janë 1 me titullin “Profesor i asociuar”, 5 me gradën shkencore “Doktor shkencash”, dhe 2 me gradën “Master Shkencash”. Raporti midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar, në nivel fakulteti është 11/8, në proporcion të duhur sa i përket kërkesave ligjore në raport me sasinë dhe përqindjet e lëndëve të mbuluara nga PAE/PAK. Në udhëheqjet e diplomave ngarkesa maksimale përcaktohet në 10 (dhjetë) udhëheqje në të njëjtën kohë lidhur me temat e ofruara në programet e studimit në fushën nën analizë.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Struktura, përbërja, funksionimi, si dhe drejtimi i e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përcaktohen qartë në statutin dhe aktet e tjera të UNYT, si dhe në rregulloret e tij dhe të departamenteve përkatëse. FDSHS përbëhet nga 3 departamente, Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Politike / Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Departamenti i Psikologjisë (<i>evidenca 1.1.1</i>). Ky fakultet drejtohet nga Dekani i cili zotëron titullin akademik Prof.As.Dr, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015. Departamenti i Drejtësisë ofron programet e integrar “Drejtësi”, paraekzistues (nën vlerësim) si edhe programin DINT të riorganizuar në 2020. Secili departament ka minimalisht 7 anëtar staf akademik me kohë të plotë, nga të cilët të paktën 3 janë me gradë shkencore apo titull akademik. Gjithashtu nga vizita u evidentua se edhe Përgjegjësi i Departamentit sapo ka përfutuar titullin shkencor Prof.As.Dr. (<i>takimi nr. 1</i>).

<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Gjatë vizitës është theksuar se stafi administrativ luan një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e programit nën vlerësim, duke kryer një sërë aktivitete në dobi të studentëve, proceseve akademike si edhe stafit akademik (<i>takimi nr. 4</i>). Edhe stafi akademik angazhohet në aktivetete administrative, proporcionalisht me kushtet kontraktuale dhe ngarkesën akademike. Dy anetarë nga personeli akademik janë të angazhuar në mënyrë aktive në organizimin e konferencave shkencore ndërkombëtare që UNYT po organizon nën kujdesin e Institutit të Studimeve Evropiane dhe Ballkanike. Gjithashtu u vu në dukje gjatë vizitës se tre personel akademik të Departamentit të Drejtësisë janë të angazhuar në projekte të BE-së si E drejta për Refugjatët, Çështjet e Shëndetit të BE-së dhe Qendra e Ekselencës së BE-së / Zgjerimi i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor (<i>evidencat 1.29; 1.29.1; 1.29.2; 1.29.3</i>)</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Roli i koordinorit është i parashikuar në aktet rregullative të UNYT. Këtë funksion e mbulon aktualisht Përgjegjësja e Departamentit, siç i është konfirmuar GVJ edhe gjatë vizitës në Institucion. Numri i vogël i studentëve ka justifikuar këtë zgjedhje. Sidoqoftë prezenca e një koordinorit të posaçëm do të lehtësonte punën e përgjegjës të departamentit.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Drejtuesi i Departamentit raporton drejtpërdrejt tek Dekani i Fakultetit lidhur me nevojat që departamenti mund të ketë (<i>evidencat 1.43; 1.32</i>). Sipas RVB dhe akteve rregullative rezulton se koordinimi i programit të studimit realizohet midis përgjegjës të departamentit dhe dekanit. Nuk ka një koordinator i cili mbikqyr dhe supervizon realizimin e programit mësimor si dhe praktikat profesionale në përputhje me objektivat e tij. Duke qenë se dy figurat e koordinarit dhe përgjegjës të departamentit bashkohen në një të vetme, kjo ngarkon punën e përgjegjës të departamentit dhe shton rolin vendimmarrës tek dekani. Sugjerohet, në këtë pikë, të caktohet një anëtar tjetër departamenti në rolin e koordinorit të programit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet përafërsisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------




<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, si njësia kryesore, ofron informacionin e nevojshëm për studentët dhe stafin akademik. Informacioni lidhet me programet mësimore dhe elementëve të tyre. Cdo program studimor i ofruar nga njësia bazë që ofron programin e studimit MSc. (PI) në “Drejtësi” përmban emërtimin e lëndëve, krediteve përkatëse, numrin e orëve mësimore në auditor dhe ato të punës individuale të studentëve, titullarët e lëndëve dhe elementët e tjerë të programit të cdo lënde (<i>evidenca 1.1</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi është i ndarë në 10 semestra. Çdo semestër, studentët mund të marrin deri në pesë kurse, ndërsa në semestrin e fundit, studentët marrin vetëm 2 lëndë dhe pjesa tjetër ndahet në praktikë profesionale dhe punë kërkimore për temën e diplomës. Studentët kanë mundësinë të marrin 47 lëndë (282 ECTS), si edhe 18 ECTS të tjera si praktikë profesionale dhe punim diplome. Programi është i ndarë në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët me zgjedhje janë ne total 12 ku studentët duhet të zgjedhin 5 prej tyre: 1 lëndë në vitin e parë; 1 lëndë zgjedhore vitin e dytë; dhe 3 lëndë me zgjedhje në vitin e katërt. Studenti mund të eliminojë 1 lëndë me zgjedhje të vitit të katërt, nëse ka mbrojtur një gjuhë të huaj dhe 2 nëse ka një certifikatë, të paktën ne nivelin C1, me ane të një testi te njohur (<i>evidencat 1.2; 1.3</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Çdo lëndë në këtë program studimi përban qëllimin, objektivat, elementet e kontrollit të dijeve, temat e leksioneve dhe seminareve, literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar, si dhe informacionet që lidhen me numrin e krediteve, numrin e orëve në auditor dhe individuale të studimit, emrin e titullarit, vitin dhe semestrin ku lënda përkatëse zhvillohet (<i>evidencat 2.2; 3.12</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në planet mësimore vjetore të tre viteve të fundit të programit të studimit MSc. (PI) “Drejtësi”, janë të përcaktuara qartë ngarkesa mësimore, orët në auditor të ndara sipas leksioneve, seminareve, praktikave dhe orë të pavarura jashtë auditorit. 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit dhe 1 orë mësimore = 50'. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e secilës lëndë apo secilit modul përcaktohet qartë edhe frekuentimi në leksion dhe ai në seminar, mënyrën e vlerësimit të dijeve (<i>evidenca 2.2</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>UNYT disponon një infrastrukturë shumë të mirë sistemi informacioni në lidhje me informimin e studentëve përsa i përket kriterëve të përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kanalizimi i këtij informacion kryhet në rrugë të ndryshme. Brenda ambjenteve të institucionit gjenden fisha informuese për programin e studimit MSc. (PI) “Drejtësi”. Në rregulloren e programit të studimit shprehen qartë gjithashtu këto informacione. Në fushatën e marketingut si psh. “gjimnaz tour”</p>

	gjithashtu shpërndahet informacion i bollshëm për këtë program studimi, pavarësisht se vitin e fundit ky aktivitet nuk u zhvillua për shkak të COVID-19. Informimi ofrohet edhe nëpërmjet faqes së internetit të UNYT. Gjithashtu, politikat e marketing-ut vazhdojnë edhe nëpërmjet medias së shkruar dhe vizuale. Në programin e studimit “Drejtësi“, përmbahen i gjithë informacioni i nevojshëm për mënyrën e pranimit dhe transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (evidenca 1.6).			
Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Stafi Akademik i programit të integruar angazhohet t’i sigurojë studentëve gjithë informacionin e nevojshëm sipas lëndëve zgjedhore ose të detyrueshme për semestër; secili student në fillim të lëndës personalisht takon një nga pedagogët e programit i cili është edhe këshilltari i tij për të regjistruar lëndët çdo semestër. Gjatë këtij takimi studentëve u vihen në dukje elementët kryesorë procedural që duhen respektuar për të avancuar në proceset akademike si ngarkesa e punës orët në auditor, frekuentimi / ndjekja e programit dhe specifikat e secilës lëndë, duke i kushtuar vëmendje përbërësve të planprogramit të tilla si praktikatat, ushtrimet ose orët laboratorike (evidenca 4.21).			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit MSc. (PI) “Drejtësi” ka qënë gjithmonë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm nga ana e Fakultetit me kadencë semestrale. Në departament diskutohet përmbajtja e programeve të studimit, problemet që kanë dalë gjatë vitit akademik, si edhe risitë e fundit në fushat përkatëse. Syllabuseve u bëhet përmirësim i vazhdueshëm, në përputhje me udhëzimet e reja që ndryshimet eventuale pasi miratohen në departament e fakultet arkivohen në sekretarinë mësimore (evidenca 6.7).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit “Drejtësi” është i organizuar në bazë të sistemit britanik, i cili është i konvertueshëm në ECTS. Programi paraqitet i strukturuar në kurrikulën e lëndëve të përgjithshme (148 BCTS), lëndëve të përqëndruara (188 BCTS), një gjuhë të huaj dhe / ose lëndëve me zgjedhje (60 BCTS), si dhe një cikël lëndësh specializimi

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




	(204 BCTS). Për t'u diplomuar nga programi, studentët duhet të fitojnë minimumi 600 BCTS (300 ECTS) në të katër komponentët në përputhje me shpërndarjen e përbërësve të tyre (<i>evidencat 1.2; 1.3</i>).
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Në programin e studimit MSc. (PI) "Drejtësi", pjesa teorike është e gërshetuar me anën praktike e cila mundëson rritjen e njohurive dhe kompetencave të nevojshme për integrimin sa më të mirë të studentëve në tregun e punës. Për të përshtatur sa më mirë programin me tregun e punës, Fakulteti dhe Departamenti kanë kryer edhe studim tregu që ekzaminon edhe programin duke u interesuar për studentët që mbarojnë edhe për orientimin në tregun e punës (<i>evidenca 1.11.1</i>). Kështu, analiza e tregut shoqërohet edhe me vëzhgimet periodike të evolucionit të kërkesë/ofertës janë bazuar në nevojat që kanë sektori publik dhe privat për burime njerëzore në fushën juridike.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Refaruar lëndëve mësimore, programi i studimit arrin të përmbush objektivat formues të programit studimor me rezultatet të kënaqëshme të të nxënit. Lëndët e ofruara në tërësinë e tyre duken në përshtatje me orientimin e programit, që mbetet i gjerë duke qenë se ka objektiva formuese në tërësinë e së drejtës.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar "Master i shkencave" dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Msc. (PI) "Drejtësi" është i mirë strukturuar ku lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në simetri të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli "master", jo vetëm në nivel kombëtar por edhe më gjerë. Në dosjen e plotë të programit syllabuset dhe planet mësimore përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit. Gjithashtu, Departamenti përgjegjës i këtij programi, kryen analizë vjetore për të parë nëse janë arritur objektivat e programit si dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional për studentët (<i>evidencat 2.2; 6.7</i>).
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Veprimtaritë formuese të programit Msc. (PI) "Drejtësi" janë të ndara në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Lëndët me zgjedhje janë në total 12 ku studentët duhet të zgjedhin 5 prej tyre. Programi është përshtatur që të ofrojë balancën e duhur midis formimit teorik dhe praktik, si edhe mundësitë e avancimit të mëtejshëm profesional ose akademik. Meqenëse "Praktika" përbën një pjesë integrale të programit (<i>evidenca 1.26</i>), aktivitetet e tjera praktike ofrohensipas natyrës dhe aftësive të secilës lëndë. Shembull në këtë kuptim është Gjyqi Imitues që ofron një kombinim të dy apo më shumë aftësishë të lëndëve të ndryshme të programit (<i>evidencat 1.17; 1.17.1</i>).
Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në	Literatura bazë e detyruar dhe ajo ndihmëse për lëndët dhe moduleve e programin të studimit Msc. (PI) "Drejtësi", përditësohen në mënyrë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	të vazhdueshme duke ofruar tekstet dhe publikimet e viteve të fundit. Në secilin syllabus pasqyrohet qartë kjo literature (<i>evidenca 2.3</i>).								
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.	Në rregulloren e këtij programi të integruar është e përcaktuar qartë që përmbajtja e lëndëve dhe moduleve duhet të garantojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët. Përveç kësaj, në syllabuset e lëndëve tek pjesa përmbledhëse dhe rezultatet e të nxënit, përshkruhet objektivi, synimet dhe kompetencat që studentët përfitojnë në fund të kursit (<i>evidenca 1.6</i>).								
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Në kuadrin e përmbajtjes së përgjithshme të programit të studimit në fjalë, GVJ konstaton se vijueshmëria është e mundshme në profesionet juridike të cilat kërkojnë formimin e përgjithshëm juridik në fushën e së drejtës civile dhe së drejtës tregtare, si edhe fushën publike. Studimi i tregut të punës ofruar nga Institucioni mundëson dhe lehtëson edhe më tej aksesin në profesion.								
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Departamenti i Drejtësisë mban kontakte të rregullta me aktorët e tregut të punës qoftë përmes rrugëve institucionale apo edhe atyre personale. Kontaktet institucionale zhvillohen nëpërmjet aktiviteteve të tilla si dita e Karrierës, raportet e Praktikës nga punëdhënësit, aktivitete jashtëshkollore si vizita në gjykatat e ndryshme, etj. Kontaktet personale i referohen veçanërisht stafit të nivelit “senior” të cilët kanë patur një karrierë të caktuar dhe mbajnë kontakte të jashtme. Studimi i tregut të punës tregon vëmendje nga ana e Institucionit kundrejt nevojave të tregut të punës (<i>evidenca 1.11.1</i>).								
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Përmbajtja e lëndëve dhe moduleve në këtë program të integruar MSC “Drejtësi”, krijon një bazë të shëndoshë për vijueshmërinë e mëtejshme të studimeve qoftë për specializim për ciklin e dytë qoftë edhe për një formacion të ciklit të tretë.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Në programin e studimit MSc. (PI) “Drejtësi”, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme është rekrutuar në përputhje me procedurat e parashikuara nga institucioni, me rregulloren e programit të studimit si dhe me kërkesat ligjore të LAL.80/2018, Neni 59, Pika 6 (evidencat 4.1; 4.2). Gjatë tre viteve të fundit, në bazë të verifikimit të kryer nga GVJ, si dhe duke u bazuar në statistikat e raportit personeli akademik/personel akademik ndihmës, departamenti përgjegjës dhe Fakulteti, kanë angazhuar një numër të konsiderueshëm personeli ndihmës për realizimin sa më optimal të këtij programi (<i>takimi me stafin akademik</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Në programin e studimit nën vlerësim, departamenti i Drejtësisë disponon personelin e kualifikuar për përmbushjen e plotë të këtij programi. Të gjithë pedagogët titullarë lëndësh janë me gradën shkencore ose titull akademik. Dosja e secilit pedagog përgjegjës për lëndën apo module që jepet në këtë program studimi dhe që gjendet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, e vërteton këtë evidencë siç u verifikua gjatë vizitës edhe nga GVJ (<i>vizita në zyrën e Burimeve Njerëzore</i>).</p> <p>Rezultojnë të angazhuar në program aktualisht 17 PAE (1 Prof, 4 prof As, 7 Dr, 2 Dr process, 2 msc, 1 LLM) dhe 8 PAK (1 prof as, 6 Dr, 1 Dr. process) .</p> <p>Një pjesë e tyre kanë kryer kualifikime e specia</p> <p>lizime jashtë vendit sipas fushave përkatëse dhe disiplinave që mbulojnë. Departamenti ka të detajuara dhe të përshtatura një bazë të dhënash për personelin akademik që realizon programin e studimit (<i>evidenca 2.1</i>). Ai pasqyron të gjitha ndryshimet që ka personeli akademik efektiv dhe me kontratë gjatë vitit akademik ku zbatohet programi i studimit disponon listën e plotë të pedagogëve akademikë për secilin semestër.</p> <p>Gjithashtu një burim tjetër ku mund të merret informacion për stafin akademik është edhe faqja online e profilit të UNYT.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Pedagogët e angazhuar në këtë program, kanë kualifikimin e nevojshëm i cili përkon me fushën specifike të lëndës apo modulit ku ata japin leksione apo seminare.</p> <p>Përgjithësisht në Departament respektohet ekspertiza në lidhje me lëndët e ofruara dhe të trajtuara nga pedagogët. Studentët e pakët në program ka bërë që në vitet e kaluara të angazhoheshin pedagogë jashtë profilit, por UNYT ka sjellë përmirësime në këtë aspekt sidomos me angazhimin e pedagogëve me kohë të pjesshme, siç i është konfirmuar GVJ-së gjatë vizitës në Institucion (<i>evidence 11 dokumentacioni shitesë</i>).</p>

	<p>Përgjithësisht IAL-ja ka mekanizma për nxitjen e pedagogëve të zhvillojnë më tej më tej punën e tyre kërkimore si nëpërmjet mekanizmave të jashtëm si nëpërmjet trajimeve që vë UNYT ofron (<i>evidence 12 dokumentacioni shtesë</i>). Në veçanëti gjatë vizitës u evidentua rëndësia e projektit Jean Monnet. Rrjeti Jean Monnet fokusohet posaçërisht në aktivitete kërkimore të tilla si organizimi i konferencave rajonale dhe ndërkombëtare, duke marrë përsipër të botoj edhe një libër akademik (<i>takimi me stafin akademik</i>).</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UNYT, disponon personel akademik, ndihmës mësimitor-shkencor dhe administrativ të mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas programit të studimit MSc. “Drejtësi”. Ky institucion ka marrëveshje bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës për realizimin e praktikës profesionale nga ana e studentëve. Aktorë të tjerë përfshijnë gjithashtu dhomat e tregtisë të rajonit dhe qendrat e zhvillimit të biznesit (<i>evidencat 2.3; 2.4</i>).</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimitorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>UNYT, për realizimin e programit MSc. (PI) “Drejtësi”, përveç stafit akademik të kualifikuar, ka në dispozicion edhe një personel ndihmës mësimitor-shkencor i cili angazhohet sipas parashikimeve kontraktuale në realizimin e orëve mësimore, në mirëmbajtjen e mjediseve ku zhvillohen këto orë mësimore. Për shembull, janë në dispozicion sistemet audio-vizive në disa salla ku zhvillohen leksione dhe seminare. Në ZBNJ gjenden edhe dosjet personale të secilit personel ndihmës mësimitor-shkencor. Sa i përket klasave laboratorike, programi nuk i parashikon ato.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>UNYT, nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Zyrës së të Diplomuarve dhe Zyrës së Çështjeve të Studentëve, ka krijuar struktura specifike që ndihmojnë studentët me karrierën e tyre duke reflektuar edhe nevojat e tregut kombëtar dhe atë ndërkombëtar të punës. Disa lektorë me kohë të pjesëshme ofrojnë eksperiencën e tyre nga bota e biznesit. Gjatë periudhës së Pandemisë Covid19, UNYT ka angazhuar në Zyrën e PR dhe Zyrën e Pranimit dy studentë në process diplomimi për të mbështetur zhvillimin e tyre personal dhe profesional evidencat (2.5; 2.6). Gjatë vizitës në Institucion është konstatuar se në përgjithësi ka konsultime midis Departamentit të Drejtësisë, përgjegjëse e programi MSc. (PI) “Drejtësi”, dhe aktorëve të tregut të punës. Është referuar të ketë ekspertë të fushës në ambientet e UNYT për të dhënë sugjerimet e tyre apo të rejat e transformimeve të tregut të punës. Këto propozime shërbejnë për përmirësimin e përmbajtjes së programit. Studimi i tregut të punës është një produkt i kësaj veprimtarie.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion u konstatua se në fund të programit të studimit realizohen konsultime dhe pyetësorë me studentët për çështjet e përgjithshme institucionale, përfshirë edhe programin e studimit. Këshillat dhe sugjerimet e tyre konsultohen dhe reflektohen në funksion të përmirësimit të programit të studimit MSc. (PI) “Drejtësi”. Siç u konstatua edhe gjatë vizitës, mbetet për t’u përmirësuar përfaqësimi dhe efektiviteti i pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese si këshilli i fakultetit dhe senati akademik i UNYT, por ky element justifikohet nga numri i vogël i studentëve në Institucion dhe mundësia e konsultimit direct (takimi me studentët).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni mban gjithmonë kontakte me studentët e diplomuar. Këto marrin prej tyre informacion dhe propozime për përmirësimin e programeve të studimit MSc. (PI) “Drejtësi”. Komunikimi realizohet përmes postes elektronike, mediave sociale dhe vizitave të ndërsjella. (evidencat 1.16; 1.20.1; 3.57; 5.16.1)</p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</p>	<p>Institucioni ka konsoliduar ndër vite bashkëpunimin me institucione kërkimore e shkencore, publike e private dhe zhvillon në mënyrë të vazhdueshme aktivitete të përgjithshme me karakter shkencor, siç i është referuar GVJ-së gjatë vizitës në Institucion. Si rezultat i këtyre bashkëpunimeve dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41/2018 programi mësimor përfshin lëndë të përgjithshme (A), lëndë karakterizuese (B), kurse integruese (C), kurse shtesë (D) dhe detyrime të përfundimtare (E).</p>


<p>Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme</p>	<p>Bashkëpunimi dhe Partneriteti me universitete të tjera, si dhe organizata qeveritare e joqeveritare kanë qenë në qendër të vëmendjes së UNYT këto vitet e fundit, në veçanëti nga momenti i ndryshimit të pronësisë drejt Fondacionit Maarif. Duke qenë një universitet ndërkombëtar, me studentë të pranuar nga 16 kombësi, qëllimi i UNYT giatë gjithë viteve ka qenë mbajtja dhe përmirësimi i një rrjeti të partneriteteve dhe marrëdhënieve kombëtare dhe ndërkombëtare (<i>evidencat 1.29; 1.29.1; 1.29.2; 1.29.3</i>).</p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Standardi II.7 Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në strategjinë e zhvillimit Institucional të UNYT, përcaktohen prioritetet e zhvillimit dhe objektivat kryesorë të studimit. Mund të ishte e udhës një plan zhvillimi strategjik i Fakultetit të Drejtësisë.</p> <p>Programi i Drejtësisë miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Departamenti i Drejtësisë ofron: 1) Master Shkencor, Program i Integruar i Ciklit të Dytë me një kohëzgjatje normale prej 5 vjet studimi (300 ECTS); 2) Master i Shkencave me një kohëzgjatje normale prej 2 vitesh studimi (120 ECTS). Programi i Integruar i Ciklit të Dytë synon të përgatisë studentët për konkurset publike ose për të filluar profesionet private siç mund të jetë Shkolla e Avokatisë (<i>evidencat 1.6; 1.7; 1.8; 1.9</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Realizimi i këtij objekti kërkimor zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushat e edukimit, formimit teoriko-profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera me interes të ndërsjellë. Marrëveshjet e bashkëpunimit pritet të intensifikohen dhe konkretizohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkëmbim përvoja të stafit akademik; - Pjesëmarrje në kërkime dhe projekte të përbashkëta; - Organizim të konferencave apo simpoziumeve shkencore të përbashkëta; (<i>evidencat 1.1; 2.9; 4.7</i>).
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të</p>	<p>Programi i studimit lejon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Studentët kanë arritur edhe të botojnë siç është rasti i botimeve në Albanian Law Journal (<i>evidenca</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	1.16). Nga vizita në Institucion rezulton se këto tipologji aktiviteteve janë në focus të zhvillimit të UNYT, siç tregon edhe prezenca në staf akademik të dy ish-studentëve.			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	UNYT ka arritur të zhvillojë mjaftueshëm politikat e tij mbi këtë pikë, si në rang kombëtar si atë rajonal. Shembuj në këtë aspekt mund të jenë anëtarësia në Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH) apo pjesëmarrja në disa trajnime/procese ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë (evidencat 1.5; 1.14; 6.3; 6.3.1).			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Pavarësisht parashikimeve rregullative të brendshme, GVJ konstatoi se për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore Departamenti është i ndërlidhur financiarisht me veprimtarinë e Institucionit në tërësi dhe të gjitha aktivitetet e ndryshme të zhvilluara mbështeten financiarisht nga institucioni duke qenë se numri i vogël i studentëve nuk mundëson një autonomi të plotë financiare në nivel Fakulteti. Sidoqoftë në fund të vitit, vlerësimi individual duhet të rreflektojë angazhimin konkret rreth kërkimit shkencor i cili lidhet edhe me shpërblime financiare. (takimi me pedagogët; evidencat 1.32; 1.38; 6.10)			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni ka tashmë disa vite që ka konsoliduar lidhjet me universitete të tjera dhe ente të tjera kërkimore shkencore të ndryshme (evidencat 2.12; 2.13; 1.38). Një shembull që u evidentua edhe gjatë vizitës është krijimi i Qendrës së Ekselencës Jean Monnet, e cila si rezultat i projekteve kërkimore, ka realizuar modulën mbi Ligjin për Refugjatët 2017-2020 dhe module mbi Çështjet e Shëndetit në BE Moduli 2019-2022 të cilat lidhen drejt drejtpërdejt me programin e MSc dhe objektivat e kërkimore në fushën juridike.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin	UNYT është angazhuar që të realizojë objektivat e kërkimit shkencor në nivel institucional. Ndër objektivat është rritja në nivel institucional nëpërmjet bashkëpunimit kërkimor brenda dhe jashtë vendit. UNYT gjithashtu ka elaboruar një sistem për matjen e vëllimit dhe cilësisë së rezultateve të kërkimit të aplikuar nga të treja fakultetet që përfshijnë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Asca/Met...

[Signature]

akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	llojin e rezultateve të hulumtimit dhe vlerësimin me pikë (evidencat 1.31; 2.13) Departamenti i Drejtësisë angazhon studentët të hartojnë studime dhe të realizojë objektivat për kompletimin e studimeve. Pavarësisht strategjisë institucionale dhe asaj të ndërkombëtarizimit, sidoqoftë një strategji për zhvillimin shkencor do të fiksonte elementët kryesorë të zhvillimit në këtë fushë.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Gjatë vizitës në Institucion, i është referuar GVJ-së për iniciativa të vazhdueshme në drejtim të konferencave dhe aktiviteteve, si edhe parashikohet një intensifikim iniciativash në këtë drejtim (<i>evidencat 1.16; 1.29; 1.29.1; 1.29.2; 1.29.3</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>UNYT reflekton në Planin Strategjik të institucionit çfarë duhet të arrijnë studentët gjatë studimeve në disiplinën e tyre. Ndër objektivat kryesorë theksohet ofrimi i një cikli gjithëpërfshirës të kurseve të Edukimit të Përgjithshëm, përdorimin e praktikave inovative të mësimdhënies dhe të të nxënit dhe formimin e studentëve në mënyrë krijuese, aktive dhe autonome (<i>evidenca 1.5</i>). Institucioni ofron përgjatë ciklit të studimit jo vetëm leksione frontale por edhe organizime akademike si leksione të hapura, leksione me të ftuar apo seminare thelluese. Ka një platform e-learning për komunikimin pedagog student dhe përgjatë pandemisë, Institucioni ka ndërmarrë masa të menjëhershme për garantimin e vijueshmërisë së rregullt të mësimdhënies.</p> <p>Përsa i përket kriterit të kërkuar, Institucioni nuk ka hartuar një udhëzues për metodat e mësimdhënies, kualifikimin e stafit akademik apo mënyrën e funksionimit të mbikqyrjes së procesit të mësimdhënies. Në këtë aspekt mungon edhe një rregullore e plotë institucionale e cila mund të qartësonte disa nga këto aspekte. Institucioni ka sidoqoftë një dokument programatik ku përcakton politikat për vlerësimin e brendshëm (<i>evidencat 2.13; 6.1; 6.2</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në nivelin institucional si dhe në atë bazë, janë përfshirë kryesisht 3 mekanizma vlerësimi që lidhen me vetëvlerësimin, vlerësimin nga studentët dhe vlerësimet e kolegëve. Në punën e vazhdueshme të personelit, monitorimi i takon njësisë bazë e cila në fund të çdo semestri, nëpërmjet drejtuesit të departamentit përpunon edhe vlerësimin e semestrit. Në UNYT, njësia kryesore e përgjegjëse për monitorimin e sigurimit të cilësisë është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, e cila është e pavarur dhe ka si objektiv kryesor raportimin e cilësisë së mësimdhënies, mësim nxënies, mënyrën e transmetimit dhe përvetësimit të informacionit nga studenti dhe cilësinë e shërbimeve të ofruar ndaj studentit (<i>evidencat 1.9; 6.1; 6.4; 6.5; 6.8; 6.9; 6.10</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të</p>	<p>Institucioni ka arritur të përfshijë aktivisht studentët dhe të bëjë vlerësimin formave të mësimdhënies dhe mësimnxënjes, e performancës së stafit akademik, nëpërmjet kontrolloeve periodike</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>dhe analizave. UNYT konsideron mekanizmat e vlerësimit si instrument për gjetjen dhe korrektimin e mangësive të procesit të mësimdhënies por edhe për rritjen e performances së vlerësimit të stafit (<i>evidencat 6.10; 6.10.1</i>). Në këtë aspekt, studentët vlerësojnë pedagogët në mënyrë anonime dhe ky vlerësim mbetet një nga elementët kryesorë për arritjen e cilësisë akademike, duke u përkthyer në disa raste edhe në masa ndëshkuese kundrejt lektorëve, përfshi edhe largimin nga kursi apo vendi i punës (<i>takimi me stafin akademik dhe studentët</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Sa i përket pedagogëve, ata u nënshtrohen katër formave të vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Raporti i Vlerësimit të Studentëve 2- Raporti i Vlerësimit nga kolegët, 3- Raporti i Performancës së Vlerësimit Individual dhe 4- Raporti i Transparencës së Notës. <p>Këto mënyra vlerësimi u evidentuan edhe gjatë vizitës e pasqyrohen edhe në Raportin Vjetor të Departamentit (<i>evidencat 1.9; 6.1; 6.4; 6.8; 6.9; 6.10</i>). Këto rezultate analizohen më tej në rang Fakulteti.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Metoda e përdorur për mbledhjen e informacionit nga studentët, është anketimi. Raportet e Vlerësimit të Studentëve që burojnë nga ky anketim, organizohen në bazë lënde dhe administrohen një herë në semestër për stafin akademik ekzistues dhe dy herë për semestër për stafin e ri. Në këto raporte, studentët japin vlerësime për pedagogët e tyre për sa i përket cilësisë së mësimdhënies, aftësive dhe përgjegjshmërisë së pedagogëve, si edhe vlerësimit ose sugjerimeve të tyre në lidhje me aspektet e lidhura me kursin, programin e studimit dhe universitetin në përgjithësi. Studentët gjithashtu plotësojnë një pyetësor pas diplomimit ose ndërprerjes së studimeve (<i>evidencat 4.1; 4.2</i>). Nga ana tjetër, vlerësimi i kolegëve si ekspertë të fushës konsiston në vlerësimin e aftësive, performancës dhe cilësisë në mësimdhënie (<i>evidenca 6.5</i>). Të gjitha këto forma vlerësimi i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve, programeve dhe Universitetit; por edhe gjithëpërfshirjen e gjithë aktorëve për përmirësimin e programit të studimit.</p> <p>Përsa i përket garantimit të cilësisë, UNYT ka krijuar një Komision të Përhershëm për Standardet e Sigurimit të Cilësisë të Institucionit i cili zbalon mekanizma dhe prodhon raporte të brendshme për sigurimin dhe garantimin e cilësisë (<i>evidencat 6.1; 6.2; 6.3; 6.3.1; 6.3.1</i>). Zyra e Sigurimit të Cilësisë, ka bashkëpunime ndërkombëtare ku veçohet ai me SUNY.</p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Programi i studimit MSc. (PI) "Drejtësi" në FDSHS, garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional të studentëve, nëpërmjet leksioneve që janë baza teorike dhe seminarëve, si edhe aktiviteteve të praktikave profesionale që zhvillohen një modul të veçantë, por edhe për secilën lëndë. Përveç këtyre formave, institucioni organizon leksione të hapura me të ftuarit e jashtëm apo edhe të vetë pedagogëve të brendshëm për tematika që lidhen me fushën e programit të studimit të drejtësisë. Procesi mësimor, në programin e studimit nën vlerësim realizohet duke kombinuar leksione, seminarë, prezantime, detyra kursi, trajnime specifike, leksionet e hapura, si edhe disa projekte ose prezantime të hulumtimeve vetjake . Metodot e transmetimit të njohurive tek studentët kanë qenë përgjithësisht adekuate/bashkëkohore dhe kjo flet për përpjekje serioze nga ana e stafit të UNYT në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Gjatë procesit mësimor, stafi akademik përdor mjete bashkëkohore të mësimdhënjes, siç janë mjetet audio-vizive. Cdo sallë auditori është e pajisur e video-projektor çfarë mundëson një komunikim më interaktiv (<i>evidencat 1.17.1; 1.39; 2.9; 3.3; 5.15; 5.22</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik përdor metoda mësimdhënie dhe mësimnxënie për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve. Në këtë aspekt, mund të përmenden metodat vizuale apo teste me shkrim ose me alternativa të përshtatshme edhe për studentët që kanë një diversitet të ndryshëm nga të tjerët të cilët mund të përthithin ose të kryejnë provimet lehtësisht. Këto metoda janë të shprehura edhe në syllabusët e programit. Gjithsesi, Institucioni është përgjegjës dhe i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij nga çdo sugjerim që vjen qoftë nga studentët qoftë edhe nga subjektet e tjera publike dhe private. UNYT siguron mundësi të barabarta pranimi tek studentët pavarësisht racës, fesë, seksit, origjinës etnike, orientimit seksual, statusit personal dhe paaftësive fizike (<i>evidencat 1.1; 4.7</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në</p>	<p>Në RVB si edhe gjatë vizitës është afirmuar se Institucioni i krijon lehtësira personelit me qëllim arrijten dhe ndjekjen e kualifikimeve të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>tyre akoademike dhe ka një procedurë për mbështetjen e stafit për pjesëmarrje në evente akademike brenda dhe jashtë vendit. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit por periudhat e shkëmbimit që do të ndikonin në përmirësimin e personelit mbeten të limituara. Një mundësi në funksion të këtij kriteri do të ishte edhe mundësia e trajnimit të stafit akademik mbi nevojat e ndryshme për të arritur rezultatet e pritshme në fushën akademike. Institucioni ka ofruar evidencë shtesë mbi këtë pikë, por mundësitë mbeten të limituara (<i>evidenca 12 dokumentacioni shtesë</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik është kompetent në lidhje me programet e studimit dhe përgjithësisht në përputhje me fushën kërkimore të lektorit me lëndën specifike që ai mbulon megjithëse syllabusi është i qartë dhe korrekt. Përdoren metoda alternativa të mësimdhënies si edhe aktivitete stimuluese të studentëve (<i>evidencat 1.17; 1.18; 1.40</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Ndër metodat e mësimdhënies alternative përdoren edhe risi të tilla si lojërat me role, <i>moot court</i>, lektor të ftuar, ese kërkimore, si edhe shqyrtimi i rasteve praktike si analiza e praktikës gjyqësore. Për më tepër, pedagogët e UNYT përdorin platforma plotësuese si Turnitin për grupe ushtrimesh praktike, projekte individuale dhe në grupe si edhe kontrollin antiplagjaturë (<i>evidencat 1.17; 1.18; 1.40</i>)</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Përdoren gjatë mësimdhënies metoda kontemporane dhe sallat janë të një niveli cilësor qoftë për zhvillimin e seminareve, diskutimeve apo për prezantimin e projekteve (<i>evidencat 3.5; 3.6</i>).</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga takimi me studentët rezulton se respektohet individualiteti i studentit dhe dëshira apo përqasja e tij ndaj temave të caktuara qoftë në zgjedhjen e temave për detyra kurse qoftë në punën me projektet e kursit në grup.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.3
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Programi i studimit MSc. (PI) “Drejtësi” realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. Sallat në të cilat zhvillohet procesi mësimor dhe shkencor janë objekte të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare. Korpusi i UNYT është i vendosur në një ndërtesë shtatë katëshe në një zonë mjaft të gjelbëruar dhe larg ndotjes, qoftë edhe asaj akustike. Institucioni ka si pjesë të tij mjedise sportive (<i>evidencat 4.10; 4.11; 4.12</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ky program studimi zhvillohet në hapësira të përshtatshme, mjaft cilësore dhe të mirëmbajtura. Ambjentet si salla leksionesh, salla seminaresh, biblioteka apo facilitate të tjera janë të pajisura me logjistikën e duhur mësimore si pc, projektor dhe janë me komfortet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor. Biblioteka është e hapur gjatë ditës dhe studentët mund të aksesojnë kopjet e nevojshme për studimet e tyre (<i>evidencat 4.12; 4.15;4.16; 4.17; 4.19</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Laboratorët ndihmës për personelin akademik dhe studentët janë të përshtatshëm. UNYT ka për programin mësimor platformën Web që është e aksesueshme nga pedagogët dhe studentët (E-Learning). I gjithë kampusi UNYT ka Wi-Fi jo vetëm në laboratorë, por edhe në klasa, si dhe në bibliotekë. Për më tepër, vitin e kaluar, gjatë situatës pandemike, Institucioni ofroi disa klasa përmes Zoom në ambjentet e UNYT duke krijuar kushtet e nevojshme për zbatimin e një ore të rregullt mësimore (<i>evidenca 4.12</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura e paraqitur në syllabuse (ajo e detyrueshme dhe fakultative) gjendet me lehtësi në bibliotekën e UNYT. Kjo literaturë në disa kopje dhe është në dispozicion të studentëve. Rezultojnë abonime në biblioteka digjitale dhe ato të aksesueshme janë vetëm bibliotekat dixhitale pa pagese por link për to nuk ka në web-in e UNYT (<i>evidence 4.13</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka garanton një numër të kënaqshëm botimesh. Nga vizita në institucion dhe biseda me stafin dhe studentët kjo strukturë garanton aksesin e teksteve kryesore të propozuara nga lektorët. Mënyra e pasurimit të bibliotekës është e institucionalizuar me kërkesa drejtuar njësisë bazë në funksion të titujve të librave për të cilat kanë shprehur interes kryesisht lektorët. Ka 12 terminale kompjuterike për aksesin e materialeve elektronike dhe dy tavolina pune në grupe (<i>evidence 4.13</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët</p>	<p>Për realizimin sa më të mirë të mësimdhënies dhe mësimnxënies, UNYT ka vënë në shërbim të personelit akademik dhe studentët, libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin</p>




aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	e studimit MSc. (PI) “Drejtësi”. Siç i’u referua GVJ-së këto konsistojnë në bazat e të dhënave ekzistuese ProQuest, EBRARY, JSTOR, Emerald Insight dhe përmes një marrëveshje me botimet e Arsimit të Lartë të McGraw Hill.		
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Infrastruktura laboratorike dhe postet e punës me PC janë në nivel të duhur dhe plotësojnë nevojat e studentëve.		
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	UNYT përdor platformën online E-learning në të cilën aksesohet në mënyrë të pavarur nga çdo student dhe pedagog. Nga marsi i vitit 2020, pas shpërthimit të pandemisë Covid-19, Institucioni përshtati mësimdhënien on-line (Platforma e Zoom). Gjithashtu provimet u u zhvilluan nëpërmjet qendrës të e-Provimit duke siguruar të gjitha lehtësitë për studentët duke patur edhe në vëmendje standardet etike gjatë periudhës provimit. Për t’u përshtatur me situatën e re u zhvillua gjithashtu një trajnim i brendshëm (<i>evidencat 3.7; 3.8; 3.9; 5.2</i>)		
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Studentët dhe personeli akademik përdorin rregullisht sistemet e komunikimit të brendshëm për të aksesuar dokumentacionin elektronik si syllabuset, leksionet, detyrat e kursit, et. Mjeti më i përdorur rezulton të jetë e-maili. Rezulton të ekzistojë një platformë <i>e-learning</i> (https://unyt.edu.al/index.php/e-learning-platform/), e cila është Zoom, kundrejt pagesës periodike (<i>Evidenca 2.1, tabela 17</i>).		
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Duke u nisur nga numri i studentëve personeli akademik është i mjaftueshëm për ti ndjekur ato efektivisht dhe për ti udhëhequr në punimet e diplomës. Manualit të Studentit (<i>students’ handbook</i>) përcakton në mënyrë të qartë informacionin në lidhje me temën e diplomës. Gjithashtu në fillim të semestrit të nëntë studentëve u dërgohet një email me rregullat e veçanta që duhet të ndjekin në këtë proces. Në fillim të vitit të pestë studentët marrin propozimin e tezës, të cilin duhet ta paraqesin në fund të semestrit të nëntë gjithmonë të ndjekur nga një pedagog i kualifikuar i fushës (<i>evidencat 1.6; 1.7</i>).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni ngrre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në institucion është ngritur dhe funksionon, që në fillimet e tij, një Zyrë për Sigurimit e Cilësisë, si njësi përgjegjëse për të ndihmuar dhe kontrolluar në garantimin e përmbushjen e standardeve në këtë drejtim. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fundviti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërbën për të pasur një pasqyrë të fakultetit dhe për tu përmirësuar në vazhdimësi (<i>evidencat 6.3; 6.3.1; 6.3.2; 6.7; 6.15</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia që menaxhon programin dhe njësia kryesore ka funksionin jo vetëm të ofrojë programin por edhe mbikqyrjen e zhvillimit të tij sipas standarteve të cilësisë. Kjo mbikqyrje zhvillohet me anë të kontrolleve periodike të strukturave drejtuese, miratimit të syllabuseve, etj sipas përcaktimve në Statut. Rregullorja e përgjithshme institucionale duhet zgjeruar dhe përshtatur sipas standardeve të duhura për të rregulluar edhe këto aspekte.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale mbështet zhvillimin e mësimdhënies nëpërmjet metodave inovative dhe shërbimet IT. Kjo pasqyrohet në Misionin e mëparshëm të UNYT-së dhe Planet Strategjike dhe Zhvillimit për periudhën (2017-2023), si edhe në Planin Strategjik e ri të rishikuar ku parashikohet Digjitalizimi në Mësimdhënie dhe Mësimnxënie (<i>evidenca 1.5 qëllimi 6</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në tërësinë e aktiviteteve të UNYT një vend të rëndësishëm zë rritja e vazhdueshme e nivelit kërkimor-shkencor të pedagogëve me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit dhe përfshirja e tyre në projekte të ndryshme të sipërmarrjeve private, institucioneve shtetërore, dhe organizmave ndërkombëtare trasmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Më konkretisht, siç iu referua GVJ-së gjatë vizitës, për të rritur cilësinë e mësimdhënies në disa kurse, u përfituan Fonde të reja të BE-së: Çështjet e Shëndetit të BE-së, E Drejta e Refugjatëve dhe E Drejta e BE-së në Sistemin Ligjor Shqiptar (<i>takimi me përfaqësues të Zyrës për kërkim dhe menaxhim projektesh</i>)</p>




<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse kanë si qëllim rritjen dhe mbështetjen ndaj personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Në kuadër të projekteve të ndryshme të bashkëpunimit por edhe në kaudër të marrëveshjeve që ka me institucione të tjera ka patur mundësinë e rritjeve të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies dhe përdorimit të metodave të reja në mësimdhënie. Megjithatë strukturat përgjegjëse nuk trajtojnë në mënyrë të vazhdueshme personelin me këtë qëllim. Mbetet në përgjegjësinë e personelit akademik që të gjejë mundësitë më të mira që të për rritjen e aftësive dhe metodat e reja për përmirësimin e aftësive akademike.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Stafi akademik dhe mbështetës në programin MSc (PI) në Drejtësi janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit, si edhe për monitorimin e korrektësisë dhe cilësisë në zbatimin e programit nëpërmjet vlerësimit të studentëve dhe vlerësimit të kolegëve .</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie që përfshijnë leksione të hapura, përfshirje të studentëve në seminare akademike, simulim të çështjeve gjyqësore, studime të rasteve që paraqesin shembuj të jetës reale, role play, diskutime në grupe, mësim i bazuar në projekte, hulumtime, aktivitete dinamike si Gjyqe Imitues, ctj.. UNYT ka të angazhuar personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve praktike. Përgjegjësit e departamenteve apo kolegë <i>senior</i>, me anë të verifikimeve në ambjentet e mësimdhënies apo takimeve specifike vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies duke raportuar më tej pranë dekanit.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Në saj të bashkëpunimeve të gjera institucionale, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale ka angazhuar herë pas here lektorë të jashtëm dhe të ftuar, specialistë të fushave të ndryshme të së drejtës, të cilët sjellin praktikën më të mirë dhe të rejtat më të fundit të shvillimeve praktike. Nxitja e bashkëpunimeve dhe partneriteteve ka rritur cilësisht performancën e stafit por edhe ngritjen në një nivel më të lartë transmetimin e dijeve tek studentët (praktika të reja mësimdhënie, potencialisht mjete të reja mësimdhënie, metoda të reja të përfshirjes së studentëve në diskutim. UNYT realizon leksione të hapura me lektorë që jenë personalitete të fushës në Shqipëri por edhe lektorë të ftuar nga universitete të huaja. Në lidhje me këtë të fundit UNYT ka një eksperiencë mjaft të mirë dhe të pasur. Keto shkëmbime eksperiencë i shërbejnë edhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë e mësimdhënies dhe</p>




	përmirësimin e saj si edhe përdorimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies (<i>evidence 1.12</i>).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit MSc. (PI) Drejtësi i ka të përcaktuara në rregullore të programit mënyrën e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentit. Gjithashtu, studentët njihen që në fillim të ciklit të studimeve me këto kriteret edhe nëpërmjet prezantimit të syllabuseve që bëhen nga pedagogët e lëndëve të programit. Format e kontrollit të vazhdueshëm të studentit, janë:</p> <p>30% provim afatmesëm 40% provim përfundimtar 20% projekt 10% pjesëmarrje aktive.</p> <p>Të gjithë studentët marrin syllabuset në fillim të kursit (<i>evidencat 1.10; 2.2; 2.1</i>)</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në këtë program studimi, pedagogu titullar i lëndës para fillimit të çdo semestri informon studentët për tematikat që do të zhvillohen, qëllimin si dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve (<i>evidencat 2.2; 3.12</i>).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Bazuar në rregulloret e studimeve si dhe në syllabuset e lëndëve apo moduleve janë përcaktuar qartë format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që studenti ka përvetsuar gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Detyrat e kontrollit janë elementë të vlerësimit të vazhduar të nivelit të dijeve. Pjesë e vlerësimit janë dhe projekte kursi ose detyra kursi në varësi të modulit. Kjo u jep mundësinë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	studentëve të demonstrojnë kompetencat e tyre në mënyra të ndryshme. Rregullat e testit përfundimtar u dërgohen studentëve të paktën një javë përpara. Sipas kursit, lloji i testimit ndryshon me shkrim, me gojë, apo me kompjuter nëpërmjet testeve me alternative (evidenca 2.2).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i studentëve lidhur me dijet, njohuritë e marra dhe aftësitë profesionale për modulin përketes zhvillohet i ndarë në dy faza: a. Kontrolli i fazës së parë përfshin kontrollin gjatë procesit mësimor, ku kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, ushtrime, detyra me shkrim (provime ndërmjetëse, detyrat e kursit, praktikën mësimore, etj). b. Kontrolli i fazës së dytë përfshin kontrollin nëpërmjet provimit përfundimtar. Përvec dy provimeve, provimi ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar, ekziston edhe një përbërës i pjesëmarrjes aktive (në përgjithësi, 10%, në disa raste përjashtimore 20%). Për më tepër, në javën e 14-të zhvillohet zakonisht një prezantim.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Një nga avantazhet e platformës online të përdorur nga UNYT sidomos gjatë pandemisë, është gjetur mundësia e zhvillimit të testeve online. Zhvillimi i këtyre testeve, përmes kriterëve të parapërcaktuara nga pedagogu i lëndës, si në kohë ashtu dhe në vlerësimin e përgjigjes së studentit, kanë mundësuar realizimin e një testimi transparent dhe objektiv. Sa i përket sistemit antiplagjaturë, kjo qendër provimesh ka përdorur sistemin Turnitin, që është edhe sistemi kryesor për ruajtjen e integritetit në ppunën akademike (evidencat 1.46; 3.5).
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë	Testimi i njohurive zhvillohet nëpërmjet tezave të provimit, të cilat hartohen nga titullari/pedagogu i modulit sëbashku me asistentin e tij (nëse ka). Anëtarët e komisionit të provimit të modulit mbikqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.

përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet nëpërmjet tezave të provimit, të cilat hartohen nga titullari/pedagogu i modulit së bashku me asistentin e tij (nëse ka) dhe zhvillohen sipas specifikave dhe parashikimeve të lëndës, në mënyrë anonime me sekretim kur ky modalitet parshikohet si i tillë. Në të tilla raste përgjegjëse është sekretaria mësimore, e cila ndjek ecurinë e provimeve, bën sekretimin e tezave për secilin student. Provimet zhvillohen në ambiente të posaçme dhe të përshtatshme për realizimin e tyre, qoftë edhe online për shkak të Covid-19. Ato monitorohen nga Komisioni i provimit, i cili mbikqyr gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në perfundimin e provimit, duke evituar çdo shkelje të rregullores të Fakultetit (<i>evidence 3.13</i>).
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi perfundimtar i studentëve konsiston në vlerësimin e e vazhdueshëm dhe vlerësimin e provimit të zhvilluar për lëndën në përfundim të semestrit. UNYT disponon një platformë të dedikuar për t'iu dhënë studentëve mundësinë të verifikojnë notën e tyre. Secili provim ka komente për çdo pyetje. Studentët kanë të drejtë të kërkojnë komentet dhe t'i shohin ato. (<i>evidencat 1.10; 3.14</i>)
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Kodi i Nderit të Studentit (<i>evidenca 3.15</i>), i cili përmban politikën e institucionit mbi plagjiaturën, dhe platforma Turnitin janë instrumentat kryesorë në respektimin e korrektësisë dhe etikës gjatë zhvillimit të provimeve. Në nivel procedural Institucioni përcakton qartë mënyrën e zhvillimit të provimit si edhe përgjegjësitë e komisionit monitories që ka përgjegjësinë e zbatimit të rregullave.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi dhe kontrolli i njohurive dhe aftësive profesionale të çdo studenti realizohet në mënyrë të drejtë dhe bazohet mbi meritën e secilit prej tyre. Në të gjitha format e provimit përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, të cilat konvertohen në notë. Rezultatet e provimit përfundimtar u bëhen të njohura studenteve nga komisioni brenda një jave.
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Mbas shpalljes së rezultateve të provimit dhe hedhjes së tyre në sistem studentët kanë mundësinë e leximit të notës së tyre në sistem ose marrjes së rezultatit në sekretarinë mësimore. Në vijim studentët kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi nga ana e pedagogut, ose të kërkojnë rishikimin e provimit. Pedagogu i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me komentet. Në

	rast student nuk bindet në lidhje me provimin, departamenti do të formojë një komision ad hoc për të kontrolluar provimin.		
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Në rastin e krijimit të një komisioni ad-hoc, procesi fillon me një kërkesë me shkrim të studentit dhe procesi menaxhohet nga përgjegjësi i departamentit. Sidoqoftë, si nga RVB, si nga takimet është verifikuar se kjo mbetet një procedure e jashtëzakonshme dhe vetëm pak studentë kanë kërkuar zyrtarisht këto rivlerësime (evidencat 1.10; 1.30).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7

Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Planet mësimore dhe programet e lëndëve kanë synim kryesor aftësimin teorik dhe praktik të studenteve. Departamenti që është përgjegjës përfshin në analizën vjetore edhe atë të syllabuseve, sipas procedurave përkatëse dhe në kohë të mjaftueshme përpara fillimit të procesit mësimor, në mënyrë që të reflektohen ndryshimet e nevojshme. Syllabusi paraqitet nga titullari i lëndës, i cili ka të paktën gradën “Doktor i Shkencave”. Analiza e syllabusit merr parasysh të gjithë elementët e tij thelbësorë duke u ndalur në përputhjen e plotë të tij me planin mësimor, bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi, aktet rregullatore të miratuara nga IAL-ja si dhe kërkesat të tregut të punës. Lëndët ndahet në dy pjesë, në pjesën e parë jepen njohuri të përgjithshme, në pjesën e dytë jepen aftësi të veçanta duke përfshirë në disa raste edhe elementë kërkimorë.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Në aspektin formal, në syllabuset e lëndëve për programin e studimit “Drejtësi” gjenden të pasqyruara elementët në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, duke theksuar përshkrimin dhe objektivat e lëndës; format e mësimdhënies dhe të kontrollit e vlerësimit të studentëve për lëndën, përmbajtjen e temave dhe çështjet kryesore brenda tyre dhe literaturën e detyruar dhe ndihmëse. Përgjatë programit, lëndët ndërlidhen me njëra tjetrën në kuptim logjik drejt thellimit dhe specifikimit të dijeve, duke ofruar kryesisht lëndë të përgjithshme në tre semestrat e parë e në vijimësi, me lëndët më të specializuara.

<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Ne fund te lëndës, testohen aftësitë e fituara nga studenti nëpërmjet testimi me shkrim ose me gojë, një temë projekti, rezultatet nga udhëheqesi i praktikës profesionale dhe të gjitha këto grumbullohen në kompetencat e aftësitë personale të studentit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përmbylljen e çdo kursi, personeli akademik analizon realizimin lëndëve/moduleve dhe evidenton çështjet më të rëndësishme që lidhen me temat e këtij kursi. Personeli akademi bën një përmbledhje të provimit, zbatimin e tyre në praktikë si dhe u demonstron atyre raste praktike studimi nga eksperiencia e tij. Analizimi i programit në përfundim të tij, temave të leksioneve e seminareve dhe javëve mësimore të përcaktuara sipas planit kalendar, bëhet me qëllim evidentimin e problematikave që lidhen me realizimin e tyre si edhe orientimin e studentëve. Kjo i shërben fokusimit si në përvetësimin e përmbajtjes së programit, ashtu dhe për tu orientuar më mirë në lidhje me përmbylljen e programit me provimin përfundimtar, sipas përcaktimeve aktet rregullative të brendshme përkatëse (<i>evidencat 1.10; 3.13</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Mënyra kryesore e përfshirjes së stafit akademik jashtë structures së programit të studimit është përmes konferencave ndërkombëtare dhe kombëtare (<i>evidencat 1.41; 1.46; 1.47</i>). Si shembull është referuar gjatë vizitës në vitin e kaluar akademik stafi akademik i Departamentit të Drejtësisë është angazhuar në organizimin e dy konferencave online dhe të seminarit akademik “Integriteti në Akademi”.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në fillim të vitit, Përgjegjësi i Departamentit orienton shpërndarjen e ngarkesës akademike sipas specializirnit dhe kompetencave të stafit akademik. Në procesin e mësimdhënies përdoren mjete moderne të teknologjisë së informacionit si projektorë e kompjutera, ndërkohë që organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale. Në zbatim të rregullores së programit të studimit, personeli ndihmës mësimor angazhohet në përgjithësi në ndihmë të procesit mësimor. Të gjithë këto kompetenca të fituara studenti i demostron në praktikën që ai zhvillon në institucionet që IAL ka marrëveshje si dhe në orët e seminareve apo gjyqeve simuluese që nuk mungojnë në praktikën e mësimdhënies të departamentit të drejtësisë.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Institucioni nxit bashkëpunimin shkencor dhe mësimor midis studentëve për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Rritja e këtij bashkëpunimi bëhet si në ndërtimin e punës në grup për tema dhe probleme të caktuara të praktikës gjyqësore ashtu dhe duke diskutuar elemente të veçantë të lëndëve që synojnë aftësimin profesional në probleme të ngjashme.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Gjatë procesit mësimor, personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të së drejtës dhe identifikon momentet dhe fushat që kanë nevojë për më tepër informacion dhe studim të metejshëm. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore, por stimulohen edhe forma shprehimore alternative si ato artistike.</p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Studentët e këtij cikli studimi realizojnë objektivat e kërkimit kryesisht nëpërmjet diplomave ose mikrotezave që realizojnë. Në disa raste punimet e studentëve realizohen në konferenca të organizuara nga UNYT apo institucione partnerë. GVJ-së i është referuar se Institucioni ofron mbështetje financiare për punën shkencore, si financim i plotë ose i pjesshëm për pjesëmarrjen e pedagogëve e studenteve në konferenca shkencore jashtë vendit, realizimin e botimeve në revista me faktorë impakti apo trajnime për formate të veçanta (<i>evidenca 4.23; takimi me pedagogët/studentët</i>).</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Institucioni dhe pedagogët e programit të studimit nën vlerësim, për realizimin sa më të mirë të mësimdhënies, kanë krijuar ura bashkëpunimi me institucione të tjera homologe të fushës së jurisprudencës apo me organizma të tjerë publikë dhe privatë siç janë gjykata, studiot ligjore, zyra Kombëtare Erasmus në Tiranë, Agjencia për Kërkime, Teknologji dhe Inovacion, apo programet e shkëmbimit Erasmus si dhe Programet MEVLANA (<i>evidenca 1.12</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.8</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Informacioni lidhur me realizimin e provimit të formimit u behet i ditur studenteve përmes strukturave përkatëse mësimore, në fillim të vitit të pestë, ku studentët marrin edhe propozimin e tezës master. Në semestrin e fundit, studentët fokusohen në kërkime shkencore, si edhe praktika profesionale (<i>evidenca 1.47</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet</p>	<p>Strukturat përgjegjëse si Departamenti, Sekretaria Mësimore si dhe të gjithë pedagogët udhëheqës, asistojnë studentet gjatë procesit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	diplomimit. Sipas RVB studentët dhe mbikëqyrësit duhen të takohen te paktën një herë në javë (<i>evidencat 1.3; 1.6; 1.10</i>).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Kriteret, standardet si dhe procedurat e testimit final si dhe diplomimit, janë të pasqyruara në rregulloret përkatëse dhe u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet broshurave dhe mjeteve elektronikë (<i>evidencat 1.23; 3.11</i>).
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Në fillim të vitit të pestë, studentët njihen me të gjithë stafin akademik dhe specializimet e tyre, që të krijojnë një ide më të mirë të temave që stafi akademik mbulon. Studenti ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë si dhe udhëheqësin e tij. Studenti gjithashtu ka lirinë të propozojë vetë një tezë diplome në rakordim me udhëheqësin përkatës.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamentet i Drejtësisë asiston studentët në hartimin e diplomës, kontrollit të literaturës brenda fushës së studimit. Pedagogët punojnë ngushtë me studentët për aftësimin e tyre në metodat e kërkimit shkencor. Studentëve iu vihen në dispozicion mjediset e Universitetit si dhe të institucioneve të tjera publike apo private me të cilat UNYT ka marrëveshje me qëllim mbështetjen e punës së tyre kërkimore. Shpenzimet lidhur me realizimin e temës së diplomës i merr përsipër studentin, ndërsa institucioni ka për detyrë t'i ofrojë bazën e materialeve studimore si libra, kërkime shkencore, laboratore etj.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i Diplomës kontrollon në mënyrë të imtësishe punën e secilit student duke dhënë vërejtje me shkrim për çdo fragment pune si dhe sugjeron literaturën e nevojshme për t'u konsultuar më qëllim arritjen e një produkti të thelluar studimesh. Pedagogët që udhëheqin studentët për të përgatitur tezën përfundimtare janë njohës të mirë të fushës, me eksperiencë në akademi dhe me aktivitet kërkimor e botues. Udhëheqësit kanë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza. Pas përzgjedhjes së fushës së studimit, problemit kërkimor dhe formulimit të temës së studimit, studentin harton se bashku me udhëheqësin një skemë që përfshin të gjitha hapat, nga fillimi deri në përfundimin e punimit. Para mbrojtjes, pas paraqitjes përfundimtare dhe kontrollit antiplagjaturë në Turnitin, udhëheqësi miralon diskutimin e tezës.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë	Në fund të secilës lëndë, studentët vlerësohen me një notë që varion nga 0 në 100. Lënda kalohet me arritjen e së paku 40% të pikëve. Studentët mund të mbrojnë tezën e tyre vetëm nëse i kanë kaluar të gjitha kurset. Teza përfundimtare ndahet ndërmjet tezës (70%) dhe praktikës (30%).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Diploma shoqërohet me suplementin e diplomes. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë si edhe është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimeve të Studenteve (QSHA). Shtojca e Diplomës jep gjithë informacionin e kërkuar për programin e Drejtësisë, si dhe rezultatet e të nxënit dhe aftësitë që merren me përfundimin e secilit program (<i>evidencat 1.22; 1.23</i>).</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, institucioni ka si detyrë t'i verë në dispozicion studentëve një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas vitit akademik përkatës. Gjithashtu institucioni përgatit një pergamenë zyrtare që GVJ konstatoi gjatë vizitës me disa shembuj (<i>vizita tek sekretaria mësimore</i>).</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen</p>	<p>Institucioni ruan dokumentacionin e studentit dhe paraqet informacion për çdo student nëse kërkohet. Zyra e Regjistrimeve është e pajisur në përputhje me standardet specifike të funksionimit të saj dhe përmbush të gjitha kriteret për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit shkresor dhe online. Sipas nevojës, Zyra e Regjistrimeve bashkërendon punën me Sekretarinë Mësimore dhe bën të mundur paraqitjen e informacionit të kërkuar nga ana e vetë institucionit apo vetë studentit (<i>evidencat 3.16; 3.17</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	
			<p>X</p>	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi IV.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi më së miri se IAL disponon të dhëna të plota në lidhje me personelin e angazhuar për këtë program studimi (<i>Evidenca "Stafi akademik i</i></p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al




<p>programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p><i>programit”; Evidenca 2.1 “Tabelat”, tabelat 1, 7 dhe 8 si dhe evidencat 2.1.1, 2.1.2 e 2.1.3).</i></p> <p>Të dhënat janë mbajtur në mënyrë të detajuar sa i përket angazhimit të secilit anëtar të personelit akademik për çdo semestër dhe vit akademik (<i>Evidenca 2.1 “Tabelat”, tabelat 4 dhe 6).</i></p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, konsultoi në zyrën e burimeve njerëzore, sipas një përzgjedhjeje rastësore, dosje personale të stafit akademik si me kohë të plotë ashtu dhe të pjesshme, nga ku rezultoi që të dhënat e administruara ishin të plota dhe përfshinin kopje të legalizuara të: jetëshkrimit, dokumentit të identifikimit, diplomës universitare dhe të listës së notave, diplomave dhe dokumenteve të tjerë që vërtetojnë gradat dhe titujt e fituar, kualifikimeve të ndryshme, librezës së punës dhe asaj shëndetësore e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, etj. (<i>Evidenca shtesë “Minutat e vizitës”</i>).</p> <p>Institucioni ka të administruara të dhëna të plota si për personelin akademik, ashtu dhe për personelin ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në aktet e brendshëm të UNYT janë parashikuar kushtet, kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur lidhur me rekrutimin e personelit akademik në përputhje mesa parashikon neni 64 i ligjit Nr. 80/2015. Konkretisht, njësia bazë identifikon dhe propozon nevojën për një vend të lirë. Këshilli i Fakultetit i përcjell në vijim Rektorit propozimin për vendet e lira, për miratimin e një nevoje të tillë. Parashikime të veçanta janë bërë dhe drejtuesin e njësisë kryesore, njësisë bazë, zv. Rektorin dhe pozicionin profesor.</p> <p>Të gjitha aplikimet rishikohen nga komisioni <i>ad hoc</i> i ngritur në rang fakulteti. Propozimi i kandidatëve në listën e shkurtuar të komisionit <i>ad hoc</i> duhet të miratohet nga Rektori dhe Bordi i Administrimit për drejtuesin e njësisë kryesore, njësisë bazë, zv. Rektorin dhe pozicionin profesor; nga rektori dhe administratori i universitetit për personelin tjetër akademik.</p> <p>Pas miratimit të kushteve dhe kohëzgjatjes së punës, rektori nënshkruan në vijim marrëveshjen për pozicionin që i është caktuar punonjësit. Çdo shtesë ose ndryshim i kushteve të punës bëhet me anë të një aneksi të kontratës ose me zëvendësim të kontratës së punës (<i>Evidencat 1.1 “Statuti”, neni 41; Evidenca 4.1 “Human Resources Policy Document”, f. 7-8).</i></p> <p>Në mënyrë të detajuar, procedurat për rekrutimin e personelit akademik shtjellohen dhe zërthehen në rregulloren për rekrutimin, e cila vjen në zbatim të ligjit të aplikueshëm në fushën e arsimit të lartë si dhe të akteve të brendshme të universitetit (<i>Evidenca 4.2 “Recruitment Procedure”</i>).</p> <p>GVJ gjen me vend të rekomandojë hartimin dhe miratimin e rregullores së përgjithshme të institucionit (e cila mungon) që të</p>




	<p><i>parashikojë kushtet, kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur lidhur me rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me parashikimet e nenit 33 të ligjit Nr. 80/2015.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>UNYT ka hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të funksionimit të tij, procedura dhe kriteret të posaçme për rekrutimin e personelit. Përparësi i jepet personelit të kualifikuar kryesisht në IAL të huaja, për shkak të kriterit të zotërimit të gjuhës angleze për qëllime të mësimdhënies (<i>Evidenca 1.7 “Rregulla dhe udhëzime”, neni 4; Evidenca 1.10 “Rregullore e programit të Drejtësisë PIND”, neni 4</i>).</p> <p>Përgjegjëse për koordinimin dhe sigurimin e procedurës së rekrutimit të personelit akademik është Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila pas përfundimit të procedurës së brendshme, shpall njoftimin për vendin e lirë të punës për të interesuarit nëpërmjet shpalljes (media e shtypur dhe elektronike) (<i>Evidenca 4.1, f. 5-6</i>) si dhe nëpërmjet njoftimit në faqen elektronike të institucionit: (https://unyt.edu.al/wp-content/uploads/2021/06/Vacancies-2021_AcademicPositions_web.pdf), faqe e cila u konsultua dhe nga GVJ.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në vijim të parashikimeve në aktet e brendshme rregullatore, institucioni ndjek me saktësi hapat përkatës në drejtim të rekrutimit të personelit të ri akademik. Përparësi i jepet personelit më të kualifikuar në tituj e grada si dhe atyre të diplomuar në universitete të huaj.</p> <p>Procedura e përzgjedhjes fokusohet në ekspertizën e kandidatit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me kriteret e përcaktuar.</p> <p>Pas përcaktimit të nevojës për personel nga përgjegjësi i programit (<i>Evidenca 1.32 “Aneks Budget Proposal”</i>) dhe miratimit nga strukturat drejtuese të IAL (<i>Evidenca 1.43 “Internal Decision on Recruiting New Dep Member”</i>), njoftimi, bashkë me cilësitë e kërkuara për vendin e ri të punës si personel akademik (<i>Evidenca 4.3 “Vacancy Announcement Law 2020”</i>), bëhen publike në faqen zyrtare të universitetit si dhe në median kombëtare e ndërkombëtare, të shtypur dhe online.</p> <p>Komisioni i rekrutimit përbëhet nga përgjegjësi i programit, dekani, një anëtar i stafit akademik, dhe shqyrton aplikimet, vlerëson dokumentacionin shoqërues si dhe përgatit listën me renditjen e kandidatëve në përputhje me nivelin e tyre të kualifikimit.</p> <p>Në radhitje vlejné sidomos si kriteret:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Cilësia e arsimit; 2. Përvoja në kërkim shkencor; 3. Filozofia e mësimdhënies dhe përvoja; 4. Rekomandimet profesionale.

	<p>Intervista zhvillohet në bazë të listave të përgatitura, ku intervistat koordinohen nga përgjegjësi i programit. Intervistat bëhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose online.</p> <p>Në përfundim të intervistës, anëtarët e komisionit të rekrutimit paraqesin përshtypjet e tyre dhe renditin kandidatët sipas vlerësimeve të bëra. Në vijim, vazhdohet me lidhjen e marrëveshjes me kandidatin fitues (<i>Shembuj procedurash të plota rekrutimi: Evidencat 4.3; 4.4 dhe 4.5</i>).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UNYT merr përsipër në aktet e tij të brendshëm mbështetjen dhe aftësimin e personelit akademik (<i>Evidenca 1.1 "Statuti" nenet 6 dhe 40; Evidenca 1.5 "Strategic plan", objektivat strategjike Nr. 1, 2 dhe 4</i>).</p> <p>Në mënyrë të detajuar, parimet që lidhen të drejtat e personelit zërthehen dhe në Kodin e Etikës, të miratuar nga institucioni (<i>Evidenca 4.7</i>).</p> <p>GVJ ka konstatuar gjatë vizitës në institucion se godina ku realizohet mësimdhënia teorike për këtë program studimi, ka klasa të pajisura me mjetet e duhura audio-vizive, salla të përshtatshme konferencash, të cilat lehtësojnë punën e personelit akademik.</p> <p>Mjediset në dispozicion të stafit drejtues dhe atij akademik, për Qendrën Kërkimore e Shkencore, për personelin administrativ si dhe për sekretarinë mësimore, janë të përshtatshëm dhe me sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së secilit (<i>Evidenca 2.1 "Tabelat", tabela 16</i>).</p> <p>Godina ka shërbim interneti wireless, lehtësisht i aksesueshëm për përdorim nga studentët dhe personeli akademik e administrativ i institucionit. Në mbështetje të stafit dhe studentëve funksionojnë shërbimi i fotokopjeve, printimit, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni është angazhuar në vijimësi me qëllim nxitjen profesionale të personelit, gjë e cila shprehet në akte të tjera formale ku vihet theksi në krijimin e mundësive për të zhvilluar aftësitë e personelit akademik dhe administrativ dhe fuqizimin e kërkimit shkencor (<i>Evidenca 1.1 "Statuti", neni 25; Evidenca 1.5 "Strategic plan" – misioni, pika B, par. 3</i>).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Praktikisht, institucioni mundëson kërkimin shkencor të personelit nëpërmjet financimit, krijimit të mundësive për pjesëmarrje në aktivitete shkencore, mobilitetin, etj (<i>Evidenca 1.5 "Strategic plan" – objektivi strategjik 2, pika 4</i>). Për nxitjen e stafit akademik në këtë drejtim është parashikuar një buxhet për pjesëmarrje në konferenca dhe botime. Gjatë vizitës në institucion u konfirmua ky fakt, zbatuar në praktikë përmes vendimmarrjes së Bordit të Administrimit dhe dokumentacionit përkatës që vërteton mbështetjen e personelit akademik (<i>Evidenca shtesë 4 "Politika e Promovimit të Stafit akademik, mbështetjen e personelit për pjesëmarrje në konferenca"</i>; <i>Evidenca shtesë 4 "Vendim i Bordit të Administrimit për miratimin e Politikës për mbështetjen e personelit për pjesëmarrje në konferenca"</i>; <i>Evidenca shtesë "Minutat e vizitës"</i>).</p> <p>Në RVB (f. 43) është evidentuar se institucioni nxit stafin të marrë pjesë në zhvillimin e projekteve, duke veçuar projektin e trajnimit për sigurimin e cilësisë (<i>Evidencat 1.29; 1.29.1; 1.29.2; 1.29.3</i>).</p> <p>Evidentohet theksi që institucioni vë mbi leksionet ndihmës dhe stafit që janë në proces të marrjes së gradës shkencore "Dr.", duke i përfshirë në kërkime dhe projekte. Ndihmë në këtë drejtim përbën dhe ulja e ngarkesës mësimore (<i>RVB, f. 43</i>).</p> <p>Nga aktet vërehet se UNYT nxit po ashtu pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari të tilla si konferenca, projekte, seminare, etj. (<i>Evidenca shtesë 12 "Training and Extracurricular that some of Activities Staff has been part of"</i>). Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19, veprimtaritë e këtij lloji janë zhvilluar nëpërmjet platformave online (<i>Evidencat 1.17; 1.17.1; 1.41; 1.44</i>).</p> <p>Nga ana tjetër, mbështetja për zhvillimin profesional dhe karrierën shtrihet dhe ndaj punonjësve të administratës së universitetit (<i>Evidencat 3.4 "Social Events Evidence"</i>; <i>4.8 "Training Staff Sample"</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet që UNYT ka marrë masa në vijimësi për të siguruar trajnimin dhe kualifikimin e personelit akademik dhe atij kërkimor-shkencor. Trajnimet dhe programet janë në harmoni me objektivat që ka marrë përsipër institucioni (<i>Evidenca 1.5 "Strategic plan", pika B –objektiva-</i>) dhe janë realizuar me trajnues vendas dhe të huaj (<i>Evidenca shtesë 1 "Annual Monitoring Report Form 2019-2020"</i>; <i>Evidencat 1.20.1 "Training and Workshops 2020"</i>; <i>4.8 "4.8 UNYT Training Staff Sample"</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve.</p>	<p>Institucioni tregon si në pikëpamje formale, ashtu dhe në atë të zbatueshmërisë, se angazhohet në të gjithë drejtimet për të siguruar përmbushjen e plotë të detyrave nga burimet njerëzore që disponon, me qëllim arritjen e objektivave në kuadër të programit të integruar</p>




	të studimeve. Detyrat e secilit anëtar, sipas stafëve përkatës, janë të mirëpërcaktuar në aktet e universitetit, në përputhje me misionin dhe objektivat që ky i fundit synon të realizojë (<i>Evidenca 4.9 "Staff Job Description"</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UNYT disponon infrastrukturën e përshtatshme për plotësimin në mënyrë efektive të programit mësimor dhe funksioneve mbështetëse të tij (<i>Evidenca 4.10 "Rent Contract Main Building-16.10.2019"</i> <i>Evidenca 4.11 "Main Building Technical Report"</i>; <i>Evidenca 2.1 "Tabelat"</i>, tabela 16). Referuar përmbajtjes së f. 44 të RVB, mësimdhënia për programet e studimit të ofruar nga Departamenti i Drejtësisë realizohet në kampusin e ri të universitetit, i përbërë nga dy ndërtesa kryesore dhe me një hapësirë të konsiderueshme shfrytëzimi. Vlerësimi është kryer në kampusin në fjalë, ku u zhvillua vizita nga GVJ si dhe ku zhvillohet programi i integruar i studimit në drejtësi.</p> <p>GVJ ka konstatuar një sipërfaqe të mjaftueshme në funksion të sallave për leksione, laboratorë, zyra, etj. (<i>Evidenca 4.12 "Space and facilities"</i>). Sipas këtyre të dhënave, universiteti vë në dispozicion 489.5 m² si salla leksioni për studentët, kundrejt 133.3 m² për klasat. Sallat për veprimtari promovionale shtrihen në 1 534 m² dhe laboratorët laboratorët për kompjuterat 175.5 m². Biblioteka ka sipërfaqe 215 m², zyra informative e dedikuar studentëve 116 m², sallat dhe ambientet sportive 663 e 648 m². Sallat janë të pajisura me ndriçim dhe me aksesoret e nevojshëm teknologjikë për zhvillimin normal dhe bashkëkohor të veprimtarisë për të cilën janë destinuar. Ambientet janë të pajisura me dritare dhe me një sistem të përshtatshëm ajrimi dhe kondicionimi (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Sipërfaqet e dedikuara stafit akademik janë: 133.5 m² - salla e takimeve; 93.3 m² - mjediset për stafin e shërbimit; 152.5 m² - njësitë hidrosanitare për stafin.</p> <p>Institucioni ka në përdorim 3 000 m² sipërfaqe parkimi, e cila në ditën e realizimit të vizitës gjendej në proces ndërtimi e sipër. Institucioni siguron 1 045 m² sipërfaqe çlodhëse për studentët. Mjediset hidrosanitare janë në sipërfaqen 134.5 m² (<i>Evidenca 4.20</i>).</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Nga vizita në institucion u konstatua aksesueshmëria, në kuptimin infrastrukturor, për personat me aftësi të kufizuara, në pjesën hyrëse të institucionit, rampa nëpër shkallë, ashensor, etj. Mungon aksesueshmëria në vendodhjen e bibliotekës, sa i përket mungesës së rampës për në ashensorin që të shpinte në të.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion u vërejt se UNYT zotëron ambientet e duhura për realizimin e programit mësimor të integruar të studimeve të ciklit të dytë Master i shkencave në drejtësi, ku klasat dhe sallat janë të pajisura me pajisjet përkatëse elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Pajisjet në fjalë, video projektorë, TV, kamera digjitale, projektorë të ndryshëm, kompjutera, pajisje CD/DVD/VHS, lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</p> <p>Në godinë funksionin shërbimi i internetit wireless, i aksesueshëm nga studentët dhe nga stafi i institucionit.</p> <p>Administrimi i pajisjeve dhe shërbimeve teknologjike kryhet nga punonjësit e zyrës së IT, të ngritur në këtë institucion, të cilët gjithashtu u ofrojnë ndihmë edhe studentëve gjatë shfrytëzimit të tyre (<i>Evidencat 4.14 "Manual of Information Security"; 4.17 "IT Support Services"</i>).</p> <p>Rezulton që UNYT ka siguruar e vënë në shfrytëzim pajisjet e duhura e të nevojshme, në funksion të programit të integruar të studimeve në përputhje me rregullimet e bëra në nenin 67, pika 4, të Statutit të tij (<i>Evidenca 1.1</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në godinë përfshihen laboratorët, sallat e studimit, auditorë të madhësive të ndryshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve, orëve praktike, leksioneve të hapura, etj. Ambientet e zhvillimit të leksioneve e seminareve janë me hapësira të mjaftueshme dhe mundësojnë qëndrimin lirshëm të studentëve. Gjithashtu, janë të pajisura me pajisje kompjuterike, projektorë, etj., dhe lehtësojnë përdorimin e metodave të larmishme të mësimdhënies. Ambientet konsiderohen të përshtatshëm për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për aktivitete të tjera të ngjashme (<i>Evidenca 4.12; Evidenca 4.17</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në përputhje me programin e studimit, IAL ka siguruar 4 laboratorë informatike (<i>Evidenca 2.1, tabela 16</i>). Laboratorët janë pajisur me programe profesionale, në përputhje me programin e studimit, objekt vlerësimi, nëpërmjet të cilëve mund të aksesohet në aplikacione të përparuara si: McGraw Hill, Turnitin, Office 365, etj. (<i>Evidenca 4.17</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u referua se gjyqet imituese zhvillohen në një nga klasat (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>), por një sallë e krijuar enkas për këtë qëllim, me mjetet e duhur, në përputhje me programin e studimit në drejtësi, për zhvillimin e gjyqeve imituese, mungon.</p> <p>Nga ana tjetër, praktikatat profesionale dhe disa veprimtari të tjera praktike realizohen në ambientet e subjekteve, me të cilët IAL ka lidhur marrëveshje (<i>Evidenca 1.28</i>). Në lidhje me to, GVJ gjen rastin të rekomandojë lidhjen e marrëveshjeve me institucione të tillë si gjykata,</p>




profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	<i>prokuroria, institucione të tjerë qendrore të rëndësishëm, në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e përfshirë në njësitë ndihmëse akademike të UNYT (<i>Evidenca 1.1 "Statuti", neni 53; Evidenca 4.19 "Library Policy and Procedures"</i>). Si në pikëpamje të akteve të brendshme të institucionit, ashtu dhe në atë objektive, rezulton që biblioteka të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se biblioteka ishte vendosur në katin e dytë të godinës, e ndarë në dy ambiente, me ndriçim, ajrim dhe sistem të përshtatshëm kondicionimi (<i>Evidenca shpeshë "Minutat e takimit"</i>).
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	UNYT zotëron një bibliotekë me larmi botimesh, ndër të cilët përfshihen dhe ato në fushën e së drejtës, në gjuhën shqipe dhe atë angleze (<i>Evidencat 1.25 "List of Purchased Books"</i>). Sipas RVB, f. 46, biblioteka e institucionit siguron tekste akademike cilësore, literaturë shpeshë dhe udhëzues, në funksion të kurrikulës së programit të studimit. UNYT është partner i revistës periodike "Albanian Law Journal". Punimet e përfshirë në të, trajtojnë tematika shumëplanëshe. Këto punime mund të aksesohen online: http://www.lawjournal.al/?q=page/albanian-law-journal . Literatura e gjendur në bibliotekë, në gjuhën shqipe dhe angleze, garanton përmbushjen e objektivave të programit për studentët (<i>Evidenca 1.25 "List of Purchased Books in Albanian - LAW."</i> ; <i>Evidenca 1.25 "List of Purchased Books in English - LAW"</i>).
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga vizita e kryer në institucion dhe sipas të dhënave të vëna në dispozicion, institucioni ka siguruar akses pa pagesë për studentët në bibliotekat online "Jstore" dhe "Emerald Insight", në të cilat studentët dhe personeli akademik e kërkimor-shkencor mund të gjejnë larmi tekstesh e punimesh, në përputhje me programin e studimit (<i>Evidenca 2.1, tabela 17</i>). Aksesimi në bibliotekat online sigurohet në bazë të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>abonimit, ku për "Jstore" kosto vjetore arrin në vlerën 2 600 \$. Kjo bibliotekë përfshin koleksione online të revistave të ndryshme shkencore. "Emerald Insight" përfshin tituj revistash shkencore dhe libra, me një kosto vjetore në vlerën 4 800 £.</p> <p>Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me "Empire State College", ekziston mundësia për akses dhe në databaza të tjera, të tilla si "EBSCO", "Proquest", "Gale", etj (<i>Evidenca 4.13 "Library facilities"</i>).</p> <p>GVJ kërkoi aksesimin në bibliotekat online dhe bazat e tjera të të dhënave, gjatë vizitës në institucion, gjë e cila rezultoi plotësisht e realizueshme, në përputhje me deklaruar nga institucioni në RVB (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer në institucion, GVJ konstatoi që biblioteka e UNYT është e pajisur me pajisjet e duhura teknike, tavolinat e punës si dhe programet kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e saj nga studentët (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Njëra prej hapësirave të saj përmban zonën e kompjuterave dhe aksesorët e tjerë të nevojshëm, 12 vende të tillë.</p> <p>ID e studentit konsiderohet si kartë anëtarësie e bibliotekës, gjë e cila mundëson shfrytëzimin në këtë ambient të literaturës. Për akses në bibliotekë është i mjaftueshëm dhe një mjet identifikimi, përveç ID universitare (<i>Evidenca 4.19</i>).</p> <p>Sipas RVB, f. 46, evidencat mbi tekstet akademike, literaturën shtesë dhe udhëzuesit për studentët, në funksion të shfrytëzimit të saj, gjenden dhe në formatin elektronik në faqen elektronike zyrtare të institucionit.</p> <p>Sistemi i përdorur në funksion të shfrytëzimit, LibrarySoft (formati MARC) shërben për regjistrimin e materialeve, sistemin e klasifikimit të bibliotekës si dhe për procedurat e katalogimit të koleksionit kryesor. Burimet elektronike mund të arrihen si brenda, ashtu dhe jashtë kampusit të universitetit (<i>Evidencat 4.13 dhe 4.19</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Procedura për shtimin e literaturës në bibliotekë dhe për përditësimin e fondit të saj është parashikuar në nenet 7 dhe 8 të "Politikave dhe procedurave të bibliotekës". Sipas nenit 8, burim i literaturës në bibliotekë parashikohen dhe dhurimet (<i>Evidenca 4.19</i>).</p> <p>Procedura e ndjekur nënkupton që drejtuesit e departamenteve dhe drejtorët e programeve hartojnë një plan të detajuar për të rritur numrin e materialeve të bibliotekës në përputhje me programet studimore, projektet e kërkimeve shkencore dhe përgatitjes së temave nga studentët. Kërkesat shqyrtohen nga organet eprorë dhe nëse miratohen e janë në përputhje me buxhetin e parashikuar për shpenzimet e bibliotekës, i kalojnë për ekzekutim bibliotekës dhe administratorit të universitetit. Sipas RVB, f. 46, buxheti i bibliotekës për periudhën 2021-2022 është parashikuar 22 000 Euro, kurse</p>

	kostoja financiare e librave në tërësi është 190 000 Euro (<i>Evidencat 4.19; 3.8 "Book Purchase 2020-2021"; 3.9 "ERP Report Textbooks Law 2021-2022"</i>).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e punës së bibliotekës në UNYT janë të disponueshme për studentët nga dita e hënë deri ditën e premte në orën 09.00 – 21.30, ditën e shtunë ora 09.00 – 17.00 dhe ditën e diel ora 09.00 – 18.00 (<i>Evidenca 4.13 "Library facilities"</i>). Oraret e ofrimit të këtij shërbimi vijnë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe tej tyre, duke iu dhënë mundësi studentëve të shfrytëzojnë dhe tej orarit mësimor literaturën e gjendur në të. Orari është i shpallur në hyrje të bibliotekës si dhe në faqen online të universitetit https://unyt.edu.al/index.php/facilities/ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas përcaktimeve të bërë në statutin e UNYT, në institucion funksionojnë njësitë ndihmëse si kryesekretaria e fakultetit dhe sekretaria mësimore, të cilat disponojnë dhe administrojnë informacionin që lidhet me studentët. Nëpërmjet strukturave të tij, si të natyrës akademike, ashtu dhe administrative, universiteti siguron mbështetje të vazhdueshme ndaj studentëve në të gjithë aspektet. Për këtë qëllim janë ngritur strukturat përkatëse, të përshkruara në statut, që bëjnë të mundur shkëmbimin e të dhënave mes njërive drejtuese, akademike dhe njërive të tjera ndihmëse apo të shërbimit (<i>Evidenca 1.1 "Statuti" nenet 46-48, 54, 57, 60</i>). <i>GVJ gjen me vend të rekomandojë hartimin dhe miratimin e rregullores së përgjithshme të institucionit që të parashikojë strukturat, rolin dhe rregullimet sa u përket studentëve, procesit të mësimdhënies, etj, në përputhje me parashikimet e nenit 33 të ligjit Nr. 80/2015.</i> Shërbimet mbështetëse nisin që në momentin e pranimit të studentëve, në Zyrën e Pranimeve, Records Office, Këshillimi Akademik. Vlen të evidentohet në këtë drejtim roli i Qendrës së Mbështetjes Akademike dhe Qendrës së Këshillimit, të cilat u sigurojnë studentëve mbështetjen e duhur lidhur me problematikat, idetë, sugjerimet, etj., gjatë kohëvazhimit të studimeve (<i>Evidenca 1.1, neni 60; Evidenca 4.2 "Rules and Regulations Academic Support</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-48423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Center and Counselling Center</i>”). Nga aktet rezulton që këto dy struktura drejtohen nga personel akademik i punësuar me kohë të plotë, që realizon detyrat e përmendura, sa i përket problematikave në kuadër të veprimtarisë universitare, ashtu dhe me jetën personale e problemet që mund të përjetojnë studentët në familjet e tyre. Informacioni i nevojshëm mund të konsultohet dhe në faqen zyrtare elektronike të universitetit: https://unyt.edu.al/index.php/academic-support-center/.</p>
	<p>Informacioni për studentët administrohet në database-n e sekretarisë mësimore si dhe në regjistrin themeltar të notave. Në sekretari gjenden të arkivuara dosjet e secilit student të regjistruar, të çregjistruar apo që ka përfunduar studimet, gjë që u konstatua dhe nga GVJ (<i>Evidenca shitesë “Minutat e takimit”</i>).</p> <p>Institucioni disponon gjithashtu të dhëna për studentët nga momenti i regjistrimit deri në dalje nga ky program studimi (<i>Evidenca 2.1 “Tabelat”, tabelat 21, 22, 23; Evidenca 6 “Letra e dekanit”</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin e aplikueshëm për arsimin e lartë dhe aktet e brendshme, brenda UNYT janë krijuar strukturat përkatëse që administrojnë të dhënat lidhur me personelin e punësuar në të (<i>Evidenca 1.1 “Statuti”, neni 50</i>).</p> <p>Nga aktet e vënë në dispozicion rezulton që institucioni disponon të dhënat e nevojshme që përfshijnë dokumentacionin lidhur me punësimin dhe kualifikimet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ (<i>Evidencat 2.1.1; 2.1.2; 2.1.3</i>).</p> <p>Të dhënat në fjalë, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila ka vënë, gjatë vizitës në institucion, në dispozicion të GVJ dosje të personelit, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme (<i>Evidenca shitesë “Minutat e takimit”</i>).</p> <p>Gjithashtu, janë të administruara të dhëna lidhur me veprimtaritë ku është përfshirë stafi, si të natyrës sociale (<i>Evidenca 3.4</i>), ashtu dhe pjesëmarrja në workshop-e dhe trajnime të ndryshme (<i>Evidencat 1.20.1 “Career Centre Workshop”; 1.20.1 “Training and Workshops 2020”</i>).</p> <p>Sistemi i brendshëm disponon të dhëna për pjesëmarrjen në konferenca si dhe botimet e bëra nga stafi akademik (<i>Evidenca 1.16 “Event calendar” dhe Evidenca 2.4 “Books and research articles”</i>).</p> <p>Nga ana tjetër, departamenti i Drejtësisë administron të dhënat lidhur me personelin akademik si dhe veprimtaritë e kryera prej tyre (<i>Evidenca shitesë 1 “Annual Monitoring Report”</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion rezulton që strukturat përgjegjëse për programin e studimit PIND, sekretaria mësimore dhe departamenti, mundësojnë dhënien e informacioneve e dokumentacionit të kërkuar si për personelin, ashtu dhe për studentët.</p>




	<p>Dhënia e informacioneve të nevojshëm është në përputhje me llojet e programeve të studimit të ofruar nga ky universitet e konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Koordinimi për hartimin e kurrikulave të programeve dhe rregulloreve mundësohet në bazë të dokumentit të hartuar për këtë qëllim (<i>Evidenca 1.21 "Curricula development policy and procedures"</i>); - Të dhëna të hollësishme mbi programet e studimit jepen në Manualin e studentit ose në manualet e programeve pasuniversitare (<i>Evidenca 1.6 "PIND Law Rregullore e Programit"</i>). Sipas RVB, f. 48, manualet u shpërndahen dhe diskutohen me studentët në ditën e prezantimit dhe orientimit të tyre. Lista e kurseve të një programi studimi u vihet në dispozicion studentëve në ambientet e universitetit, në mjedisin e pritjes dhe në zyrën e çështjeve të studentëve, gjatë periudhës së regjistrimit; - Sa i përket syllabus-it të secilës lëndë, ky iu jepet studentëve në orën e parë të kursit, gjithashtu iu dërgohet studentëve në adresën elektronike ose përfshihet në faqen e kurseve në internet (<i>RVB, f. 48</i>); - Sa i përket procesit të zhvillimit të kurrikulës, zhvillohet duke bërë vlerësimin e programit, me përfshirjen e të gjithë subjekteve të interesuar (<i>Evidenca 1.21</i>); - Sa i përket kritereve të pranimit të studentëve, universiteti i përcakton në bazë vjetore sipas vendimmarrjes së strukturave përkatëse (<i>Evidenca 5.3 "Senate Decisions on Admission Criteria and Quotas"</i>). Kriteret deklarohen në MASR dhe agjencitë e saj, publikohen në faqen zyrtare të universitetit dhe në portalin U-Albania. <p>Shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve ka funksionuar më së miri edhe gjatë periudhës së pandemisë, të shkaktuar nga Covid-19 (<i>Evidenca 5.21; Evidenca 5.22; Evidenca 5.23</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas RVB (f. 48), institucioni ka krijuar mundësinë e komunikimit mes stafit akademik dhe studentëve përgjatë gjithë vitit akademik. Në radhë të parë, i gjithë kampusi ka akses në internet në tërësinë e ambienteve të tij. Studentët mund të njihen me vlerësimet e marra (notat) në programin e-Gnomon, sipas mënyrës së aksesit të mundësuar nga zyra IT (<i>Evidenca 5.23</i>). Komunikimi është verbal, por dhe me anë të postës elektronike, gjë që u konfirmua gjatë vizitës në institucion në takimet me personelin dhe studentët (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>Rregullimi i brendshëm i veprimtarisë së UNYT, nëpërmjet statutit dhe rregulloreve, është bërë në mënyrë të tillë që strukturat drejtuese dhe titullarët të marrin dijeni për veprimtaritë e kryera nga personeli akademik dhe ai administrativ (<i>Evidencat 1.1; 1.7; 1.8 dhe 1.9</i>).</p>




dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Vlen të përmendet në këtë drejtim edhe përpilimi i raportit vjetor të institucionit, nëpërmjet të cilit përshkruhen veprimtaritë e brendshme dhe të jashtme studentore, akademike dhe administrative të tij. Raporti në fjalë përgatitet nga të gjitha strukturat akademike, administrative dhe të menaxhimit, nën drejtimin e rektoratit. Ky i fundit, është përgjegjës për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacioneve dhe për përgatitjen e raportit vjetor, i cili i paraqitet në vijim për miratim Senatit dhe Bordit të Administrimit (<i>Evidenca 1.1 "Statuti", neni 22/2, pika 2 në lidhje me nenin 17, pika g</i>).			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UNYT mundëson dhënien e një informacioni të plotë e të detajuar në faqen zyrtare online të veprimtarisë së tij, https://unyt.edu.al/ si në lidhje me objektivat, stafin akademik, studentët, veprimtaritë shkencore, etj. Informacioni mundësohet vetëm në gjuhën angleze, por IAL është duke punuar për përgatitjen e informacionit edhe në gjuhën shqipe (<i>Evidenca shtesë 6</i>). <i>GVJ rekomandon që ky proces, në përputhje me standardet e vendosur në shtojcën Nr. 5 të VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së arsimit të lartë", të përfundojë sa më shpejt në mënyrë që informacionet të publikohen edhe në gjuhën shqipe.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në përputhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion, UNYT është organizuar në formën e një shoqërie tregtare, i regjistruar si person juridik i tatueshëm në organet tatimore. Prej vitit 2018 është bërë pjesë e Fondacionit Shtetëror Turk Maarif, nën emrin "International Maarif Schools" (<i>Evidenca 1.1, neni 1</i>). Në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së tij, institucioni harton në mënyrë periodike pasqyrat financiare të të ardhurave si dhe të ndarjes së burimeve financiare. UNYT gëzon autonomi financiare dhe në bazë të dispozitave të ligjit Nr. 80/2015, harton planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm, pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit, i cili përditësohet çdo vit (<i>Evidenca 1.1 "Statuti", neni 17, pika h, në lidhje me nenin 35 të tij</i>). Gjatë analizimit të kostove mbahen parasysh ndarjet si më poshtë:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




- Kosto operative: kosto e mësimdhënies, udhëtimi dhe akomodimi i profesorëve që udhëtojnë nga jashtë vendit, tarifat që u paguhen universiteteve partnere (State University of New York/Empire State College; University of Greenwich), pagat e stafit mbështetës administrativ sikurse dhe kosto të tjera fikse operacionale, qira, energji, telefon, internet, etj., të cilat janë të lidhura me programet e studimit;
- Kosto të blerjes së aseteve të trupëzuara apo të patrupëzuara, të nevojshme për funksionimin e aktivitetit të UNYT;
- Kosto për blerje të licencave të programeve software, licencave të bibliotekave elektronike, etj.

Institucioni harton raportin vjetor mbi koston dhe efektivitetin e secilit program studimi, duke kryer dhe një analizë të shpenzimeve operacionale dhe atyre kapitale.


Analiza e koston shoqërohet me analizën e të ardhurave për çdo program studimi, gjë e cila shërben për analizimin e fitimeve dhe humbjes. Analiza e koston së programeve shqyrtohet në raport me të ardhurat e gjeneruara nga programet. Mbi analizën e bërë për fitimin dhe humbjet për secilin program studimi, kur lind e nevojshme, bëhen ndryshimet e nevojshme që reflektohen në vitin e ardhshëm akademik (*Evidenca 4.24 "Raporti vjetor 2018-2019"*).

Sipas RVB (f. 50), procesi i brendshëm i planifikimit buxhetor nis në periudhën Prill-Maj të vitit akademik, duke u bazuar në shpenzimet e vitit aktual dhe parashikimet e numrit të studentëve, programeve të reja akademike si dhe shpërndarjen e tyre në ciklet dhe degët e studimit. Ky përbën draftin e parë të buxhetit i cili, pasi diskutohet në Bordin e Administrimit dhe në Senat, rishikohet pas finalizimit të regjistrimeve në fillim të vitit akademik. Versioni përfundimtar i buxhetit finalizohet pasi regjistrimet e vitit të ri akademik janë mbyllur dhe miratimi i tij final bëhet nga senati.

Mbi këto kritere, Administratori i Përgjithshëm i UNYT, bashkë me zyrën e financës dhe administratorët e njëjësive kryesore, harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afatmesëm, pasur parasysh nevojat e paraqitura nga njësitë bazë dhe ato kryesore (*Evidenca 1.1 "Statuti", neni 36 në lidhje me nenet 37 e 46 të tij*).


Burim i të ardhurave sipas akteve të sjellë nga IAL janë të ardhurat nga: tarifat e paguara nga studentët, financimi i ortakut të vetëm, të ardhura nga projekte kërkimore si Erasmus, grantet për kërkim dhe kontratat, aktivitet tregtare (menca, kafe, bare, rezidenca, etj.). (*Evidenca 1.1, neni 76; Evidenca 4.24; RVB, f. 50*). Referuar të dhënave të sjella nga RVB, të ardhurat faktike janë siguruar nga tarifat e shkollimit, grantet për kërkim dhe kontratat dhe aktivitetet tregtare (*Evidenca 2.1 "Tabelat", tabela 18*).

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, RVB dhe aktet shoqëruese, rezulton se në planin e financimit të UNYT, parashikohet edhe mënyra e përdorimit të fondeve, të cilët ndahen në tre kategori:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Shpenzime për mësimdhënie dhe shkencë; 2) Shpenzime të administrimit institucional dhe, 3) Shpenzime të përgjithshme operative. <p>Ndarja dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhet për çdo njësi bazë, lidhur me kërkesat e shprehura prej tyre, duke marrë në konsideratë fondin e pagave, kontributet shoqërore dhe shëndetësore, për veprimtari shkencore dhe fondin e ekselencës. Gjatë hartimit të planit mbahen parasysh gjithashtu kërkesat për sigurimin e cilësisë, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, bibliotekën online, etj. Po ashtu, plani i financimit parashikon dhe nevojat e departamenteve/njësive për fonde për punë kërkimore, sipas listës së veprimtarive që do të zhvillohen (<i>Evidenca 4.24; Evidencat 4.26 "Pasqyra Financiare + shënime 31-12-19" dhe "Pasqyrat financiare + shënime"</i>). Parashikimet në fjalë janë në përputhje me përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve në drejtësi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe informacionit të marrë në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, veprimtaria e UNYT i nënshtrohet një auditimi të përvitshëm, i cili kryhet nga ekspertë të licencuar. Përveç auditimit të jashtëm, realizohet dhe auditimi i brendshëm (Njësia e Auditit të Brendshëm), nga i cili dalin të dhënat në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë në përputhje me rregullat dhe standardet (<i>Evidenca 1.1 "Statuti" neni 77; Evidencat 4.24 dhe 4.25</i>). Nëpërmjet auditimit të brendshëm vlerësohet arritja e objektivave lidhur me efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve, besueshmërinë e raportimit financiar dhe administrues, në pajtim me politikat dhe rregulloret në fuqi.</p> <p>Auditimi i jashtëm kryhet me qëllim të sigurimit se pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale.</p> <p>Auditimi i përvitshëm kryhet duke mbajtur parasysh shqyrtimet financiare (vlerësim i kontabilitetit dhe raportimi i transaksioneve financiare), shqyrtimet e pajtueshmërisë (shkalla e respektimit të politikave, procedurave dhe rregulloreve) dhe shqyrtimet operationale (informacioni operativ dhe mjetet e përdorur për të identifikuar, matur e raportuar këtë informacion; rishikimin e mjeteve për ruajtjen e aseteve; rishikimi i procedurave e sistemeve të vendosur për të siguruar pajtueshmërinë me politikat, procedurat, planet, legjislacionin dhe rregulloret). Në raportet e auditit të sjellë nga institucioni vërehet se këta raporte përmbajnë në mënyrë të detajuar situatën financiare si dhe të dhëna për përdorimin e buxhetit të planifikuar për realizimin e</p>




	programit mësimor. Të dhënat përfshijnë gjithashtu pagat, shpenzimet operative, detyrimet ndaj të tretëve, etj. (<i>Evidencat 4.24</i>).			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	U konfirmua nga vizita në institucion dhe nga aktet e sjellë nga IAL se raportet financiare janë të administruara për tri vitet e fundit akademike (<i>Evidencat 4.24 dhe 4.26</i>). Procedurat përkatëse, sipas RVB (f. 50), kryhen në mbyllje të çdo cikli studimi, ku IAL bën një raport financiar përmbledhës, ku referuar raporteve periodike, përcakton nëse programi i studimit ka përparuar në përputhje me planifikimin e bërë apo ka nevojë për rishikim e rivlerësim të situatës financiare. Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Bordi i Administrimit dhe në përfundim të këtij procesi bëhet dhe analiza që planifikon ndërhyrjet e duhura në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit (<i>Evidenca 1.1 "Statuti", neni 34</i>).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Pasur parasysh dokumentacionin e konsultuar, vlerësohet se institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare dhe zotëron mjetet e nevojshme financiare në mbështetje të realizimit të programit të integruar të studimeve në Drejtësi. Situata financiare paraqet qëndrueshmëri dhe për ata studentë që do të zgjedhin të ndjekin programet e studimit të ofruar nga departamenti i Drejtësisë. Është vënë në dukje se financimi i vazhdueshëm nga ortaku gjatë viteve të fundit, ka siguruar qëndrueshmëri financiare dhe siguri për zhvillimin e programeve të studimit. Në këtë pikë, pasur parasysh burimet e të ardhurave faktike, <i>vlerësohet shiimi dhe i faktorëve të tjerë në të ardhurat institucionale, për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së IAL përballë situatave të riskut që nuk janë parashikuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	





V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL rezulton që UNYT ka hartuar procedura të hollësishme për regjistrimin e studentëve, periudhën e studimeve dhe diplomimin e tyre (<i>Evidenca 1.1 "Statuti"; 1.7 "Rules and regulations"; 1.10 "Rregullore e Programit të Drejtësisë PIND"</i>). Aktet e brendshme janë hartuar duke pasur parasysh përcaktimet e ligjit Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Mbi bazën e akteve themelore të organizimit të brendshëm, institucioni ka ngritur një sërë zyrash dhe zbaton procedura që mbulojnë momentin e regjistrimit, pranimit, transferimit, lënies së studimeve, këshillimit gjatë periudhës së studimeve, diplomimin e studentëve (<i>Evidenca: 1.24 "Politika e Transferimit të Studimeve"; 5.1 "SAO Rules and regulations"; 2.11 "Interruption of studies"; 5.16 "Rules and regulations career office"; 1.6 "Manuali i studentit"; 1.33 "PIND Thesis Guidelines Handbook"; 3.11 "Diploma Issuing Procedure"</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UNYT ka parashikuar politika dhe procedura regjistrimi, pranimi dhe transferimi të studentëve në përputhje me kuadrin ligjor e nënligjor të aplikueshëm. Procedurat e hyrjes dhe të daljes si dhe ato gjatë kohëvazhdimit të studimeve, të mirëpërcaktuara dhe të bëra publike, garantojnë respektimin e të drejtave të secilit kandidat/student (<i>Evidenca 1.1 "Statuti", neni 6.2</i>). Këto parime përmenden dhe në planin strategjik të universitetit, në drejtim të ofrimit dhe dhënies së mundësive të barabarta për të gjithë studentët apo kandidatët për të qenë të tillë (<i>Evidenca 1.5 "Strategic plan 2020-2025", f. 2</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat mbi pranimin dhe përzgjedhjen e studentëve janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit mbi bazën e kriterëve të përcaktuar në ligjin Nr. 80/2015. Procedura të hollësishme janë parashikuar në dokumentin e regjistrimeve dhe transferimeve (<i>Evidenca 1.24</i>). Kriteret e regjistrimit janë publikuar dhe në faqen zyrtare elektronike të institucionit (https://unyt.edu.al/index.php/admissions/), e aksesueshme lehtësisht nga cilido i interesuar.</p> <p>Sa u përket procedurave të tjera gjatë vazhdimit të studimeve, përfshi transferimet, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, institucioni ka krijuar mekanizmat përkatës, rregullore dhe zyrat zbatuese të tyre. Informacione të hollësishme studentëve iu sigurohen dhe përmes Manualit të studentit (<i>Evidenca 1.6</i>) si dhe në faqen online të</p>




	<p>universitetit. Informacioni është lehtësisht i kuptueshëm dhe përfshin të dhënat e nevojshme.</p> <p>Pranimi i studentëve që ndjekin programin e integruar të studimeve në drejtësi është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015 si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë statuti i UNYT, Rregullat dhe udhëzimet dhe Rregullorja e programit (<i>Evidencat 1.1; 1.7; 1.10</i>).</p> <p>Pasur parasysh dhe rregullimet e VKM Nr. 259, datë 10.05.2019, kriter pranimi në këtë program studimi është përfundimi me sukses i arsimit të mesëm të lartë si dhe mesatarja e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>Neni 12 i Rregullores së programit përcakton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim dhe procedurën që duhet ndjekur (<i>Evidenca 1.10</i>). Procedurat e detajuara gjenden në dokumentin e regjistrimeve dhe transferimeve. Pranimet e studentëve bëhen në përputhje me standardet shtetërore të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore dhe kriteret e pranimit të vendosura nga njësitë bazë e njësitë kryesore (<i>Evidenca 1.7, nenet 9-12; Evidenca 1.10, nenet 12-14</i>).</p> <p>Nga kontrolli i kryer në dosjet e regjistrimit të studentëve në sekretarinë mësimore, rishtas dhe të transferuar, përzgjedhur në mënyrë rastësore, u konstatua se në to gjendeshin të administruar të gjithë dokumentet e nevojshëm, të përcaktuar në aktet e brendshëm të institucionit, përkatësisht në nenet e cituar më lart të Rregullave dhe udhëzimeve dhe Rregullores së programit. Nuk u konstatuan probleme sa i përket matrikullimit të studentëve (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në aktet e brendshme të universitetit, Rregulla dhe udhëzime dhe Rregullore e programit, kriter i veçantë për përzgjedhjen e studentëve me qëllim pranimin në këtë program studimi është parashikuar zotërimi i gjuhës angleze, për shkak se është gjuha zyrtare e mësimdhënies (<i>Evidenca 1.7, neni 10; Evidenca 1.10, neni 11; Evidenca 5.3</i>). Ky kriter është publikuar bashkë me të tjerët në faqen zyrtare të IAL, https://unyt.edu.al/index.php/admissions/.</p> <p>Në këtë proces, universiteti bashkëpunon me strukturat përkatëse të ngritura në zbatim të maturës shtetërore.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit, objekt vlerësimi, bëhen të ditura për publikun nëpërmjet disa mënyrave. UNYT shfrytëzon për këtë qëllim reklamat e ndryshme në median elektronike, TV, radio, rrjete sociale, etj. (<i>Evidenca 5.5</i>).</p> <p>Një mënyrë tjetër e publikimit të kriterëve të pranimit është përmes faqes zyrtare elektronike të këtij universiteti.</p> <p>Mënyrë tjetër informimi është ajo e takimeve që realizon institucioni përmes Zyrës së Çështjeve të Studentëve, e cila zhvillon takime informuese me nxënësit maturan të shkollave të arsimit të mesëm të</p>




	<p>lartë. Në takime marrin pjesë anëtarë të stafit akademik dhe akademik, të cilët udhëzojnë të interesuarit mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta për programet e studimit të ofruar nga UNYT (Evidenca 5.1, pika F; Evidenca 5.6).</p> <p>Universiteti shfrytëzon gjithashtu pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme arsimore, ku të interesuarit informohen mbi kushtet e pranimit në UNYT dhe mundësitë që ofrohen prej tij, nëse dëshirojnë të pranohen si studentë të ardhshëm (Evidenca 5.1, pikat B dhe C; Evidenca 1.20.1).</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Sipas nenit 66 të statutit, IAL pranon studentë pa asnjë diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, besimit fetar, gjinisë, origjinës kombëtare, prirjes seksuale, prejardhjes, statusit civil, paaftësisë fizike (Evidenca 1.1, neni 66).</p> <p>Përveç këtij parashikimi të përgjithshëm, nga aktet e tjerë të vënë në dispozicion nuk rezultojnë të jenë parashikuar dhe as të jenë publikuar kriteret të veçantë për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në aktet e brendshme janë të parashikuar kriteret për regjistrimin e studentëve të huaj (Evidenca 1.7, neni 6/I; Evidenca 1.10, nenet 7/d dhe 8). Përveç këtyre parashikimeve të përgjithshme, rregulla të veçanta janë specifikuar në dokumente të tjerë të brendshëm, lidhur me procedurën e aplikimit për t'u pranuar si studentë në UNYT, të shtetasve të huaj (Evidencat 5.11 dhe 5.12).</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë.</p>	<p>Sipas RVB, f. 53, UNYT ka ndjekur parimin se arsimiti i ekselent duhet të shtrihet për të gjithë studentët pavarësisht ngarkesave dhe pengesave financiare, sidomos në rastet e studentëve të shkëlqyeshëm. Politikat për këtë qëllim gjenden në planin strategjik dhe në rregulloren e zyrës për çështjet studentore (Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 1, pika 3; Evidenca 5.1, pikat B dhe G). Për këtë arsye, universiteti ofron çdo vit bursa të bazuara në merita dhe bën publicitet duke u dhënë mundësi të interesuarve (Shembull: Evidenca 1.34).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe</p>	<p>Nga përmbajtja e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe nga takimi i zhvilluar me studentët (Evidenca shtesë "Minutat e takimit"),</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>të hollësishtëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>konstatohet se ata marrin të dhëna të detajuara mbi programin e studimeve, afatin e përfundimit të tyre, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, akreditimin e programit. Informacioni sigurohet dhe nëpërmjet faqes online të UNYT: https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-program/law/.</p> <p>UNYT organizon në javën e parë të vitit akademik një javë orientuese, ku marrin pjesë studentët, personeli akademik dhe ndihmës akademik, me qëllim informimin e studentëve, sidomos ata të vitit të parë, mbi objektivat e programit të studimit, arritjet në fund të tij dhe kriteret për kalimin në vitin pasardhës akademik. Informacioni iu jepet në mënyrë periodike nga departamenti i Drejtësisë dhe sekretaria mësimore, duke u përqendruar kryesisht në kalendarin e vitit akademik, kurrikulën mësimore, orarin e semestrit të parë, stafin akademik të angazhuar në këtë semestër (<i>Evidenca 5.1 "SAO Rules and Regulations"</i>).</p> <p>Informacionin e plotë mbi lëndën dhe syllabus-in e saj, mënyrën e kontrollit të njohurive dhe detyrimet, studentët i marrin në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga pedagogu përkatës (<i>Evidenca 2.2 "Syllabuses"; Evidenca 5.13 "Final exam communication"</i>).</p> <p>Vlerësimet për secilën lëndë hidhen në sistemin e informacionit të studentëve dhe administrohen nga Zyra e Regjistrimit. Stafi akademik plotëson dhe nënshkruan fletën e rezultateve të provimit për secilën lëndë. Fletët e rezultatit administrohen nga Zyra e Regjistrimit dhe arkivohen në universitet. Me kërkesën me shkrim të secilit student të interesuar, Zyra e Regjistrimit lëshon një transkript, i cili tregon të gjitha notat e kurseve, ECTS të fituara dhe mesataren e notave (<i>Evidenca 1.10, neni 43</i>).</p> <p>Një mjet tjetër mjaft i vlefshëm për sigurimin dhe marrjen e informacionit është dhe Manuali i studentit (<i>Evidenca 1.6</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>UNYT njeh mundësinë e transferimit të studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të parë, në programe të njëjta ose të ngjashme studimi, brenda të njëjtit institucion ose në IAL të tjera, vendase apo të huaja si dhe transferimin në IAL të tjerë (<i>Evidenca 1.1 "Statuti" neni 65; Evidenca 1.7, neni 7; Evidenca 1.10, neni 9; Evidenca 1.24 "Transfer credit regulations"</i>).</p> <p>Procedura e përcaktuar në Rregulloren e cituar më lart është e qartë, sa i përket njohjes së studimeve të kryer më parë nga studenti.</p> <p>Me qëllim njohjen e studimeve të mëparshme, institucioni ka parashikuar Komisionin e Pranimeve dhe Transferimeve në nivel departamenti, i cili, në cilësinë e një komisioni <i>ad hoc</i>, përcakton kriteret e pranimeve dhe i vlerëson ata. Në fillim të vitit akademik departamenti ngre Komisionin e Ekuivalentimit dhe Transferimeve (<i>Evidenca 1.1, neni 65</i>).</p> <p>Informacioni mund të merret dhe nga Zyra e Çështjeve Studentore, si edhe nëpërmjet Manualit të studentit (<i>Evidencat 5.1 dhe 1.6</i>).</p>




	Informacioni sigurohet gjithashtu edhe në faqen zyrtare të internetit: https://unyt.edu.al/index.php/student-affairs-office/ .			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Sipas nenit 21 të Rregullores së programit, studentët informohen mbi programin e studimit, në mënyrë të detajuar dhe për kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve të tyre. Ky informacion iu sigurohet në orën e parë të zhvillimit të lëndës nga departamenti si dhe pedagogu përkatës. Këtu përfshihen dhe informacione lidhur me provimet e ndërmjetme, prezantimet e ndryshme dhe provimin përfundimtar (<i>Evidenca 1.10; Evidenca 2.2 dhe Evidenca 5.13</i>).			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Departamenti i Drejtësisë i orienton studentët që ndjekin programin e studimit në fillim të çdo viti akademik. Atyre iu jepen të dhënat e nevojshme që në fillim të këtij viti akademik rreth procedurave të vlerësimit dhe mbylljes së studimeve, përfshi procesin e diplomimit (<i>Evidenca 1.6; Evidenca 5.4</i>). Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka hartuar dhe procedurat përkatëse për punimin e temës së diplomës, i cili lehtëson punën e studentëve që mbyllin studimet përmes punimit të saj (<i>Evidenca 3.11</i>).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në funksion të plotësimit të këtij kriteri, institucioni ka angazhuar struktura të posaçme të tij siç është Zyra e Pranimeve, e cila siguron të dhënat e nevojshme ndaj të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm të këtij programi të studimeve. Kjo zyrë merr pjesë në takime që organizohen me studentë të shkollave të mesme, në qytete të ndryshme të RSH, ku shpalo informacionin mbi programet e studimit të ofruar nga UNYT dhe këshillime të përgjithshme studimore për tërësinë e të interesuarve. Rol të rëndësishëm në këtë proces luan dhe aktiviteti i Zyrës së çështjeve studentore (<i>Evidenca 5.6; Evidenca 5.6.1 dhe Evidenca 5.1, pika F</i>). Institucioni ka publikuar udhëzues të posaçëm siç është Manuali i studentit (<i>Evidenca 1.6</i>), gjithashtu të dhëna për këtë kriter gjenden dhe në faqen zyrtare online të universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët marrin informacione të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve që do të ndjekin, si nga stafi akademik, ashtu dhe ai administrativ i universitetit (<i>Evidenca 1.10, neni 21, pikat c dhe d</i>). Vlen të përmendet në lidhje me këtë kriter, orientimi që marrin studentët në fillim të çdo viti akademik mbi programin e studimit (<i>Evidenca 1.6</i>). Rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luajnë dhe të dhënat e publikuara në faqen zyrtare elektronike të UNYT.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Departamenti i Drejtësisë dhe pedagogët e secilës lëndë, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat administrative të UNYT, sigurojnë dhënien e informacioneve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për modulet, lëndët, ngarkesën mësimore, orët në auditor, syllabus-et e detajuar, praktikat, ushtrimet, detyrat e kursit si dhe çdo veprimtari tjetër që përfshihet në programin e studimit. Informimi mundësohet si në fillim (kryesisht), por dhe në vijim të vitit akademik. Ky është një detyrim që buron nga aktet e brendshme rregulluese të IAL (<i>Evidenca 1.10, neni 21</i>).</p> <p>Të dhëna të hollësishme dhe informacionet e nevojshme për sa më lart gjenden dhe në manualin e studentit (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Zyra e Pranimeve, në funksion të sigurimit dhe dhënies së informacionit të nevojshëm organizon takime të hapura në ambientet e UNYT me maturantët e shkollave të mesme, ku u jepet mundësia këtyre të fundit që të marrin pjesë në klasa të ndryshme sipas lëndëve respektive, në mënyrë që të krijojnë përshtypjen e tyre mbi mënyrën dhe cilësinë e mësimdhënies në këtë universitet (<i>Evidenca 5.4; Evidenca 5.10</i>).</p> <p>Zyra e Pranimeve vë në dispozicion të studentëve fillimisht materialin për të nisur procesin e aplikimit, si p.sh. formularin e aplikimit dhe dokumentacionin shoqërues (<i>Evidenca 5.2</i>), por edhe rregulloret e manualet e ndryshëm që përmbajnë të dhënat e nevojshme, siç është Manuali i studentit.</p> <p>Mandej, informacionet për planprogramet e kursit gjenden dhe të shpallura online në faqen: https://unyt.edu.al/index.php/bachelor-program/law/.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në nenin 6 të Rregullores së programit të studimit përcaktohet si një ndër objektivat e programit të studimit, mundësitë e karrierës, ku përmes zhvillimit të njohurive dhe të kuptuarit të ligjit, studentëve iu jepet kualifikimi i nevojshëm akademik për të studiuar më tej si dhe për të gjetur rrugën e tyre drejt tregut ndërkombëtar të punës dhe jo vetëm (<i>Evidenca 1.10</i>).</p> <p>Në harmoni me këtë objektiv të vendosur dhe aktet e tjerë të brendshëm, është ngritur dhe funksionon Zyra e Karrierës dhe Alumni-t (<i>Evidenca 5.16</i>), e cila është e angazhuar të ndihmojë studentët dhe të diplomuarit që të përcaktojnë qëllimet e tyre të karrierës si afatshkurtër, ashtu dhe në kuptimin afatgjatë, qoftë për vazhdimin e studimeve të tjera të</p>




	<p>specializuara, apo për punësim. Për arritjen e objektivit të veprimtarisë së saj, zyra shfrytëzon udhëzime individuale për karrierë, programe dhe workshop-e, këshilla mbi letrat e referencës, kërkimin e punës dhe qasjen në bibliotekën e burimeve. Gjithashtu, kjo zyrë organizon leksione të hapura, internship-e për studentët e praktikës dhe të diplomuarit e ardhshëm, trajnime të ndryshme, që ofrojnë në tërësi aftësitë dhe njohuritë e duhura për të aksesuar në tregun e punës (<i>Evidenca 1.10, f. 26; Evidenca 5.15; Evidenca 1.6; Evidenca 1.20; Evidenca 1.20.1 "Career Centre workshop"</i>).</p> <p>Një ndër veprimtaritë e rëndësishme të realizuara nga kjo zyrë është Panairi vjetor i karrierës, ku studentëve iu jepet mundësia të dëgjojnë intervista nga përfaqësues të sektorit publik dhe subjektet e ndryshëm të biznesit (<i>Evidenca 1.10, f. 26; Evidenca 1.20</i>).</p> <p>Veprimtaria mbështetëse në këtë drejtim është siguruar dhe gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, nëpërmjet trajnimeve të organizuar në formën e uebinareve (<i>Evidenca 1.20.1 "Training and Workshops 2020"</i>).</p> <p>Me rëndësi në këtë drejtim është dhe hartimi i një plani të posaçëm veprimi nga Zyra e karrierës lidhur me veprimtaritë e ndryshme që ka planifikuar të zhvillojë dhe që synojnë, ndër të tjera, orientimin për në tregun e punës (<i>Evidenca 5.16.1</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacionin e plotë lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, studentët e marrin që në leksionin e parë (<i>Evidenca 1.7, neni 20</i>). Në këtë drejtim, vlen të përmendet dhe roli i këshilltarit akademik, i cili siguron udhëzime për secilin student në të gjitha çështjet akademike (<i>Evidenca 1.7, neni 21</i>). Të dhëna të tjera të hollësishme mbi procesin mësimor studentët marrin dhe nëpërmjet Manualit të hartuar posaçërisht për ta (<i>Evidenca 1.6</i>).</p> <p>Sipas RVB, f. 54, strukturat e departamentit dhe ato mbështetëse të institucionit mundësojnë që në mënyrë të vazhdueshme, studentët të marrin të dhënat e nevojshme mbi logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e tjerë që i vlejnë programit të studimit. Përshkrimi i tyre iu bëhet që në fillim të programit, gjithashtu studentët apo të interesuarit, kanë mundësi të shohin nga afër mjediset e IAL në vizitat që mundësohen për këtë qëllim (<i>Shembull: Evidenca 5.10</i>).</p> <p>Informacioni i përditësuar gjendet dhe në faqen zyrtare elektronike të UNYT.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Si nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, ashtu dhe nga vizita e kryer në institucion e nga takimi me studentët, konstatohet që strukturat përgjegjëse në rang akademik dhe administrativ kanë mundësuar dhënien e informacionit në mënyrë të saktë e të kuptueshme. Ky informacion ka qenë lehtësisht i arritshëm edhe në distancë (sidomos gjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19), duke realizuar shkëmbimin e të dhënave në rrugë elektronike (nëpërmjet</p>

	faqes zyrtare të universitetit: https://unyt.edu.al/index.php/e-learning-platform/ , postës elektronike, etj) (Evidenca 6.7, f. 1).			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Në përputhje me nenin 47 të statutit të IAL, sekretaria mësimore është përgjegjëse, ndër të tjera, për të ruajtur informacionin, dokumentacionin dhe dokumentet që ilustrjnë aktivitetin mësimor të studentëve (Evidenca 1.1; Evidenca 1.30, neni 6). Zyra e sekretarisë mësimore administron dosjet personale të studentëve, të dhënat që lidhen me provimet përfundimtare dhe notat përfundimtare të vlerësimit të tyre, të cilat gjenden dhe në sistemin e-gnomon të këtij universiteti (Evidenca 1.30, kapitulli III). Këto të dhëna të administruara u konsultuan gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ, si dosje të studentëve, ashtu dhe procesverbale të vlerësimit të tyre, dokumente të cilët u gjetën të rregullt në formë dhe përmbajtje (Evidenca shtesë "Minutat e takimit").			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar për programin e studimit për secilin vit akademik objekt shqyrtimi. Të dhënat përfshijnë statistikat e përgjithshme mbi numrin e studentëve, ndarjen e tyre sipas programit, notat, aktivitetet ku janë përfshirë, studentët e diplomuar dhe të dhënat mbi punësimin e tyre (Evidenca 2.1, tabelat 21-23; Evidenca 1.35 "Dokumentet e performancës").
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni zotëron të dhënat e nevojshme statistikore për numrin e studentëve të regjistruar, të çregjistruar apo me studime të papërfunduara, për programin e integruar të studimeve në drejtësi. Të dhënat administrohen nga sekretaria mësimore, në dokumentacionin e mbajtur për këtë qëllim (Evidenca 2.1, tabela 21, dhe Evidenca shtesë "Minutat e takimit").
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit	Institucioni disponon në mënyrë të saktë të dhënat e nevojshme që tregojnë ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	nga regjistrimi deri në diplomim, fakt i cili vërtetohet nga dokumentacioni (<i>Evidenca 2.1, tabelat 21 dhe 23; Evidenca 1.35</i>), ashtu dhe nga dokumentet e depozituar në sekretarinë mësimore si regjistra, procesverbale të notave, etj. (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>). Gjithashtu, të dhënat në fjalë gjenden në bazën e të dhënave e-Gnomon (<i>Evidenca 5.17</i>).			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga aktet e konsultuar vërehet që të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga strukturat e ngritura për këtë qëllim, janë mbajtur në mënyrë të saktë dhe mund të aksesohen me lehtësi. Aksesi në to mundësohet nga baza e të dhënave e-Gnomon, ku të dhënat mbrohen nga fjalëkalimet e krijuar për këtë qëllim dhe nivelet përkatës të hyrjes (<i>Evidencat 5.23 dhe 5.17</i>).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Institucioni e plotëson këtë kriter nëpërmjet dokumentit të performancës, në të cilin gjenden të dhëna sa i përket profilit, cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve, shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, etj. Nga dokumenti bie në sy se mbi 85% e të diplomuarve në të gjithë programet, janë punësuar (<i>Evidenca 1.35</i>). Të dhënat e hartuara dhe të përpunuara shërbejnë si bazë për marrjen e masave të nevojshme me qëllim përmirësimin e këtyre treguesve (<i>Evidenca 6.7</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Sipas nenit 98/1, gërma c, të ligjit Nr. 80/2015, studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucionit të arsimit të lartë. Në përputhje me këtë parashikim ligjor, në nenin 47, pika 5, në lidhje me nenet 70, 16/1, 30, 32/3 të statutit të UNYT, përcaktohet se studentët kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e këtij universiteti dhe përfaqësohen në Këshillin Studentor, Senat, Këshillin e Etikës dhe në Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë (<i>Evidenca 1.1 "Statuti"</i>).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	E drejta për pjesëmarrje në vendimmarrjen e UNYT është garantuar në mënyrë efektive, kjo si në pikëpamje të akteve të brendshme rregulluese, ashtu dhe nga pohimet e studentëve, gjatë takimit të zhvilluar me ta. Emrat e studentëve, anëtarë të senatit, etj., mund të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>konsultohen lehtësisht në faqen zyrtare elektronike të institucionit (https://unyt.edu.al/index.php/executive-management/#sen) si dhe në dokumentacion (<i>Evidenca 6.2</i>). Mendimet e studentëve mblidhen në mënyrë periodike dhe shqyrtohen nga institucioni me qëllim marrjen e masave për ndërmarrjen e veprimeve në të ardhmen (<i>Evidenca 6.7, pika F</i>). Një prej studentëve është dhe anëtar i GVB (<i>RVB dhe evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>). Në RVB, f. 56, vihet në dukje se presidenti i Unionit Studentor ka marrë pjesë në takimet e rektoratit, sidomos lidhur me organizimin dhe zhvillimin e provimeve gjatë periudhës së pandemisë. Mendimi i studentëve është marrë dhe gjatë procesit të rishikimit të kurrikulave, nëpërmjet pyetësorëve përkatës.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programi i studimit, objekt vlerësimi, është hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesa e detyrimeve akademike të studentëve, duke pasur në vëmendje shtrirjen e viteve akademike, numrin e lëndëve, etj. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh një ngarkesë akademike të përhapur drejt gjatë vitit (<i>Evidenca 5.24</i>). Procedurat e parashikuara janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fushën e arsimit të lartë dhe synojnë të pakësojnë sa më shumë qasjen burokratike (<i>Evidenca 1.10</i>). Njohja e studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme rezulton e rregulluar nga aktet e brendshme si dhe strukturat e ngritura për këtë qëllim (<i>Evidenca 1.7, neni 7; Evidenca 1.10, neni 9; Evidenca 1.24</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>UNYT ka garantuar përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit në statut dhe në rregulloren e përgjithshme. Nga pikëpamja e realizimit të kriterit, studentëve u jepet mundësia të shprehen mbi elementet e programit të studimit (<i>Evidenca 6.9; Evidenca shitesë 1 "Vlerësimi i studentëve Spring 2020"</i>), mendime të cilët merren në shqyrtim nga strukturat përgjegjëse të institucionit, që shpie në rishikim apo përmirësim të këtyre elementeve (<i>Evidenca 6.7, pika F; Evidenca 6.1</i>). Përfshirja në këtë proces garantohej dhe nga Këshilli Studentor, veprimtaria e të cilit iu bëhet e njohur studentëve dhe online: https://unyt.edu.al/index.php/student-union/.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nenet 32-37 dhe 43-45 të Rregullores së programit të studimit përcaktojnë në mënyrë të detajuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentit nga pedagogu i lëndës, përfshi dhe procedurën e ankimit (<i>Evidenca 1.10</i>). Me këto rregulla studenti njihet dhe përmes manualit të studentit (<i>Evidenca 1.6</i>). Neni 45 i Rregullores së programit të studimit përcakton procedurën e saktë të kundërshtimit të rezultateve të provimit, ku studentët mund t'i drejtohen zyrës së çështjeve studentore dhe mandej procedura vijohet nga drejtuesi i departamentit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga takimet në institucion, nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë proces të ezauruar në të gjitha shkallët përkatëse lidhur</p>

	me procesin e vlerësimit të dijes, pasi çdo pretendim i studentëve, kur kanë pasur të tillë, është sqaruar nga pedagogu i lëndës. Është vënë në dispozicion vetëm një praktikë e rishikimit të vlerësimit për shkak të gjendjes shëndetësore (<i>Evidenca shitesë 3</i> ”; <i>Evidenca shitesë “Minutat e takimit”, takimet me stafin akademik, studentët dhe vizita në sekretarinë mësimore).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Institucioni është i angazhuar në fushën e kërkimit shkencor dhe në nxitjen e personelit akademik që të përfshihet në këtë veprimtari (<i>Evidenca 1.1, nenet 5, 6 dhe 25</i>). Për këtë qëllim, rezulton nga të dhënat e vëna në dispozicion si dhe nga takimi me stafin akademik, që anëtarët e tij kanë qenë pjesëmarrës në një sërë veprimtarish, si konferenca ndërkombëtare apo veprimtari kërkimore-shkencore. Në këtë drejtim, universiteti nxit dhe mbështet botimet e punimeve në revista të ndryshme shkencore (<i>Evidencat shitesë 4 “Politika e promovimit të stafit akademik, mbështetjen e personelit për pjesëmarrje në konferenca” dhe “Vendim i Bordit të Administrimit për miratimin e politikës për mbështetjen e personelit për pjesëmarrje në konferenca”</i> ; <i>Evidenca 1.41; Evidenca 2.12</i>).
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Në përputhje mesa ka përcaktuar në statut për fushën e kërkimit shkencor, rezulton që UNYT të ketë vendosur objektiva të qartë në këtë drejtim dhe të ketë lidhur marrëveshje konkrete ndërkombëtare, në nivel rajonal dhe më gjerë. Objektivat vlejné dhe për stafin akademik të këtij programi të studimeve (<i>Evidenca 1.12 “List of agreements and MoU-s”</i> ; <i>Evidenca 1.13 “Balkan University Association Membership Evidence”</i> ; <i>Evidenca 6.7, pika B</i>). Marrëveshjet e përbashkëta synojné në realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkët. Universiteti ka vënë në dispozicion të dhëna konkrete sipas të cilave, në kuadër të projekteve ku është angazhuar, ka organizuar disa aktivitete me pjesëmarrje të studentëve, ku përfshihet projekti i BE “Jean Monnet”. Në kuadër të tij, në muajin Shkurt 2020, në bashkëpunim me universitetin e Dubrovnik-ut (Kroaci), është organizuar shkolla dimërore “Strategjitë e demokratizimit dhe

	<p>pajtimit në Evropën Juglindore: ripërcaktimi i politikave joefektive”. Evidentohet shkolla verore në muajin Korrik 2019 “Angazhimi për miqësinë: Ndryshimi i kulturës politike në Ballkan”, po në kuadër të projektit “Jean Monnet”, në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane të Serbisë, si dhe shkolla dimërore “Krijimi i bashkëpunimit territorial: Ndikimi i dialogut ndërkulturor dhe rrjedhat e migrimit në Juglindje Evropë”, e zhvilluar nën të njëjtin projekt në muajin Dhjetor 2018, në bashkëpunim me universitetin e Bolonjës (Itali) (<i>Evidenca 2.8</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në fushën e kërkimit shkencor është një ndër objektivat e stafit akademik të këtij programi studimi (<i>Evidenca 6.7, pika B</i>).</p> <p>Në përputhje me këtë objektiv, studentëve u mundësohet marrja dizeni për aktivitetet e ndryshme ku mund të prezantojnë studime apo punime shkencore (<i>Evidenca 5.18</i>). Sipas RVB, f. 57, konfirmuar dhe gjatë vizitës në institucion, në muajin Prill 2020 ishte planifikuar një Kongres Studentor, me student vendas dhe të huaj, ku do të shpërndareshin punime kërkimore nga studentët sipas temave të zgjedhura nga komiteti i organizimit të eventit. Për shkak të situatës së pandemisë, kongresi nuk u mbajt në kohën e përcaktuar dhe u shty për t’u zhvilluar nëpërmjet platformës online. Aktiviteti në fjalë është përmendur me qëllim ilustrimin e përpjekjeve të stafit akademik dhe të IAL në përgjithësi për të nxitur punën kërkimore edhe tek studentët (<i>Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet që ka bërë në statut sa i përket fushës së kërkimit shkencor, nga aktet e administruar dhe nga vizita në institucion (<i>Evidenca shtesë “Minutat e takimit”</i>), konstatohet që universiteti siguron mbështetje për stafin akademik dhe për studentët, në drejtim të publikimit të punimeve të tyre në revista shkencore ndërkombëtare. Sipas shpjegimeve të dhëna në RVB, f. 57, buxheti propozohet nga anëtarët e departamentit, miratohet në vijim nga drejtuesi i departamentit, dekani e në fund nga rektori dhe Bordi i Administrimit (<i>Evidenca shtesë 5</i>). Rezulton që për kërkimin shkencor ka buxhet të veçantë, që lehtëson punën kërkimore (<i>Evidenca 4.23; Evidencat shtesë 4</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Synimi i institucionit në përgjithësi dhe i personelit akademik të këtij programi studimi në veçanti, për të nxitur dhe mbështetur studentët drejt studimeve inovative, shprehet në aktet e krijuara, që ilustrojnë këtë objektiv (<i>Evidenca 1.29; Evidenca 1.29.1; Evidenca 1.29.2; Evidenca 1.29.3; Evidenca 2.12</i>). Nëpërmjet shembullit të tyre dhe krijimit të mundësive për zbatim të marrëveshjeve me IAL të huaja, kërkohet të arrihet të menduarit ndryshe tek studentët e këtij programi, në përputhje me zhvillimet e reja objektive dhe për dhënien e ideve të reja në fushën e së drejtës. Në fakt disa prej studentëve kanë publikuar punime (të përzgjedhur si më të mirët) në “Albanian Law Journal”</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>(Evidenca shtesë 2), e cila mund të aksesohet dhe online: http://www.lawjournal.al.</p> <p>Institucioni ka sjellë shembuj të punimeve të studentëve, që synojnë trajtimin e problematikave të caktuara, në një frymë të re e bashkëkohore (Evidenca 1.19 dhe Evidenca 1.19.1).</p> <p>Në lidhje me angazhimin në drejtim të patentave, vlerësohet se nuk gjen zbatim për studentët e këtij programi të studimeve.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve, studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës.</p>	<p>Rregullat lidhur me diplomimin e studentëve janë përcaktuar në nenet 29, 30, 49 e 50 të rregullores së programit (Evidenca 1.10).</p> <p>Shtjellimi i rregullave për punimin e diplomës është realizuar në dokumentin specifik të udhëzuesit për punimin e saj (Evidenca 1.33). Sikundër raportohet dhe në faqen 57 të RVB, gjatë këtij procesi, studentët mbajnë kontakte të rregullta me pedagogët dhe këshilltarët e tyre, ku sipas nevojave të punimit që është duke u kryer, marrin dhe ndihmën e duhur për secilin nga aspektet që lidhet me punimin e një diplome.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.7</p> <p>Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit</p>	<p>UNYT i ka mëshuar politikës së bashkëpunimit me organizmat shkencorë ndërkombëtare, duke e shprehur fillimisht këtë në statutin e institucionit dhe në dokumente të tjerë të brendshëm strategjikë (Evidenca 1.1, neni 8; Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 3). Në përputhje me këto përcaktime, brenda institucionit është ngritur dhe funksionon zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare që mundëson vënien në praktikë të politikave të bashkëpunimit (Evidenca 1.1, neni 55). Gjithashtu, vlen të përmendet dhe hartimi i një strategjie të posaçme të ndërkombëtarizimit që përfshin periudhën 2020-2025 (Evidenca 1.14).</p> <p>Vërehet nga aktet se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh për arritjen e këtij objektivi, me disa universitete të vendeve të BE-së (Evidenca 1.12) si dhe është bërë pjesë e programeve Erasmus, për të siguruar mobilitetin e stafit dhe studentëve (Evidenca 1.12; Evidenca 1.15). Për të siguruar në vijimësi infomacione mbi mundësinë e granteve dhe bashkëpunimin, institucioni qëndron në kontakt me zyrën kombëtare Erasmus+, Tiranë, si dhe me Agjencinë për Kërkime,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Teknologji dhe Inovacion, Tiranë (Evidenca 1.12.3). Mobiliteti i studentëve, i stafit akademik dhe atij administrativ mundësohet edhe nëpërmjet programeve Mevlana (Evidenca 1.12). Gjithsesi, nga të dhënat e administruara nuk rezulton që ndonjë prej studentëve të këtij programi studimi të jetë mobilizuar nga dhe drejt programit të studimit (Evidenca 2.1, tabela 20).</p> <p>Rëndësi paraqet në këtë drejtim aplikimi për programet Jean Monnet dhe Erasmus+ nga qendrat kërkimore të universitetit që ka sjellë krijimin e moduleve të rinj si “E drejta për refugjatët” dhe “Çështjet e shëndetit të BE” (Evidenca 1.29.1; Evidenca 1.29.2; Evidenca 1.29.3).</p> <p>UNYT rezulton gjithashtu që të jetë bërë pjesë e një grupi arsimor në pronësi të fondacionit turk Maarif, nën siglën “International Maarif Schools”, që vepron në mbi 40 vende të globit, të dhënat mbi të cilin mund të konsultohen dhe në faqen online të universitetit: https://unyt.edu.al/index.php/turkish-maarif-foundation/.</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Aktet e brendshme të universitetit nxitin stafin akademik në përdorimin e metodave të tilla të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për të ndjekur ciklin e tretë të studimeve (Evidenca 1.10, neni 6; Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 1). Studentët ndiqen me vëmendje gjatë gjithë jetës së tyre studentore, në punimet që kryejnë dhe veprimtaritë ku marrin pjesë, duke u udhëzuar dhe për politikën e citimit të punimeve të autorëve të tjerë, me qëllim ruajtjen e së drejtës së autorit (Evidenca 1.6; Evidenca 5.19). Programet e lëndëve nga ana tjetër, janë ndërtuar në mënyrë të tillë që garantojnë po ashtu vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve (Evidenca 2.2).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendas dhe të huaj në projekte kërkimore.</p>	<p>Përpjekjet pozitive të universitetit në drejtim të përfshirjes së studentëve vendas dhe të huaj në projekte kërkimore gjejnë shprehje së pari në aktet e brendshme të IAL (Evidenca 1.1, neni 25; Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 2; Evidenca 6.7, pika B, research objective 2-3). Në funksion të përmbushjes së këtij kriteri dhe përfshirjen e studiuesve të rinj në projekte kërkimore kombëtare e ndërkombëtare, departamenti ka fituar dhe është pjesë e projekteve Jean Monnet (Evidenca 1.29; Evidenca 1.29.1; Evidenca 1.29.2 dhe Evidenca 1.29.3).</p>
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Institucioni ka krijuar bazën e nevojshme në fushën e kërkimit shkencor, ku mund të përfshihen dhe kërkuesit shkencorë të huaj (Evidenca 1.1, nenet 25-29). Politikën përfshijnë një gamë të gjerë të kërkimit, ku ndërthuren disiplina të ndryshme të shkencave shoqërore, që nuk përfshijnë vetëm një vend të caktuar. Fokusi i përgjithshëm i kërkimit është përqendruar në problemet e organizimit shoqëror, ekonomik dhe politik me karakter global, por duke mbajtur në vëmendje dhe veçoritë kombëtare specifike. Kryesisht, është</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>planifikuar që kërkimi në këtë fushë do të përqendrohet në demokracinë dhe zhvillimin në Shqipëri, që lidhet dhe me programin e studimit, objekt vlerësimi. Për arritjen e këtij objekti, universiteti vepron nëpërmjet qendrave të tij kërkimore, që sigurojnë akses dhe për kërkues të huaj (<i>Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 2; Evidenca 2.12</i>). Nuk ka të dhëna lidhur me numrin e kërkuesve shkencorë të huaj.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Politika favorizuese e universitetit ndaj mobilitetit të studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare shprehet më së miri në aktet e brendshme të tij (<i>Evidenca 1.1, neni 8; Evidenca 1.14.1</i>). Një ndër objektivat e IAL është zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore, me qëllim që t'u ofrohet studentëve përvojë ndërkombëtare (<i>Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 3</i>). Është Zyra e marrëdhënëve ndërkombëtare struktura, e cila është ngarkuar me detyrën për të mundësuar lëvizjen e studentëve dhe shkëmbimit të studentëve e personelit në përgjithësi (<i>Evidenca 1.1, neni 55; Evidenca 5.20; Evidenca shitesë 7 "Open Call Mobility Programs"</i>). Praktikisht, UNYT realizon mobilitetin përmes programeve Erasmus dhe Mevlana, nga të cilët ka përfituar në vijim të aplikimeve përkatës (<i>Evidenca 1.12</i>).</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore.</p>	<p>Në përputhje me qëllimin e tij strategjik, universiteti, gjatë realizimit të veprimtarive kërkimore dhe të mësimdhënies, mundëson pjesëmarrjen e personelit akademik të huaj si dhe të studentëve të huaj (<i>Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 3</i>). Edhe në këtë aspekt, rolin kryesor e luan Zyra e marrëdhënëve ndërkombëtare (<i>Evidenca 1.14.1; Evidenca 1.14</i>). Në funksion të strategjisë së ndërmëtarizimit të UNYT, kjo zyrë inkurajon shkëmbimin e stafit për të tërhequr personel ndërkombëtar akademik të kualifikuar (<i>Evidenca 1.1, neni 55</i>). Nga aktet rezulton që në programin e studimit është aktivizuar personel akademik i huaj (<i>Evidenca shitesë 11</i>). Staf akademik i huaj është përfshirë dhe në veprimtaritë e ndryshme të organizuara nga universiteti (<i>Evidenca 1.16</i>).</p> <p>Nga ana tjetër, universiteti ndjek politika pozitive dhe në drejtim të studentëve të huaj, për periudha të ndryshme kohore. Ndihma u jepet këtyre studentëve në pikëpamje akademike, e lehtësuar mjaft nga rregullimet e brendshme që ka bërë universiteti për këtë qëllim (<i>Evidenca 1.10, neni 8; Evidenca 1.14; Evidenca 5.11</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>UNYT ka parashikuar procedura e njësi të posaçme në drejtim të informimit dhe shërbimit ndaj studentëve në statut dhe në rregulloren e programit, siç janë sekretaria mësimore, zyra e karrierës, zyra e pranimeve, zyra e këshillimit (<i>Evidenca 1.1, neni 9, pika III</i>), me të cilat studenti njihet në mënyrë të përgjithshme në momentin e nënshkrimit të kontratës me IAL (<i>Evidenca 5.7 dhe Evidenca 5.8</i>) si dhe nëpërmjet manualit të studentit (<i>Evidenca 1.6</i>). Informimi dhe shërbimi ndaj studentit realizohet nga sekretaria mësimore, në nivel departamenti si dhe një rol mjaft të rëndësishëm në këtë aspekt luan dhe këshilluesi akademik (<i>Evidenca 1.10, neni 18</i>). Gjithashtu, informacionin e nevojshëm dhe zyrat që realizojnë shërbimet përkatëse janë të publikuara dhe në faqen online të UNYT.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët gjatë vizitës në institucion, konstatohet që ata marrin këshillimin dhe mbështetjen e nevojshme përgjatë kohëvazhimit të procesit mësimor të programit të studimit (<i>Evidenca shtesë "Minutat e takimit"</i>). Institucioni ka ngritur një sistem të posaçëm për këtë qëllim, ku rol kryesor luan departamenti dhe stafi akademik, zyrat e administratës së IAL, Qendra e këshillimit të studentëve, Zyra e çështjeve studentore, Zyra e karrierës si dhe këshilluesi akademik, i cili ka për detyrë të udhëzojë studentët që të regjistrohen në kurse, të zbulojnë interesat dhe talentin e tyre, të ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (<i>Evidenca 1.1, neni 47, 48, 54, 60; Evidenca 1.10, neni 18</i>).</p> <p>Platformat e komunikimit janë të larmishme dhe synojnë shkëmbimin e saktë dhe të shpejtë të informacioneve të ndryshëm, përmes faqes zyrtare të IAL online, rrjeteve sociale të komunikimit, postës elektronike dhe njoftimeve nga instruktorët (<i>Evidenca 5.13</i>).</p> <p>Përgjatë periudhës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, UNYT ka miratuar në mënyrë të menjëhershme platformën elektronike e-learning, e cila është përdorur gjatë gjithë procesit të mësimdhënies (<i>Evidenca 3.7; Evidenca 5.21</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit</p>	<p>Ndër njësitë e ngritura brenda strukturës së UNYT janë Qendra e Këshillimit të Studentëve (<i>Evidenca 1.1, neni 60</i>) dhe Zyra e Alumni dhe Karrierës (<i>Evidenca 1.1, neni 54</i>).</p> <p>Nëpërmjet zyrës së këshillimit studentëve u jepet mbështetje dhe ndihmë psikologjike, duke mbrojtur të drejtën e tyre të privatësisë. Zyra në fjalë ndihmon studentët që të kuptojnë pikat e tyre të forta</p>




<p>mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>akademike dhe rritjen e potencialit të të nxënit, të nxitë të mësuarit gjatë gjithë jetës, të lehtësojë procesin e rritjes së dijeve duke krijuar një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues midis studentëve, personelit akademik dhe personelit mbështetës.</p> <p>Nëpërmjet zyrës së karrierës dhe alumni, mundësohet mbështetja për studentët që të integrohen me sukses në tregun e punës. Kjo zyrë iu siguron studentëve dhe të diplomuarve udhëzime dhe orientime që i ndihmojnë ata për të planifikuar karrierën e tyre të ardhshme në një treg pune në zhvillim e sipër (<i>Evidenca 1.20; Evidenca 1.20.1</i>). Mirëorganizimi i punës së kësaj zyre vërehet dhe nga miratimi i një rregulloreje të posaçme për funksionimin e saj si dhe të planveprimit (<i>Evidenca 5.16; Evidenca 5.16.1</i>).</p> <p>Këshilluesi akademik ka për detyrë të udhëzojë studentët që të regjistrohen në kurse, të zbulojnë interesat dhe talentin e tyre, të ndjekin punën akademike dhe japin udhëzime në të gjitha çështjet arsimore (<i>Evidenca 1.9, neni 13; Evidenca 5.14</i>).</p> <p>Institucioni siguron gjithashtu këshillimin për kryerjen e praktikës profesionale nga studentët (<i>Evidenca 1.9, neni 19; Evidenca 1.10, neni 29</i>). Rregullorja për praktikën nuk rezulton të jetë miratuar nga universiteti dhe nuk rezulton në aktet e vënë në dispozicion. Institucioni ka lidhur disa marrëveshje me institucione publike e private, ku ata planifikohet të zhvillojnë praktikën profesionale (<i>Shembull: Evidenca 1.28</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nëpërmjet Zyrës së alumni-t dhe karrierës, institucioni siguron të dhëna për studentët, për fazën pas diplomimit të tyre lidhur me mundësitë për zënie me punë (<i>Evidenca 5.16</i>). Në funksion të veprimtarisë së kësaj zyre është hartuar dhe planveprimi i zyrës së karrierës (<i>Evidenca 5.16.1</i>).</p> <p>Zyra mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve që i përkasin këtij programi studimi (<i>Evidenca 2.1, tabela 23</i>). Zyra disponon të dhëna dhe për alumni-t e punësuar nga vetë IAL (<i>Evidenca shitesë "Minutat e takimit"</i>).</p> <p>Të dhënat administrohen në përputhje me Rregulloren për zyrën e karrierës dhe alumni-t. Sikundër vërehet nga evidencat shitesë të cituara, statistika të punësimeve, këto të dhëna iu vihen në dispozicion organeve drejtuese të IAL. Plani i punës së kësaj zyre dhe koha e aktiviteteve prezantohen tek rektori i universitetit. Të dhëna të tjera mbi veprimtarinë e kësaj zyre, mbi alumni-t, mundësitë për punësim, etj., mund të aksesohen dhe online në faqen zyrtare të universitetit: https://unyt.edu.al/index.php/cso02/.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në përputhje me parashikimet e nenit 103 e vijues të ligjit Nr. 80/2015, IAL ka bërë parashikime në aktet e brendshme rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, përkatësisht në nenin 30 të statutit (<i>Evidenca 1.1</i>).</p> <p>Mbi këtë bazë, institucioni ka hartuar politikat përkatëse në këtë drejtim si dhe strukturat e nevojshme, që merren me monitorimin dhe përmirësimin në vijimësi të cilësisë, në nivel institucional. Detyrat e njësive lidhen me garantimin e plotësisht të standardeve të cilësisë në procesin akademik nga ana e strukturave dhe organeve të institucionit (<i>Evidenca 6.1 "Quality Assurance Manual"</i>).</p> <p><i>Parë parashikimet e neneve 32/3 dhe 33/5, 7 të statutit të UNYT, GVJ gjen me vend të rekomandojë miratimin nga strukturat drejtuese të këtij universiteti të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë dhe të Rregullores për funksionimin e Njësive të sigurimit të cilësisë, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet që këto rregullore nuk janë miratuar.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në vijim të parashikimeve të bëra në statutin e tij, në strukturat e UNYT përfshihet Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore (<i>Evidenca 1.1, neni 33</i>). Këtë veprimtari, kjo njësi e kryen në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë, ku njëri prej anëtarëve vjen nga studentët (<i>Evidenca 1.1, neni 32</i>).</p> <p>Sa i përket strategjisë, rëndësia që i ka dhënë IAL nuk shprehet vetëm në mënyrë të përgjithshme në strategjinë institucionale (<i>Evidenca 1.5</i>,</p>

	<p><i>objektivi Nr. 1</i>), por politika të detajuara janë shprehur në manualin për sigurimin e brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 6.1</i>).</p> <p>Në këtë proces dhe struktura janë përfshirë dhe studentët (garantuar nga parashikimi përkatës në statutin e IAL), të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Gjithashtu, në këtë proces është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, neni 75 i statutit (<i>Evidenca 1.1</i>), gjithashtu parashikohet mundësia e partneriteteve që kanë ndikim në sistemin e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 6.1, f. 24-25</i>).</p> <p>Përmirësimi i sigurimit të cilësisë mundësohet në këtë drejtim dhe nga përfshirja e UNYT në projektin Erasmus+ “Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të sigurimit të cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri”, projekt i cili fokusohet në mbështetjen e proceseve për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmave për sigurimin e menaxhimit efektiv dhe përmirësimin e mësimdhënies në IAL private në Republikën e Shqipërisë (<i>Evidenca 6.15; Evidenca 6.16; Evidenca 6.17</i>).</p> <p><i>GVJ rekomandon angazhimin dhe të një përfaqësuesi nga institucionet me të cilët bashkëpunon institucioni për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Institucioni përdor metoda të ndryshme për vlerësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe vlerësimit të brendshëm të institucionit, të cilat janë detajuar në manualin e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 6.1</i>).</p> <p>Informacioni që institucioni siguron nga studentët dhe nga stafi akademik lidhet me aspekte të mësimdhënies, të programeve dhe të lëndëve mësimore. Metodatat që përdoren janë: peticioni akademik, vlerësimet e studentëve (për pedagogët), raportet e vetëvlerësimit, vlerësimi i pedagogëve nga supervisorët për secilin pedagog (<i>Evidencat 6.6; 6.8.1; 6.9; 6.10; 6.10.1; 6.11; 6.12; 6.13; 6.14</i>).</p> <p>Në mënyrë periodike, institucioni realizon vlerësimin e jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Cilësisë në arsimin e lartë, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me ekspertë të huaj, në vijim të të cilëve merr masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në nenet 32 e 33 të statutit si dhe në strategjinë e tij të brendshme, UNYT ka paraqitur politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit (<i>Evidenca 1.1; Evidenca 1.5, objektivi strategjik Nr. 1</i>), të shtjelluara në mënyrë të hollësishme dhe në manualin e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 6.4</i>).</p> <p>Vlerësimi kryhet në mënyrë periodike. Njësia e Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo njësi organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit. Mbi bazën e të dhënave të marra nga pyetësori studentor dhe</p>

	<p>informacioneve të tjerë, hartohet raporti i vlerësimit vjetor (<i>Evidenca 1.1, neni 33/1</i>).</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i strukturave dhe programeve të studimit kryhet periodikisht sipas parashikimeve të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë ndërmjetëson, harton dhe jep raporte për aktivitete dhe nisma të reja që lidhen me sigurimin e cilësisë për të gjitha njësitë e UNYT përmes Koordinatorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Njësisë së Sigurimit të Cilësisë. Funksionimi i Komisionit rregullohet nga manuali i sigurimit të cilësisë, i hartuar dhe miratuar nga vetë Komisioni në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Përgjegjësitë kryesore të Komisionit kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përpilimin e një raporti vjetor vetëvlerësimi (institucional dhe programor); - Promovimin dhe nxitjen e vetëdijes së brendshme për të gjitha njësitë për çështje të cilësisë; - Krijimin e besueshmërisë për vlerësimin e jashtëm për të gjitha palët e interesuara; - Ofrimin e asistencës dhe informacionit të azhurnuar për çështjet e sigurimit të cilësisë duke iu përmbajtur kërkesave të reja ligjore (<i>Evidenca 6.1, f. 14-15</i>). <p>Manuali, në këtë drejtim siguron parashikimin e procedurave që do të ndiqen si dhe jep modelet për secilin prej formularëve të vlerësimit. Në mbështetje të përmirësimit në vijimësi të cilësisë së mësimdhënies, është formuluar dhe strategjia e mësimdhënies, ku janë shprehur objektiva specifike dhe të arritshëm (<i>Evidenca 6.18</i>).</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.	Nga aktet rezulton që struktura përgjegjëse në nivel institucional për monitorimin e cilësisë është Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit, i cili zgjidhet nga senati akademik, me misionin e zhvillimit dhe forcimit të sistemit të cilësisë në UNYT në mënyrë që t'i shërbejë nevojave të komunitetit universitar dhe organeve të tjera të interesuara që lidhen me cilësinë e institucionit dhe programet e studimit të ofruara nga UNYT (<i>Evidenca 1.1, neni 32</i>). Ky komision është përgjegjës për koordinimin e procedurave të vlerësimit

	<p>të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme, kërkimin shkencor dhe vetë Universitetin. Komisioni mbikëqyr dhe harton rregulloret, politikat, programet, proceset akademike dhe joakademike, si dhe siguron respektimin e kornizës ligjore duke siguruar cilësi në UNYT në bashkëpunim me të gjithë partnerët institucionalë dhe palët e interesuara (<i>Evidenca 6.8, f. 14: Evidenca 6.2; Evidenca 6.3; Evidenca 6.3.1; Evidenca 6.3.2</i>).</p> <p>Komisioni ka në përbërje të tij anëtarë nga të gjithë fakultetet, studentët dhe një anëtar të jashtëm. Në nivel të njësisë bazë, të gjitha veprimtaritë e departamentit përfshihen në raportin vjetor të departamentit (<i>Evidenca 6.1</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UNYT planifikojnë dhe organizojnë vlerësimin e brendshëm të cilësisë si për programet e studimit, ashtu dhe për institucionin. Kryerja e procedurave, përmes mekanizmave të përcaktuar nga këto struktura, bëhet në mënyrë periodike mbi programin e integruar të studimit në drejtësi.</p> <p>Drejtimet e vlerësimit janë të ndarë sipas zërave përkatës në manualin për sigurimin e cilësisë dhe përfshijnë vlerësimet e studentëve në bazë kursi, vlerësimet e personelit akademik për njëri-tjetrin, formën individuale të vlerësimit të performancës së pedagogëve, formën e transparencës së notave, vlerësimin në raportet vjetore mbi procesin e të mësuarit dhe standardet përkatëse të cilësisë të departamentit në fund të vitit akademik (<i>Evidenca 6.1</i>). Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi (<i>Evidenca 1.1, neni 33</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në manualin për sigurimin e cilësisë, institucioni ka parashikuar shfrytëzimin e metodologjive të vlerësimit, instrumenteve të matjes dhe vlerësimit për programet e studimit në një formë përshkrimore dhe sipas shtojcave bashkëngjitur tij. <i>GVJ vlerëson të rekomandojë hartimin dhe miratimin e rregullores së NJSBC ku të specifikohen metodat për kryerjen e vlerësimit, indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik e në tërësi instrumentet matës dhe vlerësues.</i> Në tërësi këto mjete përdoren nga Komisioni për sigurimin e cilësisë si dhe zyra e sigurimit të cilësisë, në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve (<i>Evidenca 6.8</i>). Mekanizmat e përdorur janë procesi i vlerësimit të studentëve, përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të të mësuarit, procesi i vlerësimit të anëtarëve të personelit akademik, procesi i vetëvlerësimit të pedagogëve (<i>Evidenca 6.8; 6.8.1; 6.10; 6.10.1; 6.11; 6.12; 6.13; 6.14</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në analizë të procedurave të parashikuara në manualin përkatës, të gjitha procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen në periudha të rregullta dhe të gjitha rezultatet e performancës, me propozimet përkatëse, i paraqiten Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së</p>

	<p>Institucionit dhe Senatit, nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikat e miratuara.</p> <p>Vlerësimet programore dhe të departamenteve planifikohen për çdo vit akademik bazuar në kërkesat e partnerit kombëtar dhe ndërkombëtar. Dokumenti i manualit të sigurimit të cilësisë vlerësohet në mënyrë periodike. Të gjitha informacionet në lidhje me politikat dhe praktikat për sigurimin e cilësisë në UNYT janë të arritshme për të gjitha grupet dhe njësitë e interesuara përfshirë organet e studentëve (<i>Evidenca 6.1, f. 10-11</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Përveç formularëve të pyetësorëve, etj., manuali përmban dhe elementet që duhet të ketë raporti vjetor i vlerësimit (<i>Evidenca 6.1, shtojca</i>). Raporti duhet të përmbajë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga subjekte të ndryshëm, duhet të përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik. Në nivel departamenti, në raportin vjetor të departamentit, bazuar në rezultatet e vlerësimeve, hartohet një plan veprimi për masat e marra për adresimin e mangësive për vitin pasardhës akademik (<i>Evidenca 6.7</i>). Raporti vjetor institucional siguron të dhëna që në vijim shërbejnë për marrjen e vendimeve për miratimin e planveprimeve në kuadër të përmirësimit dhe zhvillimit të programeve të studimit (<i>Evidenca 6.2</i>).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion vërehet që programi i studimit vlerësohet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë në nivel departamenti. Në përfundim të vitit akademik, mblidhen të dhënat sipas burimeve të përcaktuar në manualin për sigurimin e cilësisë, informacion i cili përfshihet më pas në raportin vjetor të departamentit, që vlerëson mësimdhënien, të nxënit, transparencën e notave dhe standarde të tjerë të cilësisë. Rezultatet e performancës, me propozimet përkatës, i dorëzohen Komisionit të Përhershëm të Cilësisë dhe senatit akademik. Raporti bëhet në vijim pjesë e raportit vjetor mbi ecurinë akademike si dhe e vetëvlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional</p>

	(Evidenca 6.1; Evidenca 6.7; Evidenca 6.2; Evidenca 6.10; Evidenca 6.10.1).			
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Institucioni ka parashikuar në aktet e brendshme instrumentet që do të përdoren për kryerjen e vlerësimit (Evidenca 6.1 – Shtojca). Gjithashtu, në të njëjtin dokument janë specifikuar drejtimet dhe metodat për kryerjen e matjeve dhe vlerësimit si dhe indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik (Evidenca 6.1). Instrumentet dhe metodat shërbejnë për hartimin e raportit vlerësues të programit të studimit dhe përmirësimit të tij, nëse rezulton e nevojshme.			
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Metoda të drejtpërdrejta, të përmendura shprehimisht në manualin për sigurimin e cilësisë, nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë. Si metoda të tilla përmenden vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve nëpërmjet plotësisht të pyetësorëve përkatës, vlerësimi i didaktikës nga kolegët. Metoda të tjera në këtë drejtim janë përmendur në f. 62 të RVB për promovimin e mësimdhënies: seminarët akademike, procesi i rishikimit të syllabuse-ve, programet e këshillimit (Evidenca 1.16; Evidenca 2.9; Evidenca 3.3). Gjithashtu, çdo semestër, fakultetet bëjnë transparencë në vlerësimin e studentëve për të identifikuar dhe shmangur vlerësimet e padrejta (Evidenca 6.8; Evidenca 6.8.1). GVJ gjen me vend të rekomandojë specifikimin e metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit të cilësisë në manualin ose rregulloren për sigurimin e cilësisë, në mënyrë që të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Metoda të tërthorta të përmendura shprehimisht në manualin për sigurimin e cilësisë nuk janë të evidentuara, por këto metoda mund të nxirren nga interpretimi i akteve si dhe referuar dokumentacionit të sjellë. Si metoda të tërthorta rezultojnë të përdoren: procesi i vlerësimit të studentëve, marrja e mendimit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies dhe për institucionin, marrja e mendimit nga personeli akademik, ndihmësakademik dhe administrativ si dhe strukturave përgjegjëse (Evidenca 6.4; Evidenca 6.5; Evidenca 6.6; Evidenca 6.8; Evidenca 6.9; Evidenca 6.10). GVJ gjen me vend të rekomandojë specifikimin e metodave të tërthorta të vlerësimit të cilësisë në manualin ose rregulloren për sigurimin e cilësisë, në mënyrë që të jenë të qarta dhe të kuptueshme për t'u përdorur në praktikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi VI.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, në aktet e tij të brendshëm dhe në politikat e procedurat e brendshme të cilësisë, ka parashikuar dhe figurat që përfshihen në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca 1.1, nenet 32 e 33; Evidenca 6.1</i>).</p> <p>Në këtë proces janë përfshirë njësitë bazë, stafi akademik, por dhe studentët, të cilët japin kontributin e tyre gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve (<i>Evidenca 2.1, tabela 24</i>). <i>Në statut nuk ka parashikime të veçanta për bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm.</i> Ekspertë të jashtëm janë parashikuar në Manualin e sigurimit të cilësisë vetëm për fushën e kërkimit dhe arritjet përkatëse (<i>Evidenca 6.1, f. 25-26</i>).</p> <p>Në f. 63 të RVB përshkruhet se angazhimi i UNYT si partner në projektin Erasmus+:QainAL si dhe trajnimet, i kanë shërbyer institucionit dhe palëve të interesuara për përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca 6.15; Evidenca 6.16; Evidenca 6.17</i>).</p> <p><i>Mungojnë ekspertët e jashtëm që do të mund të kontribuonin në hartimin e raportit të vlerësimit, sidomos për këtë program studimi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Institucioni, në vijim të parashikimeve ligjore të aplikueshme, ka përcaktuar detyrat që duhet të përmbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë, të nivelit bazë dhe institucional. Detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenet 32-33 të statutit (<i>Evidenca 1.1</i>). <i>Në nivel departamenti të këtij programi studimi, nuk ka përcaktime në rregulloren e programit.</i> Nga shqyrtimi i rregulimeve të brendshme konstatohet që, formalisht, ushtrimi me përgjegjësi i detyrave në drejtim të sigurimit të cilësisë, është i garantuar (<i>Evidenca 6.1, f. 10</i>), por <i>rekomandohet detajimi i përgjegjësive dhe detyrave në rregulloret e posaçme të njësive të sigurimit të cilësisë, sikundër është parashikuar në statut.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me rregullimet e bëra nga statuti i UNYT, neni 32, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë janë jo më pak se 5 anëtarë dhe jo më shumë se 7 të tillë, nga të cilët një anëtar është përfaqësues i studentëve (<i>Evidenca 1.1</i>). Stafi akademik dhe administrativ merr përsipër rolin kryesor në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Komisionin e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Njësisë duke siguruar përgjegjësinë institucionale. Senati ka përgjegjësinë finale për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. (Evidenca 6.1, f. 10-11).			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Sipas përcaktimeve statutores dhe manualit të nxjerrë për këtë qëllim, vlerësimi i brendshëm i cilësisë konceptohet dhe zbatohet mbështetur në standardet profesionale, duke zbatuar parimin e pavarësisë institucionale. Struktura, roli dhe përgjegjësitë e sistemit dhe organeve të sigurimit të cilësisë bazohen në kornizën ligjore të aplikueshme dhe në organizimin e brendshëm të institucionit. Duke mbajtur parasysh dhe qëllimet e vlerësimit si dhe mënyrat e marrjes dhe administrimit të të dhënave, procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk synon të krijojë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve (Evidenca 6.1). Ky fakt nuk rezultoi as gjatë takimeve me grupin e pedagogëve dhe të studentëve në institucion (Evidenca shtesë "Minutat e takimit").			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në <i>statutin e UNYT nuk ka parashikime të veçanta për bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm.</i> Ekspertë të jashtëm janë parashikuar në Manualin e sigurimit të cilësisë vetëm për fushën e kërkimit dhe arritjet përkatëse (Evidenca 6.1, f. 25-26). Qenia partner dhe pjesëmarrja në projektin e Erasmus+ QainAL "Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të sigurimit të cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri", i ka vlejtur këtij institucionin në drejtim të përmirësimit të praktikave të sigurimit të cilësisë (Evidenca 6.15; Evidenca 6.16; Evidenca 6.17).			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të UNYT, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme jo vetëm nga studentët, por dhe nga çdo i interesuar. Sipas Manualit për sigurimin e cilësisë, të gjithë informacionet në lidhje me politikat dhe praktikën për sigurimin e cilësisë në UNYT janë të arritshme për të gjitha grupet dhe njësitë e interesuara, përfshirë organet e studentëve (Evidencat 6.1, f.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>11). Sipas RVJ, f. 64, politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë për këtë program studimi, janë të shpallura në manualin për sigurimin e cilësisë, statutin dhe rregulloren e UNYT (rregullorja e përgjithshme mungon dhe nuk rezultojnë të jetë e miratuar), në buletin e studentëve dhe në raporte zyrtare të hartuar nga ky institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Të dhënat e vjela gjatë procedurave të ndjekura për sigurimin e cilësisë, vlerësimet e studentëve, përfshi konkluzionet dhe komentet, përpunohen në mënyrë elektronike dhe iu njoftohen instruktorëve përkatës, pasi lënda të jetë zhvilluar plotësisht. Nga ana tjetër, formulari për vlerësimin e kolegut nënshkruhet nga instruktori dhe vlerësuesi i tij, me komentet dhe propozimet përkatës. Në këtë proces, drejtuesi i departamentit dhe dekani janë në dijeni të rezultateve të procesit (<i>Evidenca 6.11; Evidenca 6.12</i>).</p> <p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së të dhënave të përshkruara në raportet përkatës si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezultojnë që të jetë cenuar liria dhe etika akademike apo të jenë cenuar të dhënat personale (<i>Evidenca 6.4; Evidenca 6.5; Evidenca 6.8; Evidenca 6.9; Evidenca 6.10.1</i>). Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave të sakta mbi programet e studimit dhe përmirësimi i këtyre të fundit.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni i përdor të dhënat që dalin nga vlerësimi i stafit akademik në funksion të rritjes së cilësisë së procesit akademik dhe në përgjithësi të cilësisë në rang universiteti. Të dhënat që rezultojnë nga pyetësorët, etj., shërbejnë për hartimin në vijim të planit të masave që duhen marrë në vijim nga strukturat drejtuese të universitetit në rang fakulteti dhe në rang institucional. Të gjitha procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen në periudha të rregullta dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i paraqiten Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Senatit, nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikat e miratuara. Vlerësimet programore dhe të departamenteve planifikohen për çdo vit akademik bazuar në kërkesat e partnerit kombëtar dhe ndërkombëtar. Dokumenti i Manualit të Sigurimit të Cilësisë vlerësohet në mënyrë periodike (<i>Evidenca 6.1, f. 10; Evidenca 6.2; Evidenca 6.8.1</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e rregullimeve specifike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave në rrjedhim të veprimtarive që monitorojnë vlerësimin e cilësisë nga ana e institucionit, dëshmon rëndësinë që universiteti i kushton këtij procesi. Sipas manualit për sigurimin e cilësisë, nëpërmjet procesit vlerësues synohet të përcaktohet nëse ka nevojë për ndryshime institucionale në politikat dhe praktikat e miratuara (<i>Evidenca 6.1, f. 10</i>). Institucioni ka parashikuar procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të</p>

	administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë (<i>Evidenca 1.5; Evidenca 6.7; Evidenca 6.8.1</i>).			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Rezulton nga të dhënat e vëna në dispozicion se institucioni ka organizuar veprimtari në vijimësi me personelin, por dhe me studentët, me qëllim që të jenë të informuar dhe të ndërgjegjësuar për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi e më gjerë, në vazhdimësi (<i>Evidenca 6.15; Evidenca 6.16; Evidenca 6.17</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Integruar në “Drejtësi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i New York-ut në Tiranë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit është i hartuar sipas standardeve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, duke reflektuar disa nga aspektet pozitive të tij tek programi i integruar i ri të studimeve në drejtësi.
2. Institucioni disponon ambiente të bollshme dhe me standardet e duhura për zhvillimin e programit të studimit, e pajisur me mjetet e përshtatshëm nga pikëpamja logjistike, por edhe nga pikëpamja rekreative.
3. Biblioteka garanton një akses të bollshëm në literaturën e nevojshme të programit dhe fushës së drejtësisë në përgjithësi, si fizikisht ashtu edhe online.
4. Shërbimet IT sigurojnë mbulimin e shërbimeve online dhe kanë patur rol të rëndësishëm për realizimin e procesit mësimor në kohë dhe sipas kërkesave të stafit dhe studentëve edhe gjatë pandemisë.
5. Zyra e karrierës luan një rol të rëndësishëm lidhur me bashkëpunimin me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës përgatitjen e studentëve për tregun e punës në sektorin publik apo privat.

Pika të dobëta:

1. Mungon një rregullore institucionale e plotë.
2. Mungon një strategji zhvillimore e posaçme lidhur me Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.
3. Mungojnë plane të detajuara kërkimore dhe orientimi i stafit lidhur me kërkimin që mund të kryejnë në grup apo në mënyrë individuale.
4. Mundësitë për trajnimin profesional të stafit akademik janë të kufizuara.

Rekomandime:

GVJ rekomandon si më poshtë:

1. Klinika e ligjit mund të jetë më funksionale apo të jetë më e përfshirë në gjyqet simuluese me qëllim aftësimin praktik të studentit.



2. Prezenca e një koordinatori të posaçëm të programit të studimit, do të lehtësonte punën e përgjegjësit të departamentit. Sugjerohet, në këtë pikë, të caktohet një anëtar departamenti në rolin e koordinatorit të programit.
3. Të përmirësohet përfaqësimi dhe efektiviteti i pjesëmarrjes së studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese si këshilli i fakultetit dhe senati akademik i UNYT.
4. Të shtohen mekanizmat për rritjen e autonomisë financiare të fakultetit dhe departamentit duke qenë se aktualisht ka një varësi të theksuar nga organizmat qendrore.
5. Të zhvillohet një strategji për zhvillimin shkencor që do të bashkërendonte aktivitetet në këtë fushë.
6. Të hartohet një udhëzues për metodat e mësimdhënies, kualifikimin e stafit akademik apo mënyrën e funksionimit të mbikqyrjes së procesit të mësimdhënies.
7. Të hartohet edhe një rregullore e plotë institucionale.
8. Të hartohet një strategji zhvillimore e posaçme lidhur me Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.
9. Duke qenë se një pjesë e stafit është i ri dhe/ose pa përvojë të gjatë në mësimdhënie, të shtohen mundësitë e trajnimit të stafit akademik mbi nevojat e ndryshme për të arritur rezultatet e pritshme në fushën akademike.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master Integrated in "Law" of the Institution of Higher Education "New York University in Tirana"

Strengths and affirmations:

1. The study program is designed according to the best national and international standards, reflecting some of its positive aspects in the new integrated program of studies in law.
2. The institution has ample facilities and the appropriate standards for the development of the study program, equipped with appropriate tools from a logistical point of view, but also from a recreational point of view.
3. The library guarantees ample access to the necessary literature of the program and the field of justice in general, both physically and online.
4. IT services provide coverage of online services and have played an important role in carrying out the learning process on time and according to the requirements of staff and students even during the pandemic.
5. The career office plays an important role in cooperating with employers in conducting and supervising internships preparing students for the labor market in the public or private sector.

Weaknesses:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





1. The complete Institutional Regulation is missing.
2. There is a lack of a special development strategy related to the Faculty of Law and Social Sciences.
3. There is a lack of detailed research plans and orientation of the staff regarding the research that they can perform in a group or individually.
4. Opportunities for professional training of academic staff are limited.

Recommendations:

EEG recommends the following:

1. The law clinic may be more functional or more involved in simulation trials for the purpose of practical student training.
2. The presence of a special coordinator of the study program would facilitate the work of the head of the department. It is suggested, at this point, to appoint a department member in the role of program coordinator.
3. Improve the representation and effectiveness of student participation in decision-making and advisory bodies such as the faculty council and the UNYT academic senate.
4. To increase the mechanisms for increasing the financial autonomy of the faculty and the department, since there is currently a significant dependence on the central bodies.
5. Develop a strategy for scientific development that would coordinate activities in this field.
6. Develop a guide to teaching methods, the qualification of academic staff or how the teaching process is overseen.
7. To draft a complete institutional regulation.
8. To draft a special development strategy related to the Faculty of Law and Social Sciences.
9. As part of the staff is young and / or without long experience in teaching, increase the opportunities for training of academic staff on different needs to achieve the expected results in the academic field.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

